

Zani i Naltë

Themeluar më 1923 - Viti V (XIX) - Nr. 17 (170) ISSN: 2305-655X

SHKËNCË ISLAME | SOCIOLOGJË | PSIKOLOGJË | LETËRSI | HISTORI | MORAL | LITERATURË KOMBËTARE



NUMRI
ISSUE 17 2016

Botues:
Komuniteti Mysliman i Shqipërisë

Zani i Naltë

Revistë shkencore dhe kulturore

VITI V (XIX) 2016, NR. 17 (170)

**Merret me shkenca islame, sociologji, filozofi, psikologji,
histori, gjuhësi, letërsi, moral dhe literaturë kombëtare**

www.zaninalte.al

Tiranë, 2016

Zani i Naltë

Revistë shkencore, organ i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë

Themeluar në tetor 1923, rifilluar në tetor 2012

VITI V (XIX), tetor, nëntor, dhjetor 2016 nr. 17 (170)

Nën kujdesin e

kryetarit të KMSH-së: H. Skender Bruçaj

Drejtör: Dr. Genti Kruja

Bordi editorial: Ali Zaimi

Prof. dr. Ayhan Tekinesh

Prof. dr. Ferdinand Gjana

Prof. dr. Hajri Shehu

Prof. dr. Njazi Kazazi

Prof. dr. Qazim Qazimi

Prof. dr. Rahim Ombashi

Dr. Brikena Smajli

Dr. Fahredin Ebibi

Redaktor: Andrin Rasha

Haxhi Lika

Në anglisht: Dritan Hoxha

Fushat: Shkencat Islame

Tefsir

Hadith

Fikh

Sociologji

Filozofi

Gjuhësi

Letërsi

Psikologji

Histori

Kulturë

Art, etj.

Realizimi grafik: Hysen Vogli

Fotoja në kopertinë: Xhamia e Përmetit

Adresa: Komuniteti Mysliman i Shqipërisë

Rr. "George W. Bush", Nr. 50,

Tiranë - Shqipëri

e-mail: info@zaninalte.al

www: www.zaninalte.al

Përmbajtja

Shkenca Islame

1. Funksionalizmi i mendimit islam

Dr. Muhamed Mustafi, Fakulteti i Studimeve Islame - Shkup5

2. Çfarë keni bërë për ta ndjerë namazin?

Adnan Merja14

Studime

3. Botimi i kolanës “Zani i Naltë”, vlerësim kompensues për vitet e anatemimit dhe rëndësia e tij sot

Mr. Ramadan Shkodra - Dr. Sadik Mehmeti, Bashkësia Islame e Kosovës24

4. Jepjani punëtorit pagën e tij, para se t'i thahet djersa e tij

Ilir Akshija, M.D., M.Sc., Spitali Universitar “Nënë Tereza”, Tiranë29

Jurisprudencë Islame

5. Mbikëqyrja fetare ose Ihtisabi ndaj prindërve – rregullat dhe etika - I

Dr. Sedat Islami, Prishtinë42

Histori

6. Gjashtë shekuj islam institucional në Ballkan

Akademik Feti Mehdiu, Prishtinë55

7. Sanxhaku i Shkupit në fund të shek. XIX dhe në fillim të shek. XX

Dr. Hasan Bello, Instituti i Historisë, QSA 69

8. Në kërkim të pavarësisë

Nuredin Nazarko81

Përkthime

9. Rreth fesë dhe lirisë

Turki El-Hamed89

Personalitete

10. Kleriku atdhetar Sheh Hamid Kraja (1870 -1926)	
Muharrem Shqarri	96

Retrospektivë

11. Paqja, bashkimi kombtar dhe Islamizma	
E. F. Kraja	116
12. Abstracts in English	122
13. Rregullat e shkrimit	128



Funksionalizmi i mendimit islam

Dr. Muhamed Mustafi

Fakulteti i Studimeve Islame, Shkup

Abstrakt

Mendimi islam është diçka që konsiderohet si një tërësi që nuk mund të ndahet në pjesë më të imta sepse në rast të tillë do të konsiderohet vetëm si një rezultat i ndonjë teorie që mund të pranohet ose mund të refuzohet. Tërësia e tillë e këtij mendimi e bën funksional në jetë që nga koha e shpalljes së Islamit e deri sot. Funksionalizmi i mendimit islam mund të jetë shumë real nëse zbatohet në mendje e vepra ashtu siç është aplikuar në kohën e Pejgamberit a.s., gjegjësisht ashtu siç është pranuar nga njerëzit e asaj kohe. Sa më e pastër të jetë mendja, aq më i madh do të jetë funksionalizmi i mendimit islam dhe e kundërta, sa më i zbehtë të jetë truri i myslimanit, aq më i dobët do të jetë funksionalizmi i tij. Mendimi islam nuk ka nevojë të ripërtërihet për t'u përkryer sepse nga vetë natyra është i përkryer dhe se buron nga origjina hyjnore, por ne kemi nevojë të ripërtërijmë veten tonë e të mburremi me Islamin dhe jo me ide e mendime që burojnë vetëm nga truri i njeriut. Mendimet e njeriut janë të ndryshme dhe shumë shpesh i shkel koha, ndërsa mendimi islam është konstant dhe i përshtatshëm për të gjitha kohërat, sepse buron nga Islami që nuk njeh as kohë të caktuar e as popull të caktuar dhe se çdokush ka mundësi ta pranojë dhe se mund të aplikohet në çdo vend.

Hyrje

Në botën e mendimeve ekzistojnë shumë ide, çështje dhe problematika që shqyrtohen për masën e ndikimit të tyre në shoqëri dhe në të shumtën e rasteve më së shumti vlerësohen idetë dhe mendimet që kanë ndikimin më të fuqishëm në botë. Ndryshimet shoqërore dhe politike në botë janë të llojeve të ndryshme, por në bazë të kësaj që përjetojmë edhe ne sot, vërehet qartë se asnjë prej tyre nuk ka tejkaluar masën e kohës, kjo sepse kanë kohë dhe periudhë të caktuar funksionaliteti. Sistemet shoqërore dhe politike janë funksionale për aq kohë sa kanë pushtetin dhe kur humbin e humbasin atë, humbin ndikimin dhe kështu, për teori të tilla, mund të lexojmë vetëm në literaturën historisë së zhvillimit të mendimit njerëzor.

Të njëjtin fat po përjeton edhe mendimi fetar perëndimor, sepse, siç shohim, në Perëndim, ai nuk ndikon në nxitjen e lëvizjeve të mendimit.

Të tilla mendime janë funksionale nëse kanë përkrahje nga institucionet e ndryshme, në të kundërt, jo.

Vlen të theksohet se kur diskutohet për funksionalitetin e mendimit islam asnjëherë nuk kemi hasur në histori, madje as sot nuk vërejmë ndonjë dobësim të tij, pa marrë parasysh nëse përshtatet apo jo me ambientin e jashtëm. Në shumë shoqëri myslimani jeton dhe vepron sipas mendimit islam, si në shoqërinë

islame ashtu edhe në atë joislame. Funksionaliteti i tillë nuk është i dobët nëse bisedohet për dëshminë fetare dhe për jetën fetare, madje ka të njëjtën fuqi në botën islame dhe në atë joislame.

Lëvizja e jetës private, familjare dhe shoqërore brenda parimeve të mendimit islam është vërtet multifunksionale dhe çdo mysliman i aplikon parimet e fesë islame, sepse në trurin e tij mendimi islam është funksional.

Mendimi islam

Funksionaliteti i mendimit të tij është i qëndrueshëm dhe konstant edhe pse “armiqtë e Islamit mundohen që ta prezantojnë keq dhe ta nënçmojnë Islamin që ta bëjnë më pak atraktiv për generatën e njerëzve dhe për ata që tentojnë të largohen nga shoqëria e tyre.”¹

Një opsion i tillë u ofrohet atyre që jetojnë në zbrazëti dhe në mendjet e të cilëve nuk ekziston një bindje e thellë islame.

Në një fushë konfliktesh të tilla, as individit e as shoqëria nuk mund të bien në kurthin e keqinterpretimeve të tilla nëse në mendjet e tyre funksionon mentaliteti islam.

Në këtë kontekst, Marzouq thotë:

“Sikur të praktikohet Islami në mënyrë korrekte nga ana e myslimanëve, atëherë, ata do të bëhen

1. Abdussabour Marzouq, Conquest through ideas, end and means, Muslim World League, Maqqah, f. 29.

mrekulli dhe krenari e historisë, por nëse e braktisin dhe anojnë nga regresi dhe apatia, në këtë mënyrë, faj i pafalshëm do të ishte i tyre e jo i Islamit.”²

Sa më funksional të jetë mendimi islam aq më funksional do të jetë edhe myslimani, sepse fuqia lidhëse ndërmjet këtyre dy komponentëve është shumë e madhe dhe e pandashme. Nuk mund të pritet ndonjë rezultat pozitiv nëse ky raport është i ndërprerë dhe nuk funksionon si duhet. Disfunksionaliteti i mendimit do të vërtetonte të kundërtën e asaj që kemi obligim si myslimanë, arabë qofshim ose jo. Ky funksionalitet do t'i detyrojë njerëzit që “të mos e shikojnë me indiferencë botën aktuale. Sqarimi i islamit ashtu siç është do të vërtetojë se kjo e vërtetë ende jeton në nivelin individual dhe atë shoqëror, i plotë dhe i pakompromis.”³

Ndikimi i së vërtetës së Islamit mund të jetë i fuqishëm apo i zbehtë, në varësi të funksionalitetit të mendimit islam në trurin e myslimanit. Pra, ky funksionalitet e bën atë të ndihet i gjallë në shoqëri, nëse vepron me një energji teorike dhe praktike.

Ndryshe nga të tjerët, të cilët mendojnë se mendimi fetar është i përqendruar vetëm në botën shpirtërore, ne mendojmë se mendimi fetar nuk është aq i ngushtë dhe njëdimensional. Nëse nuk

funksionon në këtë mënyrë, atëherë do të ndodhë njësoj siç ndodhi me të tjerët, të cilët e lidhën vetëm me botën njëdimensionale dhe në këtë rast për shoqërinë do të ketë vetëm një alternativë, gjegjësisht mbështetjen në diçka që nuk është e afërt me natyrën e botës sonë. “Feja është sistem shoqëror, legjislativ e moral, dhe nëse e braktisim një sistemin të tillë me çfarë do ta zëvendësojmë dhe në ç’parime do të mbështeteshim për të përfutur qetësinë në shoqëri? Në këtë mënyrë, alternativa e vetme do të ishte mbështetja në racionalitet dhe në ndërgjegje”.⁴

Ndryshimi i të menduarit duhet të fillohet nga brenda e drejt Islamit e jo nga jashtë, sepse çdo efekt i huaj mund të fshijë natyrën specifike të mendimit islam. “Ne sigurisht, që mund të marrim impulse nga kulturat e huaja, por nuk mund ta kompletojmë Islamin e përkryer me diçka joislame, qoftë nga Perëndimi ose nga Lindja. Islami si institucion shpirtëror e shoqëror nuk mund të “përmirësohet”. Çdo ndryshim në konceptet apo organizimin shoqëror të tij përmes huazimit nga ndikimet e kulturave të huaja, do t'i shkaktonte atij një dëm të madh. Patjetër që duhet të ketë ndryshim, por duke filluar nga vetvetja dhe duke u drejtuar drejt Islamit e jo larg tij.”⁵

2. Po aty, f. 28.

3. Roger du Pasquier, *Unvailing Islam*, The Islamic Texts Society, Cambridge, 1992, f. 8.

4. Abdulhalim Mahmud, *El-islam vel-aklu*, Darul-Me'aref, Kajro, f. 17

5. Muhammad Asad, *Islam at the crossroads*, Noor Publishin house, Delhi, 1987, f. 154.

Nuk kemi të drejtë të mendojmë se mendimi islam mund të funksionojë përmes evolucionit të mendimeve, veçanërisht nëpërmjet zëvendësimit të tij me mendime kalimtare e të përkohshme, sepse në mendime të tilla qëndrimet do të ishin kalimtare dhe me vlerë të përkohshme. Çdo ripërtëritje e mendimeve nënkupton se ka gabim të vazhdueshëm dhe se nuk mund të shërohet një gabimi tillë nëpërmjet evoluimit të ideve. Në këtë mënyrë nuk do të kishte stabilitet as në fe e as në moral.”⁶

Mendimet e ndryshme që janë prodhim i trurit të njeriut janë gjithmonë në lëvizje e sipër, sepse çdo mendim korrigjon të parin dhe kështu ka ndodhur gjer më sot, por, kur bëhet fjalë për mendimin islam, koncepti ndryshon, sepse nuk ai buron nga truri i njeriut, por nga Zoti i Madhëruar. “Ne nuk kemi nevojë të ‘reformojmë’ Islamit ashtu siç mendojnë shumë myslimanë, por ajo që duhet ndryshuar është sjellja jonë ndaj fesë, përtacia jonë, plogështia jonë, shkurtpamësia jonë. Pra, ne duhet të reformojmë gabimet tona e jo defektet e Islamit. Nëse dëshirojmë të fitojmë zgjim islamik, nuk duhet të kërkojmë parime të reja mënyre sjelljeje nga jashtë, por vetëm duhet të aplikojmë parimet e hershme dhe të harruara.”⁷

Parimet e funksionimit të mendimit islam

Mendimi islam nuk do të ishte funksional nëse mbështetet në parime të ndryshueshme që janë pjellë e mendjeve njerëzore. Parimet e Islamit janë ndryshe, sepse kanë funksionuar në një mënyrë unike gjatë tërë historisë së njerëzimit. Diçka është islame kur bazohet në mësimet e Ku’ranit dhe të pejgamberit Muhamed a.s. Sigurisht, Kur’ani dhe literatura e hadithit janë përplot me këshilla e nxitje për të kërkuar diturinë dhe përmirësuar veten nëpërmjet përputhjes së normave të siguruara nga Zoti dhe pejgamberi i Tij. Por, dija edhe përmirësimi kuptohen gjithmonë në terma të një synimi të posaçëm dhe ky synim është që të bëhemi plotësisht njerëzorë në këtë botë e të arrijmë lumturinë e përjetshme në tjetrën.

Në vetvete dhe për vetvete dija s’ka vlerë, përndryshe, pejgamberi nuk do të ishte lutur: “O Zot, kërkoj mbrojtje nga dija e padobishme.”⁸

Pra, funksionaliteti i mendimit islam varet nga raporti që ekziston mes diturisë në kokën e myslimanit dhe mes jetës praktike të tij. Asgjë nuk mund të jetë funksionale nëse është e mbyllur brenda kufijve të njohurive teorike e të thata, që nuk mund të zbatohen në jetën praktike individuale e shoqërore.

6. Abdulhalim Mahmud, op. cit, f. 226.

7. Muhammad Asad, op. cit, f. 154.

8. William Chittick, Shkencë e kozmosit, shkencë e shpirtit, Zemra e Traditës, Tiranë, 2011, f. 162.

Burimi i mendimit islam është hyjnor dhe ka për qëllim aplikimin e tillë në jetën e përditshme normative, individuale dhe shoqërore. Ky mendim nuk mund të jetë thjesht një teori që mund të pranohet apo jo, por është obligim dhe përgjegjësi, që duhet të realizohet me fjalë dhe vepra. Mendimi islam është i frymëzuar nga shpallja dhe është shpjeguar nga Pejgamberi a.s. “...për t’i kontrolluar forcat e historisë dhe në këtë mënyrë për të formuar një botë të re të idealeve. E tillë është edhe përgjegjësia e myslimanit, pra të mendojë për shenjat që i sheh e jo të kalojë pranë tyre si të ishte i shurdhër dhe i verbër. Ai që është i verbër në këtë botë, do të jetë i verbër në botën tjetër.”⁹

Meqenëse qëllimi kryesor i shpalljes së Islamit është udhëzimi i njerëzve në këtë botë, atëherë nuk kemi të drejtë të formojmë vetëm mendime teorike jofunksionale, sepse, në të kundërt, do të humbim rolin që kemi në këtë botë. Nuk kemi të drejtë të mendojmë jashtë botës dhe jashtë jetës, sepse nuk jemi njerëz që jetojmë me ëndrra e shpresa. Lidhja mes mendimit islam dhe realitetit është shumë e fuqishme dhe pa kurrfarë kontradiktash. “Në Islam, ideali dhe realiteti nuk janë dy fuqi kontradiktore që nuk mund të pajtohen. Jeta ideale nuk mund të formohet përmes braktisjes së

plotë të realitetit, sepse në këtë mënyrë shkatërrohet uniteti organik i jetës. Ideali gjithmonë tenton që të përshtatet me realitetin për ta absorbuar, për ta transformuar dhe për ta ndriçuar në tërësi.”¹⁰ Në këtë kontekst, Zoti i Madhëruar thotë: “Ne nuk i krijuam qiejt dhe tokën dhe atë që është në mes tyre për të luajtur.”¹¹

Ne jemi njerëz që bartim përgjegjësinë e Islamit dhe nëse mendojmë se vetëm me mendimet tona jofunksionale do të mund të ndryshojmë realitetin, gabojmë, sepse ajo që quhet mendim islam, duhet të ketë edhe funksion islam.

Nëse mendimin islam e largojmë për t’u mbështetur në ndonjë parim tjetër, atëherë natyra e tij do të ndryshojë, sepse me ndryshimin e besimit ndryshon edhe efekti. “Në këtë mënyrë, intelekti do të bëhet udhëheqës e jo feja dhe në këtë mënyrë do të ndryshonte natyra e fesë dhe do të largoheshim nga rruga e drejtë. Kjo rrugë e drejtë, që në arabisht quhet “*siratun mustakim*” nënkupton lidhshmërinë e ngushtë mes fesë dhe intelektit.”¹²

1. Feja është shpallur për të udhëzuar intelektin rreth çështjeve konkrete që kanë të bëjnë me botën e metafizikës, veçanërisht sqaron çështjet që kanë të bëjnë me Zotin, pejgamberin e ditën e gjykimit.

10. Muhamed Ikbāl, op. cit., f. 18.

11. Ku’ran, 44:38.

12. Abdulhalim Mahmud, El-Islam vel-aklu, f. 17.

9. Muhamed Ikbāl, Obnova vjerske misli u Islam, Sarajevo, 1979, f. 95.

2. Feja ka të bëjë me çështjet e moralit e veçanërisht me të mirën e të keqen, me vlerat që e bëjnë njeriun të devotshëm, të singertë, besnik e të mirë.

3. Feja ka të bëjë me çështjet legjislative që e rregullojnë shoqërinë dhe e bëjnë atë të lumtur nëpërmjet normave të tilla.

Pra, feja është shpallur për të udhëzuar intelektin pikërisht në këtë çështje.

Mënyra e funksionimit të mendimit islam

Mendimi islam është funksional sepse ka një synim dhe nuk formohet pa pasur ndonjë dobi konkrete, sepse në të kundërt, do të ishte steril dhe i pafrytshëm. Këtë çështje e analizon shumë bukur studiuesi i njohur islam William Chittick: “Thashë se ka një dallim themelor midis traditës intelektuale islame dhe diturisë moderne. Për ta kuptuar këtë, duhet theksuar se intelektualët myslimanë përpiqeshin të arrinin një vizion njësoj dhe të njësoj të të gjitha gjërave duke aktualizuar intelektin tejpersonal, shpirtin hyjnor (ruhin) të fshehur në veten njerëzore.

Përkundrazi, shkencëtarët modernë kërkojnë të arrijnë një të kuptuar gjithnjë e më të përpiktë të gjërave, që t’u lejojë (të kenë) kontroll në rritje mbi mjedisin, trupin e njeriut dhe shoqërinë. Mirëpo, ky kontroll arrin në atë shkallë sa i dorëzohet egoizmit injorant dhe harraq, që tekstet e quajnë ‘kaprico’ (hawa) ose ‘neps’ (shahwa).

Ai nuk vihet në duart e inteligjencës plotësisht të aktualizuar të mëkëmbësit të Zotit mbi tokë. Kjo shihet veçanërisht qartë në botën moderne, ku të gjithë kanë shfrytëzuar fuqinë shkencore, teknologjike e burokratike për të ngulitur bindjet te të nënshtruarit e tyre.”¹³

Horizonti i mendimit islam nuk ka vetëm një funksion, por është shumëfunksional, sepse mbështetet në parimin që nuk sheh përkufizim konkret, veçanërisht në fe. “Feja nuk është diçka e kufizuar, nuk është vetëm mendim, as vetëm ndjenjë e as vetëm vepër, por është pasqyrë e tërë njeriut dhe për këtë shkak, nuk ka arsye që të mendohet se kuptimi dhe intuita pengojnë njëri-tjetrin, sepse kanë një origjinë që vjen nga një burim.”¹⁴

Kjo mënyrë e funksionalizimit të mendimit islam nuk përkufizohet vetëm në një shtresë njerëzish. Këtë botëkuptim e ka edhe intelektual i edhe i rëndomti, i pasuri dhe i varfri. Ky mendim funksionon te të gjithë, sepse bindja islame është në shpirtin e të gjithëve. “Islami në esencën e vet nuk i ndan njerëzit përpos në bazë të devotshmërisë ndaj Allahut dhe kryerjes së veprave të mira.

Sipas Islamit, njerëzit janë të barabartë si dhëmbëzat e krehrit. Arabi nuk ka asnjë dallim kundrejt njerëzve të tjerë përveçse në bazë të devotshmërisë. Që aty, Islami e zgjeroi

13. William Chittick, op. cit, f. 81-82.

14. Muhamed Ikbali, op. cit, f. 14.

hapësirën në drejtimin që nënkupton se çdokush ka të drejtë të mendojë, të përsiatë, të hulumtojë dhe të punojë, qoftë ai pjesëtar i udhëheqësve ose rob ose i mbrojtur.”¹⁵

Myslimani formon vetveten nëpërmes funksionalitetit të mendimit të tij islam. Sa më autentik të jetë mendimi i tij, aq më funksional do të jetë në botë, si dhe sa më të pasur ta ketë diapazonin e mendimit, aq më shumë do të ketë ndikim në lëvizjet botërore bashkëkohore.

Kështu vepruan myslimanët e hershëm dhe kështu u bënë udhëheqës në botën e mendimeve dhe lëvizjeve politike. Ata formuan një ndikim të dukshëm nëpërmjet kulturës së tyre dhe, (falë kësaj), sot e kësaj dite, vazhdojnë të ndikojnë në botë me anë të veprave të tyre të shkruara. Ata i zbërthyen mendimet e hershme filozofike greke duke formuar mendimin autentik islam. Ata e kuptuan mirë se si funksionon mendimi islam dhe për këtë shkak, sot, ashtu siç thotë Akkadi: “Përballë islamit ekzistojnë dy gjëra të rëndësishme, që nuk duhen vonuar e injoruar. E para ka të bëjë me mbrojtjen e vetes para ambicieve të të huajve, kurse e dyta ka të bëjë me bashkëpunimin për t’i përfituar mjetet e përparimit dhe zhvillimit.”¹⁶

Mendimi islam nuk përqendrohet

vetëm në një popull, sepse shpallja nxit fuqinë e mendimit të gjithë. “Shpallja, pra, nuk është shpallje e vetëm një populli, por është një shpallje themelore”¹⁷, që vlen për të gjithë. Nuk mund të thuhet se shpallja i takon vetëm një populli, por të gjithë i shijojnë rrezet e ngrohta të saj dhe të gjithë inspirohen prej saj. Kjo ishte një analizë e mënyrës më të mirë për të qenë mendimi islam funksional ashtu siç ka qenë në kohën e kaluar, veçanërisht në kohën e Pejgamberit a.s., e më vonë. Studimi i kësaj çështje erdhi si shkak i keqardhjes sonë kur vështrojmë se si sot, edhe pse jemi të shumtë në numër, jemi shumë të kufizuar në ndikim, ndërsa, për sa i përket temës, ashtu si thotë edhe Ibn Halduni në Mukaddime, “shpresoj që ata që do të vijnë pas nesh, Zoti do t’iu dhurojë mendim korrekt dhe me një shkencë të pastër do t’i shqyrtojnë të gjitha çështjet e një disipline. Ata që do të vijnë më vonë, do të shtojnë fakte pas fakti derisa shkenca të kompletohet.”¹⁸

Përfundim

Sot, nga e gjithë sa u tha në këtë elaborate, vërehet qartë se shtrimi i rrugës për të depërtuar nëpër mendimin funksional islam në botë është shumë i vështirë. Pra, ashtu

15. Ahmed Fuad El-Ehvani, Filozofia Islame, BIM-FSHI, Shkup, 2002, f. 126.

16. Abbas Mahmud Akkad, El-Islam vel-hadaret-insaniijetu, El-Mektebetul-asrije, S’ajda, Bejrut, f. 12.

17. Eva de Vitrej Mejerovic, Poetika islama, (Julija Krsteva, Prelazenje znakova), Svjetlost, Sarajevo, 1979, f. 203.

18. Ibn Haldun, Mquaddima, Veselin Maslesha, Sarajevo, 1982, f. 125.

siç pejgamberi a.s. u ballafaqua me realitetin e ngadhënjeu, ashtu duhet vepruar edhe në realitetin tonë. Ne nuk jemi ata që ndryshojmë mendimet e njerëzve, por nëse ofrojmë mendim të pastër e funksional, atëherë do të jemi të suksesshëm, sepse do t'i ofrojmë njeriut bashkëkohor një ideal që është më i lartë se ai material, në mënyrë të veçantë do ta mbulojmë zbrazëtirën që ekziston në mendimin njerëzor ashtu siç ekzistonte edhe në shoqërinë para se të vinte shpallja kuranore.

Funksionalizmi i mendimit islam mund t'i dhurojë mendimit teknologjik, ekonomik dhe politik ndërkombëtar shpirtin human dhe të mbulojë zbrazëtirën që ekziston në natyrën e tyre.

Vetëm nëpërmjet funksionalitetit të mendimit islam mund të përfitohet pozita e hershme që zotëronin myslimanët dhe vetëm në këtë mënyrë mund të dilet në mejdan me të tjerët, përndryshe do të vazhdohet edhe më tej pa fjalën kryesore dhe pa ndikim në lëvizjet botërore.

Literatura

1. Kurani Kerim në përkthim të Sherif Ahmetit.
2. Abbas Mahmud Akkad, El-Islam vel-hadaretul-insanijetu, El-matba-atul-asrijetu, Saida, Bejrut.
3. Abdulhalim Mahmud, Al-Islam vel-aklu, Darul-mearif, Kajro.
4. Abdoussabour Marzouq, Conquest through ideas, end and means, Muslim World League, Maqqah.
5. Ahmed Fuad El-Ehavni, Filozofia islame, BIM-FSHI, Shkup, 2002.
6. Eva de Vitrej Mejerovic, Poetika Islama, (Julijsa Kristeva, Prelazjenje znakova, Svjetlost, Sarajevo, 1979.
7. Ibn Haldun, Muqaddima, Veselin Maslesa, Sarajevo, 1982.
8. Muhammed Asad, Islam at the crossroads, Noor Publishing House, Delhi, 1987.
9. Muhamed ikbal, Obnova vjerske misli u islamu, Sarajevo, 1979.
10. Roger du Pasquier, Unvailing Islam, The Islamic texts Society, Cambridge, 1992.
11. William Chittick, Shkencë e kozmosit, shkencë e shpirtit, Zemra e traditës, Tiranë, 2011.

Çfarë keni bërë për ta ndjerë namazin?

Adnan Merja

Abstrakt

Nëse me të vërtetë duam të realizojmë faljen e namazit ashtu siç duhet, duhet të zhvishemi nga çdo ndjenjë tjetër përveç kënaqësisë së Allahut (xh.sh.) dhe zemrën t`ia hapim Atij. Çdo fjalë që derdhet nga buzët, duhet të vuloset me vulën e vetëdijes. Për shembull, kur themi Elhamdulillah, duhet ta dimë mirë se ç`nënkuptohet me këtë fjalë dhe ta përpunojmë atë në vetëdijet tona e duke ngashëruar të themi “Të gjitha lavdërimet dhe të gjitha falënderimet e lartësimit, i takojnë vetëm Allahut (xh.sh.). Të bëj këtë, është detyra ime dhe e drejta e Krijuesit tim”. Kështu që ajo fjalë, të lartësohet te Allahu, së bashku me kuptimet e thella që kemi mbartur mbi të. Po ashtu, edhe kur të themi Err-Rrahman dhe Err-Rrahim, të jemi të stolisur me të njëjtat ndjenja për Të. Kur të themi Maliki Jeumid-Din, ta vulosim këtë fjalë me kuptimet madhbështore që përmban dhe në këtë formë t`ia paraqesim të Vërtetët. Namazi për ne, duhet të konsiderohet si një miraxh dhe për këtë duhet të përpigemi sipas kapacitetit tonë të ndjejmë ato të vërteta që ndjen Profeti ynë (a.s.).

Pyetje: Ta lemë mënjane namazin e Selefi salihinëve (të parëve tanë). Sot, shumica e njerëzve po përpigën të gjejnë një mënyrë për të anashkaluar namazet e detyruara. Kërkojmë edhe një herë këshillat tuaja në këtë pikë, për të mos rënë më pre e pamjes së jashtme, për të mos sakrifikuar më shpirtin e namazit me disa veprime formalitare dhe

të arrijmë vetëdijen për një përkushtim të thellë gjatë faljes?!..

Përgjigje: Besimi dhe namazi, janë të dy pjesë të një foleje të përbashkët; namazi, është vëllai binjak i besimit. Besimi përfshin edhe pjesën e jashtme të fesë dhe jetës fetare, e kjo pjesë rikuperohet

vazhdimisht dhe arrin të bëhet njësh me natyrën nëpërmjet adhurimeve të ndryshme, por më shumë, me më të parin e tyre, namazin. Sipas kësaj mund të thuhet se namazi është një besim i praktikuar dhe besimi një namaz i praktikuar. Ata që e kanë përjashtuar nga jeta e tyre konceptin e thellimit në adhurime dhe e shikojnë fenë thjesht si një pranim ndërgjegjësor, sado që punët e veprimtaritë t'i orientojnë sipas kriterëve fetare, pa e kuptuar fare u vjen dita që mund të bien në mëkat. Po, shtylla e fesë është namazi. Namazi e pastron njeriun nga papastërtitë shpirtërore, çdo ditë pesë herë, nëpërmjet lumenjve të pendesës që rrjedhin drejt përjetësisë. Ai, është një detyrë aq e rëndësishme, një strehim aq i sigurt saqë edhe në momentet më të zjarrra siç janë luftërat, të ofrohen rrugët më të shkurtra për ta kryer atë dhe më të afërta drejt përjetësisë. Për këto veçori kaq të larta, namazi ka zënë vendin më të rëndësishëm në jetën e njerëzve të Shekullit të Lumtur, saqë të gjithë Miqtë e të Vërtetit, nuk janë mjaftuar asnjëherë me namazet e detyruara por e kanë përsosur jetën duke falur çdo ditë qindra rekate vullnetare.

Të dashuruarit me namazin

Udhëzuesi ynë, Profeti Muhamed (a.s.) gjatë gjithë jetës së tij tregoi një shembull shumë të bukur dhe një kujdes shumë të afërt

me namazin, saqë zgjoi në zemrat e ndjekësve dashuri të thellë për “ajkën e adhurimeve”. Ai, që thoshte për namazin, “namazi është drita e syve të mi”¹, që e praktikonte atë në një mënyrë më të dashur, më të zellshme se dashuria apo zelli që ndiejnë të tjerët për disa gjëra të tjera², që qëndronte në këmbë derisa i ënjteshin këmbët³, që disa herë nuk kalonte në rekatën tjetër derisa të lexonte disa xhuze nga Kur`ani⁴, që gjatë faljes i dëgjohej zëri i ngashërimeve, siç dëgjohej zëri i një tenxhereje kur zien, apo i një mulliri kur e punon me dorë⁵, që dridhej përpara të Vërtetit në momentin e sexhdes⁶. Vetëm një përqendrim i tillë, një ndjeshmëri e tillë si e Profetit të Nderuar (a.s.), mund t'i bënte sahabet të dashuruar me namazin.

Nëse do ta themi me fjalët e Fudajl ibn Ijad, sahabet e nderuar, kur zgjoheshin në mëngjes, e kishin fytyrën të zverdhur e të zbehur ngaqë pjesën më të madhe të natës e kalonin duke falur namaz. Ndonjëherë qëndronin shumë pak në këmbë por shumë gjatë në sexhde.

1. Nesai, *isbretu`n-nisa* 1; Ahmed Ibn Hanbel, *El-Musned* 3/128, 199, 285.

2. Et-Taberani, *El-Mu`cemu`l-kebir*, 12/84; Ed-Deylemi, *El-Musned*, 1/172.

3. Buhari, *tefsiru sure* (48) 2; Muslim, *sifatu`l-munafikin* 79-81.

4. Shiko: Buhari, *tebexhud* 9; Muslim, *salatu`l-musafirin* 204.

5. Ebu Davud, *salat* 156; Ahmed Ibn Hanbel, *El-Musned* 4/25.

6. Kur`an, 26: 218-219.

Kur fillonin me përgjërime dhe të derdhnin brendësinë e tyre ndaj Allahut, tundeshin siç tunden pemët në kohë me furtunë, po ashtu edhe sytë së bashku me vendin lageshin nga lotët. Kënaqësia që merrnin nga namazi, ua harronte çdo lodhje fizike dhe donin që këto minuta të mos mbaronin kurrë. Kur vinte mëngjes, lyenin fytyrën me vaj dhe rrudhnin sytë që njerëzit të kujtonin se e kishin kaluar natën në gjumë.

Le të hedhim vështrimin nga vetë praktikat e mrekullueshme të sahabeve të nderuar; se çdo të thotë të kuptosh qëndrimin përpara Mëshirës Hyjnore, të provosh shijen e Kur'anit Famëlartë dhe ç'është dashuria dhe zelli për namazin: Pejgamberi (a.s.), gjatë luftës Dhatu'r-Rika, kishte ngarkuar me detyrë për ruajtjen e një shtëpie, dy sahabë të nderuar, Ammar ibn Jasir dhe Abbad ibn Bishr (r.a.). Kur Ammari kishte radhën e pushimit, Abbadi u çua të falte namaz. Në këto momente, një idhujtar i kishte diktuar këta sahabë të nderuar dhe filloi të gjuajë me shigjeta drejt tyre. Abbadi iu ngulën në trup dy-tre shigjeta por ai nuk e prishi namazin dhe e plotësoi me ruku dhe sexhde. Më pas zgjoi shokun e tij. Ammari menjëherë u çua dhe teksa po e ndiqte idhujtarin me sy, u kthye te shoku i tij dhe kur pa gjakun që po i rridhte e pyeti se pse nuk e kishte zgjuar kur ndodhi kjo. Abbadi i ktheu një përgjigje prej të dashuruarish me namazin duke

i thënë: "Po lexoja një sure (Kehf), (ajetetet ishin aq të bukura aq të ëmbla) saqë nuk doja ta ndërprisja namazin pa i mbaruar. Por, kur shigjetat po më vinin njëra pas tjetrës, u detyrova ta mbaroj namazin dhe të thërras ty. Të betohem në Allah, se po të mos kisha shqetësimin se nuk do ta ruaj dot këtë vend që na tha i Dërguari i Allahut (a.s.), më mirë vdisja në namaz se sa të ndërprerja suren në gjysmë."⁷

Çdo ditë qindra rekate namaz

Po, sahabet e nderuar asnjëherë nuk mjaftoheshin me ibadete e nuk ngopeshin me namaz. Po ashtu, edhe ata që patën fatin të ulen në gjunjë së bashku me mësuesin e tyre, u rritën të tillë si heronj namazi. Për shembull, Ata' ibn Ebi Rebah (r.a.), edhe pse ishte shumë i dobët fizikisht dhe i pafuqishëm, vazhdonte të lexonte të paktën në njërin rekat, njëqind ajete nga sureja Bekare. Përqendrimi që përjetonte në namaz, ia harronte mundimet fizike⁸.

Muslim ibn el-Ferahidi, thotë për njërin prej të mëdhenjve të tebei tabiinëve, Shu'be ibn Haxhaxh se: "Sa herë që shkoja pranë Shubes, - përveç kohës së kerahetit (kohë jo e përshtatshme për namaz), - e gjeja gjithmonë duke falur namaz"⁹.

7. Ebu Davud, *tabaret* 79; Ahmed Ibn Hanbel, *El-Musned* 3/343.

8. Ebu Nuajm, *Hijetu'l-Evlja* 3/310; Ibnu'l-Xhevzi, *Sifatu's-Safve* 2/213.

9. Ibnu'l-Xhevzi, *Sifatu's-safve* 3/350.

Gjithashtu Ebu Kattan shton se: “Nëse do ta shikonit Shu’ben kur qëndronte në ruku, do të kujtonit se ka harruar sexhden. Nëse do të shikonit qëndrimin e tij mes dy sexhdeve, do të kujtonit se ka harruar sexhden e dytë.”¹⁰

E pra, të dashuruarit pas namazit, e kishin shumë të lehtë faljen e njëqind rekateve në ditë. Ata faleshin aq shumë saqë shpeshherë, udhëtimi për në botën tjetër u fillonte në këtë gjendje. Për shembull, Ebu Ubejde el-Basri, një nga rrethi i tabiinëve, e filloi rrugëtimin e tij për në botën tjetër pikërisht kur ishte në namaz.¹¹

Nuk ishin të pakët edhe ata që e falnin namazin e sabahut me abdesin e namazit të jaciesë, si: Vehb ibn Munebbih, Tavus ibn Kejsan, Said ibn Musejjeb, Imam ebu Hanife.¹² Cunejd-i Bagdadi, për tridhjetë vite me radhë, i ka falur namazet me xhemat dhe asnjëherë nuk ka humbur tekbinin fillestar. Nëse ndjente se në zemër i kishte hyrë pakëz mendim rreth dynjasë dhe ndjente që nuk e kishte ndjerë plotësisht namazin, sado e pakët të ishte kjo, atë namaz e falte përsëri. E kishte bërë zakon të falte çdo ditë katërqind rekate namaz. Për tridhjetë vite rresht, nuk ka fjetur asnjëherë pas namazit të jaciesë dhe natën e ka kaluar me

adhurime. Ebu Osman en-Nehdi, edhe pse konsiderohej nga ata që nuk e kishin parë të Dërguarin e Allahut, siç thuhet në terminologjinë e hadithit (muhadramun), falte gjithmonë njëqind rekate mes namazit të akshamit dhe jaciesë.

Edhe mbretërit e botës shpirtërore si Bishr ibn el-Mufaddal dhe Bishr ibn Mansur, ishin mes atyre që falnin katërqind-pesëqind rekate në ditë. Për më tepër, drejtuesi i shtetit Abbasi, Harun Rashid, megjithëse kishte shumë punë dhe detyra të tjera në drejtimin e shtetit, transmetohet se nuk asnjëherë nuk ka neglizhuar që të falë njëqind rekate çdo ditë. Kjo tregon lidhjen e fortë të njerëzve të asaj kohe me namazin dhe me adhurimet. Në fakt, nëse shfletojmë librat e shkruar rreth njerëzve të mëdhenj, do të gjejmë se nuk janë të pakët ata që kanë kaluar jetën duke falur nga njëqind rekate në ditë.

Nivel dhe punë zemre

Në këtë mes, dua të përmend edhe diçka: Sigurisht që në fe nuk ka vështirësi. Islami, është i ndërtuar mbi “jusr” (lehtësi).¹³ Profeti ynë (a.s.), edhe pse vetë falej derisa i ënjteshin këmbët, umetit (bashkësisë) së tij gjithmonë i ka propozuar të bëjnë aq sa munden, gjithashtu edhe në fushën e adhurimeve u ka këshilluar të mos e mbingarkojnë veten me gjëra që nuk munden. Në

10. Ebu Nuajm, *Hiljetu l-enlija* 7/145; Ibnu l-Xhevzi, *Sifatu s-Safve* 3/349.

11. Edh-Dhehebi, *Sijeru a’lami n-nubela* 6/167.

12. Shiko: El-Gazali, *Ihja ulumi d-din* 1/359.

13. Buhari, *iman* 29; Nesai, *iman* 28.

këtë pikëpamje, të ndjesh namazin që fal dhe të falesh shumë, është një lloj niveli. Besimtarët, në këtë pikë inkurajohen dhe nxiten për qëllime të larta, por asnjëherë nuk duhet të kalojë kjo në dhunë apo detyrim.

Kështu thotë edhe shkrimtari i Risaleve, “pesë namaze me abdes në një ditë kryhen mjaftueshëm në një orë të vetme”¹⁴ dhe tregon rrugën e lehtësisë që duhet të kemi si objektiv. Vërejmë nëpërmjet kësaj fjalie që është marrë parasysh edhe ai që nuk ka mundësi, por edhe ai që ka mundësi ta kryejë namazin, duke i dhënë një lehtësi prej një ore për ti kryer të gjitha namazet pa i braktisur ato. Më pas, ai shton duke thënë, “asnjëherë mos thuaj, ‘ku është namazi që fal unë e ku namazi që duhet falur në të vërtetë!’ sepse një farë hurme ka vlerën e një peme hurme.”¹⁵ Me anë të kësaj fjale, do të tregojë se edhe ai që nuk kupton asgjë nga ato që thotë në namaz, prapëseprapë namazi i tij futet në peshoren e punëve dhe llogaritet si adhurim. Po ashtu shton se, siç fara e hurmës ka fazat e veta për tu bërë pemë, edhe namazi ka fazat e veta dhe për çdo fazë merr pjesë nga drita hyjnore. Bediuzzamani na nxjerr në pah objektivin me këto fjalë, për t’i dhënë zemër njerëzve të dobët si ne dhe për të mos i thyer shpresat

tona. Po, Allahu i Lartmadhëruar e shpërblen këdo që fal namaz, por ajo për të cilën po flasim këtu, është e vërteta dhe shpirti i namazit.

Një besimtar, duhet që namazin ta plotësojë, patjetër, me kushtet që ai kërkon. Pra, siç përmendet edhe në librin “Isharatul ixhaz”, “ajo që duhet të bëjmë kujdes në namaz, është plotësimi i të gjitha kushteve dhe ruajtja e origjinës dhe kuptimit të pastër të tij”.¹⁶ Të përpiqesh t’i zbatosh të gjitha kushtet e namazit sipas mënyrës që kërkohet dhe ta ruash freskinë e tij si në ditën e parë pa e dëmtuar me ngjyime të tjera të dëmshme. Të vraposh çdo ditë në lumin e namazit, të pastrohesh në të nga çdo gjynah dhe me një shpirt të pastër të dalësh gjithmonë përpara të Madhërishmit duke përjetuar pothuajse në çdo kohë faljeje, “miraxhin” e mrekullueshëm.

Origjina e namazit dhe kuptimi i tij

Në thelb, namazi është përmendje, lavdërim dhe falënderim për Allahun. Po, përmendja, lavdërimi dhe falënderimi, janë bërthama e namazit, prandaj në të gjitha lëvizjet e kryera në namaz, lexojmë fjalët (elhamdulillah, subhanallah, Allahu ekber). Ashtu siç përmend edhe Bediuzzamani se, që nga fillimi pra, marrja e tekbitit fillestar, e deri në dhënien e selamit të fundit, ne e lartësojmë Allahun

16. Bediuzzaman, *Isharatul l-ixhaz* f. 42.

14. Bediuzzaman, *Fjalët (Sözler)* f. 21 (Fjala e katërt).

15. Bediuzzaman, *Fjalët* f. 290 (Fjala e njëzetë e një, makami i parë).

me çdo gjendje tonën dhe me çdo fjalë, duke thënë Subhanallah, ose e falënderojmë me të gjitha ndjenjat duke thënë Elhamdulillah, ose e madhërojmë duke thënë Allahu ekber.¹⁷ Për shkak se namazi fillohet me të, tekbirit fillestar i thuhet në origjinal (tekbir iftitah) tekbiri çelës. Gjithashtu, gjatë namazit është edhe një tekbir tjetër që emërohet në origjinal (tekbir tahrim) tekbiri ndalues. Në fakt, ky tekbir, me një emërim të tillë është si një fjalë e dhënë, e cila do të thotë se tashmë ndalohet hyrja e çdo gjëje dynjaje dhe je në atmosferën e veçantë të Mbretit të Gjithësisë. Që nga ai moment, fillon namazërimi yt i plotë, duke ia dedikuar të gjitha ato minuta, sekonda, fragmente, gdhendjes tënde shpirtërore me përmendje, lavdërime dhe falënderime.

Po, nëse me të vërtetë doni të realizoni faljen e namazit ashtu siç duhet, duhet të zhvisheni nga çdo ndjenjë tjetër përveç kënaqësisë së Allahut (xh.sh.) dhe zemrën t'ia hapni Atij. Çdo fjalë që derdhet nga buzët, duhet të vuloget me vulën e vetëdijes. Për shembull, kur thoni Elhamdulillah, duhet ta dini mirë se ç'nënkuptohet me këtë fjalë dhe ta përpunoni atë në vetëdijet tuaja e duke ngashëruar të thoni "Të gjitha lavdërimet dhe të gjitha falënderimet e lartësimit, i takojnë vetëm Allahut (xh.sh.). Të bëj këtë, është detyra ime

dhe e drejta e Krijuesit tim". Kështu që ajo fjalë, të lartësohet te Allahu, së bashku me kuptimet e thella që kenë mbartur mbi të. Po ashtu, edhe kur të thoni Err-Rrahman dhe Err-Rrahim, të jeni të stolitur me të njëjtat ndjenja për Të. Kur të thoni Maliki Jeumid-Din, ta vulosni këtë fjalë me kuptimet madhështore që përmban dhe në këtë formë t'ia paraqisni të Vërtetit. Namazi për ju, duhet të konsiderohet si një miraxh dhe për këtë duhet të përpiqeni sipas kapacitetit tuaj të ndjeni ato të vërteta që ndjeu Profeti ynë (a.s.). Namazi juaj duhet të përmbajë brenda tij të gjitha kuptimet e larta hyjnore dhe të lartësohet nëpër qiej, sikur po takohet me secilin Pejgamber, që ndodhej aty. Me Ademin (a.s.) në qiellin e parë, me Jahjan (a.s.) dhe Isain (a.s.) në qiellin e dytë, me Jusufin (a.s.) në qiellin e tretë, e me Idrisin (a.s.), Musain (a.s.), Ibrahimin (a.s.) në qiejt e tjerë dhe të ndjejë, që sikur edhe për pak, nëse hedh edhe një hap, e gjen veten përpara atmosferës së veçantë Hyjnore. Në fund të namazit, menjëherë pas dhënies së selamit, me frikën se nuk i ke respektuar dot ashtu siç duhet kushtet e të qenët përpara atmosferës Hyjnore, ngre duart dhe vazhdon me lavdërime, falënderime e lartmadhërimet dhe pa ndalur vazhdon ti përsërisësh këto fjalë të mrekullueshme nga tridhjetë e tri herë. E pra, nëse doni të përjetoni një namaz duke kuptuar të vërtetat e

17. Shiko: Bediuzzaman, *Fjalët* f. 42-50 (Fjala e nëntë).

tij, nuk duhet t'i lini pas dore këto. Pa harruar edhe fillimin e përgatitjeve serioze përpara faljes.

Fytyra e venitur e ibadeteve tona

Nga ana tjetër, nëse besoni se ia keni dedikuar veten tuaj lartësimit të fjalës së Allahut, atëherë duhet ta kuptoni mirë rëndësinë e këtij dedikimi dhe sipas asaj të mbani qëndrimin e duhur. Lartësimi i fjalës së Allahut, është thirrje për në besimin në Allah si dhe të ftosh në Islam dhe në shtyllat bazë që na parashtroi i Dërguari i Allahut (a.s.). Lartësimi i fjalës së Allahut, është gjithashtu të tregosh një përpjekje serioze për të shkruar emri i Allahut në çdo skaj të botës si dhe bashkë me të, përcimi i emrit të Profetit tonë Muhamed (a.s.) në çdo cep të errët të saj. Lartësimi i emrit të Allahut, është të valëvitësh në skajet më të larta të vërtetën “la ilahe il-lallah Muhammedun Resulullah” dhe ta bësh atë si një ylber, i cili shikohet nga të gjithë. Atëherë, nëse ju i jeni futur rrugës së njohjes së Allahut nga njerëzit, leximi i mesazheve të Tij nga ana e tyre, leximi i pasqyrimeve hyjnore të gjendura në fytyrën e gjithësisë nga ana e njerëzve, si dhe nëse i thërrisni drejt adhurimit të duhur, a nuk duhet që në fillim ju vetë t'ia veni veshin këtyre mesazheve, t'i lexoni ju të parët dhe të jeni ju nga ata të parët, që adhurojnë me sinqeritet? Nëse akoma veproni me mendimin që ‘hajde ta falim edhe këtë namaz dhe ta heqim’ duke u mjaftuar thjesht të

bëni disa lëvizje formale, sa për të thënë që jam falur, a nuk e mashtroni veten në këtë mënyrë? A nuk është e pakuptimtë që këtë gjë që ju nuk e shikoni si të rëndësishme dhe nuk e vlerësoni sa duhet, por vetëm si diçka që është për tu kaluar, t'ia shpjegoni të tjerëve? A nuk duhet që këtë gjë në të cilën po ftoni njerëzit, pikë së pari të jetë ndër punët më serioze tuajat? Nëse nuk e vlerësoni siç duhet diçka, si prisni që të tjerët ta vlerësojnë atë?!

Një nga problemet më të mëdha tonat, si myslimanë është zbehja, që vihet re dukshëm në ibadetet tona. Sa e dhimbshme është kur në xhamitë tona shikon njerëz në një gjendje si ato gjetet e vjeshtës, njërit i hapet goja për gjumë, një tjetër është shtrirë, një tjetër edhe në mihrab flet rreth dynjasë dhe një tjetër me zi pret të mbarojë namazi dhe të dalë jashtë. Për këtë, një gjendje e tillë nuk sjell asnjë lloj ndikimi pozitiv në shoqëri. Adhurimi, nuk funksionon më si një mjet praktik për t'i ftuar të tjerët në Islam. E nëse ne do të përfaqësonim me vepra besimin, siç thotë edhe Bediuzzamani: “Nëse ne do ta jetonim shumë mirë atë që lexojmë në Kur'an, nëse do t'i demonstrojmë me vepra moralin Islam dhe të vërtetat e besimit, do të kishin hyrë në këtë fe të bukur edhe personat e feve të tjera dhe disa shtete të disa kontinenteve do të pranonin Islamin”.¹⁸

18. Shiko.: Bediuzzaman, *Lahika e Emirdaut-2* f. 128.

Por fatkeqësisht, nuk po e pasqyrojmë dot bukurinë marramendëse të Islamit.

Në fakt, Islami është në vetvete një gjendje ndryshe. Një besimtar i vërtetë, i impresionon ata që shikojnë rukunë e tij, ua merr mendjen atyre, që shikojnë sexhden e tij, atë që dëgjon përgjërimet dhe shikon gjendjen e tij përballë të Lartmadhëruarit, del nga vetja dhe bie së bashku me të në sexhde. E pra, kur Islami nuk përfaqësohet në këtë mënyrë, as te njerëzit e tjerë nuk ndodh ndonjë reagim. Askush nuk mund të kuptojë bukuritë e pakrahasueshme të namazit duke parë vetëm disa lëvizje formalitare.

Ndikimi është i lidhur ngushtë me marrëdhënien me Allahun

Suksesi dhe arritja e rezultateve të kënaqshme të përpjekjeve në rrugën e Allahut, është shumë e lidhur me vlerësimin dhe pranimin e Tij. Allahu i Lartmadhëruar, nuk i bën ndikues asnjëherë ata që nuk kanë lidhje të forta me Atë. Allahu i jep vlerë vetëm atyre zërave e u jep ndikim atyre veprimeve që janë të lidhura fort me Atë.

Për këtë, shërbyesit e Kur'anit duhet të kërkojnë vlerësimin e duhur të marrëdhënias me Allahun dhe ta dinë mirë që lëvizjet dhe pamjet e jashtme, nuk kanë asnjë vlerë të Allahut i Lartmadhëruar. Siç thuhet edhe në një hadith që Allahu nuk ju vlerëson sipas pamjes së jashtme

as sipas lëvizjeve të zakonit por ju vlerëson sipas emocioneve të zemrës, sipas burimeve ndjesore të çiltra të shpirtit dhe sipas veprave të mbushura me sineritet. E nëse nuk ka një përkthim të këtyre ndjenjave në vepra, nëse asgjë e juaja nuk përmban sineritet nga zemra, të gjitha përpjekjet janë të kota.

Prandaj, për të mos u përballur me qortimin e ajetit “O ju Besimtarë! Përse shpjegoni ato që nuk i bëni!”¹⁹ dhe për të mos mbetur pa përgjigje ndaj pyetjes “Përse, duke mos i zbatuar ato të vërteta që u shpjegoni njerëzve, uleni në gradën e një gënjeshtari dhe po kështu nxini fytyrën e pastër të Islamit?”, shpirtat që i janë dedikuar shërbimit të besimit duhet të përpiqen të jenë më të kujdesshëm në këtë pikë.

Rreth temës në fjalë, do të parashtrojmë tre pika të rëndësishme se si mund të bëhemi heronj të vërtetë të namazit:

Tri kushtet për tu bërë hero i namazit

1. Kur i Dërguari i Allahut (a.s.) na tregon diçka, na fokuson në një qëllim të lartë. Na shpjegon se Xheneti është njëqind gradë dhe se grada më e lartë e tij është Xheneti Firdeus dhe thotë se: “Kur të kërkon Xhenetin nga Allahu Teala, kërkon Xhenetin Firdeus”²⁰ duke na bërë të

19. Sureja Saf, 61/2.

20. Buhari, *ṣṣahih* 4; Tirmidhi, *ṣṣhenet* 4; Ibni Maxhe, *ṣṣuhd* 39.

ditur që qëllimi ynë të jetë gjithmonë shumë i lartë. Për më tepër, përveç kërimit të Firdeusit, na mëson edhe me dua të posaçme se si ta kërkojmë atë. Prej duave të Tij, mësojmë edhe gradën më të lartë të kërkesave siç thotë: “O Allah! Na e mbush brendësinë tonë me dëshirën për të parë Bukurinë Tënde. Na emocionon zemrën tonë me dëshirën për të ardhur tek Ti dhe na ndero neve me shikimin e bukurisë Tënde”, në këtë mënyrë tregojmë që jemi kërkuar të kënaqësisë Hyjnore. Këto dua që na mëson profeti ynë, na orientojnë të jemi kërkuar të më së mirës dhe më së lartës. Gjithashtu, duhet të sillemi qëllimlartë edhe në pikën e kuptimit të namazit. Duhet vazhdimisht t'i kërkojmë vetes të jetë nën gjurmët e namazeve të selefëve (të parëve tanë) dhe vazhdimisht të kërkojmë nga Allahu mbështetjen e Tij për të falur namazin me vetëdije të plotë. Ndoshta secili prej nesh do ishte mirë të thoshte në këtë mënyrë: “O Allah! Më jep të njëjtën ndjesi, kuptim dhe vetëdije namazi, siç ia ke dhënë të Dërguarit Tënd (a.s.). Më bëj që edhe shpirti im të kuptojë namazin siç duhet. Zoti im! Edhe unë dua të falem si Profeti im dhe ta ndjej namazin deri në qelizat më të thella të qenies sime. Dua që asgjë tjetër të mos më hyjë në mendje përveç Teje. Të lutem Ty, o Allah, ma mundëso këtë edhe mua!..”

Të kërkojmë një horizont profetik të tillë namazi, nuk do të thotë se

kërkon profetësinë. Siç kërkojmë që ta marrim shembull në çdo gjë të jetës Profetin tonë, ashtu kërkojmë edhe në këtë pikë. Kjo lloj duaje asnjëherë nuk shkon kot. Nëse jeni këmbëngulës dhe e keni me dëshirë këtë dua, Allahu nuk u mban larg kësaj mirësie. Me dëshirën e Allahut, arrini ta merrni atë që kërkon. Nëse ju bëni një dua të tillë, edhe Allahu i Lartmadhëruar, Mbreti i Përjetshëm, u jep nga Mëshira e Tij e pafund ashtu siç i ka hije Madhështisë së Tij. E pra, të bëhesh njësh me të lartën, të synosh gjithmonë sipër, është përkthimi në vepra i qëllimeve të larta. Edhe në faljen e namazit, njeriu duhet të synojë gjithmonë lart e më lart.

2. Dëshira për të kryer faljen e namazit në nivelet e duhura, kërkon një lloj duaje (lutje) të bërë me gjuhë dhe me vepra. Duaja me vepra në këtë rast, bëhet duke lexuar vepra të ndryshme të shkruara në këtë fushë. Nuk mund të quhet i sigurt ai që dëshiron të arrijë një nivel të lartë në namaz, por që nuk ka lexuar diçka të shkruar rreth kësaj, as nuk ka dëgjuar të mëdhenjtë se ç' thonë dhe as nuk është interesuar ndonjëherë të hedhë një hap përpara. Kështu që, udhëtari i namazit, nuk duhet të neglizhojë pa lexuar, studiuar e medituar mirë mbi artikujt, apo librat e dijetarëve të mëdhenj, të cilët me përjetimet dhe eksperiencat e tyre, spërkasin në zemrat e lexuesve dashurinë për adhurime, i shëtisin ata nëpër

atmosferat e veçanta të namazit dhe i ngopin ndjenjat e tyre.

Një besimtar, sado pak, duhet të mundohet t'i hedhë sy disa herë veprave të shkruara rreth të vërtetave të të Vërtetit, rreth bazave të besimit dhe rreth kuptimeve të adhurimit. Të lexohen mirë dhe të diskutohen veprat e dijetarëve të mëdhenj të Kur'anit dhe krahas këtyre, edhe veprat e atyre, që mundohen të shkruajnë rreth namazit në ditët tona.

3. Të tregohesh këmbëngulës në duatë me vepra dhe me fjalë, të jesh i vendosur dhe i vazhdueshëm në atë që kërkon dhe të ecësh drejt qëllimit tënd pa u pezmatuar aspak, me një durim aktiv, janë kushte të tjera të rëndësishme për të arritur qëllimin. Sevdaja për namazin, nuk pikon menjëherë në zemrën e kërkuesit. Kjo mungesë dëshire apo dashurie, mund të zgjasë disa ditë, disa muaj ose edhe disa vite. Prandaj, është

shumë e rëndësishme të plotësosh të gjitha kushtet e duhura dhe të vazhdosh me të njëjtin zell deri në fund.

Nëse pretendoni të bëheni hero i namazit, nuk duhet të lini pas dore as mënyrën më të vogël, që mund t'ju çojë drejt këtij synimi. Nëse ju vjen diçka që ua ndez dashurinë në zemër, mos u mjaftoni duke e bërë vetëm një herë të vetme, por ta vazhdoni qindra herë. Ndoshta do ju duhet ta lexoni mbi dhjetë herë një libër, ta dëgjoni mbi qindra herë një ligjëratë, të mbani vath në vesh vazhdimisht fjalët e një të dituri për këtë çështje. Kurrë mos u dorëzoni duke thënë “nuk bëhet” dhe mos jini të nxituar. Nuk duhet të harroni se në këtë rrugë, për vite me radhë do të përplaseni nëpër shkëmbinj, do të gurgulloni si ujërat, por çdo herë do të jeni edhe më të pastruar dhe më në fund do t'ia arrini qëllimit.

Botimi i kolanës “Zani i Naltë”
**Vlerësim kompensues për vitet e anatemimit
dhe rëndësia e tij sot**

Mr. Ramadan Shkodra - Dr. Sadik Mehmeti
Bashkësia Islame e Kosovës

Abstrakt

Mungesa për pesëdhjetë vjet e trashëgimisë së revistës “Zani i Naltë”, sikurse edhe e shumë simotrave të saj, që dolën me të ose pas saj, pastaj anatemimi, anashkalimi dhe mohimi i vlerave të saj, si dhe seleksionimi, përbuzja dhe përmimi e cilësimit “si armiq të popullit” të autorëve që kanë shkruar në këtë revistë, përveç se tregon për një përpjekje të ashpër, sistematike dhe të orkestruar të mendimit ideologjik të kohës, për t’i zhdukur dhe për t’i kaluar në harresë vlerat e saj, ajo dëshmon edhe një herë se fjala e mirë, fjala e vërtetë dhe hakikat, është si pema e mirë që rrënjët e saj i ka thellë në tokë, kurse degët i ka lart, shumë lart, dhe e cila, me vullnetin e Zotit, e jep bërëqetin e vet në çdo kohë dhe në çdo moment.

1.
Kohë më parë, nga tri komunitetet tona islame Tiranë-Prishtinë-Shkup, u botua në dhjetë vëllime kompleti i revistës “Zani i Naltë” (1923-1939). Me botimin e kësaj ndërmarrjeje të përbashkët, tri komunitetet tona

islame, pa mëdyshje, realizuan dhe konkretizuan një vepër monumentale për historinë, kulturën dhe qytetërimin shqiptar, në njërën anë, kurse për vlerat që bart dhe përmbajtjen që kjo revistë ka, lexuesit shqipfolës i ofruan një udhërrëfyes të rëndësishëm për kohët e sotme, në anën tjetër.

Meqenëse për “Zani i Naltë”, për rëndësinë dhe kontributin e tij të gjithmbarshëm, që nga koha kur u botua e këndeje, më pastaj për vlerat dhe rolin e kësaj reviste në formimin e vetëdijes dhe mendimit fetar dhe kombëtar të shqiptarëve, për anatemimin dhe harresën që iu bë kësaj reviste dhe autorëve që shkruan në të, tashmë studiues të ndryshëm shqiptarë e të huaj, të besimit islam e të besimeve të tjera, me studime e shkrime të shumta, në simpoziume e konferenca shkencore, kanë paraqitur analiza, kanë nxjerrë konkluzione, kanë dhënë gjykime dhe kanë shprehur vlerësime. Ne na ngelet të shprehim admirimin, vlerësimin dhe mirënjohjen tonë për themeluesit, drejtuesit, bashkëpunëtorët dhe për të gjithë ata që kanë kontribuar për themelimin, rritjen, përhapjen dhe zhvillimin e “Zani i Naltë”.

Shprehim admirimin, vlerësimin dhe mirënjohjen tonë për gjithë ata dijetarë vepërmirë, që me nxjerrjen e “Zani i Naltë”, pikërisht në një fazë të krizës institucionale e morale që po përjetonte përgjithësisht bota shqiptare dhe veçmas besimtarët myslimanë, si pjesë dërrmuese e saj, dhe në një kohë të përpjekjeve për të krijuar një realitet të ri shtetëror, trasuan fuqishëm, qëndrueshëm, drejt dhe saktë, rrugën që vazhdon të japë frytet e saj edhe sot e kësaj dite. Kjo, sepse me “Zani i Naltë” nisi, - për së mbari, - botimi i publicistikës islame në gjuhën shqipe

dhe jo vetëm, por “Zani i Naltë” shërbeu edhe si prelud për fillimin e veprimtarisë botuese islame në gjuhën shqipe.

Kurse ata që në faqet e “Zani i Naltë”, vunë firmën e tyre, gjithmonë do të jenë të respektuar e të vlerësuar dhe kurrë s’do të harrohen. Dhe s’ka si të harrohen emra si: Haxhi Vehbi Dibra, Hafiz Ali Korça, Ismail Maçi, Sali Vuçiterni, Ferit Vokopola, Haki Sharofi, Jonus Bulej, Mehdi e Mithat Frashëri, Nebil Çiko, Shefqet Muka, Sadik Bega... dhe gjithë ajo plejadë intelektualësh që shkëlqyen si frymëzues, si pararendës dhe si bartës të ndryshimeve të mëdha shoqërore, duke i dhënë kahe e drejtime mendimit teologjik islam shqiptar dhe rrjedhave shoqërore, duke kryer në mënyrë të shkëlqyeshme detyrën dhe misionin e tyre. Dhe jo vetëm kaq, por këta intelektualë u vunë në mbrojtje të Islamit, mësimave dhe vlerave të tij, duke polemizuar e debatuar me individë e grupe njerëzish, të cilët në shtypin e kohës, keqinterpretonin, shpifnin e intrigonin kundër fesë islame dhe pasuesve të saj.

2.

Ribotimi i kompletit të revistës “Zani i Naltë”, për ne sot dhe brezat që do të vijnë, përveç të tjerash, është një argument dhe dëshmi shtesë se Allahu xh.sh., me Madhërinë e Tij, kurrë nuk lejon që një punë e nisur në Emër të Tij të humbasë e

të harrohet, pavarësisht përpjekjeve dhe dëshirave njerëzore.

Mungesa për pesëdhjetë vjet e trashëgimisë së revistës “Zani i Naltë”, sikurse edhe e shumë simotrave të saj, që dolën me të ose pas saj, pastaj anatemimi, anashkalimi dhe mohimi i vlerave të saj, si dhe seleksionimi, përbuzja dhe përçmimi e cilësimi “si armiq të popullit” të autorëve që kanë shkruar në këtë revistë, përveç se tregojnë për një përpjekje të ashpër, sistematike dhe të orkestruar të mendimit ideologjik të kohës, për t’i zhdukur dhe për t’i kaluar në harresë vlerat e saj, ajo dëshmon edhe një herë se fjala e mirë, fjala e vërtetë dhe hakikat, është si pema e mirë që rrënjët e saj i ka thellë në tokë, kurse degët i ka lart, shumë lart, dhe e cila, me vullnetin e Zotit, e jep bereqetin e vet në çdo kohë dhe në çdo moment.

Kështu, me krijimin e rrethanave të reja dhe shkuarjen në pakthim të ish-sistemit dhe ringritjes së komuniteteve fetare, nisi një periudhë e re, jo vetëm për “Zani i Naltë” dhe revistat e tjera islame që kishin dalë dikur, por filloi gjithashtu periudha e rivlerësimit dhe e vendosjes së tyre në vendin ku e meritojnë. Këtë e dëshmon edhe projekti fillimisht për të ripërtërirë emrin “Zani i Naltë” dhe më pas edhe me botimin e kompletit të kësaj reviste dhe risjelljen e saj në këtë mënyrë dhe në tërësinë e saj para lexuesve, studiuesve dhe të interesuarve të tjerë.

Ribotimi i kompletit të “Zani i Naltë” në dhjetë vëllime, përveç të tjerash, është i rëndësishëm dhe merr vlera ku e ku më të mëdha, për mendimin tonë, edhe për këto arsye:

- Sepse u krijon mundësi studiuesve të fushave të ndryshme, dhe më së shumti studiuesve të fesë, historisë, qytetërimit, letërsisë etj., që më me kompetencë t’i qasen trashëgimisë sonë të shkruar dhe krijimtariisë që na kanë lënë brezi i “Zani i Naltë”.

- Sepse përmbajtja e revistës “Zani i Naltë” dhe tematika e trajtuar me kompetencë në rubrikat e larmishme nga fusha e tefsirit, hadithit, fikhut, filozofisë, moralit, letërsisë, sociologjisë etj., është tregues i qartë i një materiali shumë të pasur dhe me interes për studentët e fakulteteve tona islame në Prishtinë, Shkup dhe Tiranë, të cilët, mendojmë, “Zani i Naltë” duhet ta kenë literaturë të obligueshme gjatë studimeve të tyre. Artikujt dhe studimet e botuara në faqet e “Zani i Naltë”:

- do t’i ndihmojnë studentët e këtyre fakulteteve, përveç për njohjen e bazave dhe burimeve të Islamit - Kur’anit dhe Hadithit, edhe për të sqaruar pozicionin islam rreth tyre,

- do t’i ndihmojnë për mësimin e historisë dhe qytetërimit islam,

- do t’iu shërbejnë për ngritjen e horizonteve fetare, kulturore e qytetare,

- do t'i nxisin dhe do t'i inkurajojnë ata për t'iu përgjigjur detyrave reformuese, emancipuese progresive, shoqërore, arsimore e kulturore në përputhje me kërkesat e kohës, me objektivat aktuale e të perspektivës,

- do t'i ndihmojnë në heqjen e disa dyshimeve dhe nuk do të lejojnë futjen e mendimeve dhe ideve të huaja për ne dhe për trashëgiminë e Islamit në këto troje.

• Përcaktimi i studentëve të fakulteteve tona islame për punimet e tyre të diplomës nga fushat e sipërpërmendura, do të na mundësojë që rolin dhe rëndësinë e “Zani i Naltë” ta njohim jo vetëm nga aspekti historik, por edhe nga ai bashkëkohor dhe aktual, sepse ndonëse “Zani i Naltë” është botuar dekada më parë, përmbajtja e shkrimeve të saj ka vlerën e e njëllotë edhe në kohën e sotme. Janë shkrime shumë aktuale, të rëndësishme e të nevojshme, sikurse të jenë thënë sot dhe sikur të jenë shkruar për ditët e sotme.

• Sepse duke vështruar faqet e “Zani i Naltë”, do të njihemi edhe me rolin e ulemasë sonë në rrafshin kombëtar dhe me kontributin e tyre domethënës dhënë çështjes së kombformimit dhe shtetformimit. Ky kontribut ka vazhduar edhe gjatë gjithë periudhës së daljes së revistës “Zani i Naltë”, duke ngulitur te lexuesit e saj, me shkrime të zhanreve të ndryshme, ndjesinë kombëtare

dhe respektin për institucionet e shtetit.

• Sepse duke lexuar “Zani i Naltë”, do të shohim se ai ka ndihmuar që në mes të shqiptarëve të ekzistojë ndjenja e dashurisë, harmonisë, tolerancës e mirëkuptimit me anëtarët e besimeve të ndryshme, vlerë për të cilën krenohemi të gjithë. Pa mëdyshje, një kontribut të madh në ngulitjen dhe kultivimin e kësaj vlere kombëtare patën autorët që shkruan në faqet e “Zani i Naltë”.

• Ndërsa vjershat dhe poezitë e botuar në faqet e “Zani i Naltë”, duhet të jenë patjetër pjesë e repertorit të korit të nxënësve të medreseve tona, sepse vështirë të thuhet se mund t'i këndohet më me shpirt dhe më mirë Kur'anit, Pejgamberit a.s., Atdheut, Flamurit etj., se ç'u është kënduar në këtë revistë dhe simotrat e saj “Kultura islame”, “Njeriu” etj.

3.

Në fund, edhe një herë përsëritim finalizimin e projektit të tri komuniteteve tona islame për “rikthimin” e “Zani i Naltë” dhe atë t'ua ofrojë masës së gjerë të lexuesve.

• Shpresojmë dhe urojmë që iniciativa dhe ndërmarrje të tilla nga tri institucionet tona të ketë edhe në të ardhmen me botimin e kompletit të veprave të autorëve të traditës, si p.sh. të Hafiz Ibrahim Dallit, Hafiz Abdullah Zëmlakut, Ferit Vokopolës, Haki Sharofit, Haxhi Sherif Ahmetit, pastaj botime të

antologjive të poezisë së traditës etj., sepse me ribotimin e tyre, jo vetëm që do të shlyenim, deri në njëfarë mase, borxhin që kemi ndaj të parëve tanë, por botimi i tyre, na thotë mendja, do të bënte të njëjtin shërbim që kanë bërë kur janë botuar për herë të parë. Janë jashtëzakonisht me rëndësi, për shkak të aktualitetit nëpër të cilin po kalojmë si popull dhe si shoqëri, që të ribotohen vepra sidomos nga fusha e akaidit, e fikhut dhe nga lënda e kulturës fetare në të cilat kemi një material shumë të pasur nga e kaluara jonë. Pse të mos botohen, fjala vjen, veprat: *“Dhuntie Ramazani”*, *“Besimet e myslimanvet”*, *“Libri i së falmes”* etj., të Hafiz Ibrahim Dallit, *“Ilmi halë”* i Shevqet Mukës, *“Dijeni besimtare praktike”* - për disa nivele, botim i Këshillit të Naltë të Sheriatit, *“Mësime feje”* i Ahmed Hamdiut, botim i Këshillit të Naltë të Sheriatit, *“Islamizmi”*, botim i Këshillit të Naltë

të Sheriatit, *“Edukata morale”* për disa nivele, nga Haki Sharofi, dhe shumë të tjera.

- Është koha, mendojmë, që të tria komunitetet tona islame, të kenë edhe një revistë fetare, filozofike dhe kulturore islame të përbashkët dhe me karakter gjithëkombëtar, që do të vazhdonte traditën e nisur nga brezi i “Zani i Naltë” e këndej.

Ndonëse jemi shumë admirues për punën që na kanë lënë të parët, megjithatë mundemi dhe duhet të vazhdojmë traditën e tyre, nëse dëshirojmë që edhe ata të jenë të kënaqur me ne dhe në mënyrë që brezat që do të vijnë pas t’i bëjmë të ndihen në borxh për të na admiruar, ashtu siç ne po i admirojmë të parët tanë.¹

1. Kumtesë e mbajtur në konferencën shkencore “Zani i Naltë”- një shekull në shërbim të dijes”, mbajtur në Prishtinë, më 16 qershor 2015.

Jepjani punëtorit pagën e tij, para se t'i thahet djersa e tij

Ilir Akshija, M.D., M.Sc.
Qendra Spitalore Universitare, “Nënë Tereza”,
Departamenti i Statistikës, Tiranë

Abstrakt

Studimi i sistemit bankar dhe krabasimi me praktikat islame, apo edhe kundërvënia në momente të caktuara është e zakonshme në literaturën ekonomike islame. Një temë që nuk trajtohet rutinë është mënyra e pagesave të punëtorëve dhe vlerësimi i skemave përkatëse sipas një modeli të bazuar në Legjislacionin Islam. Flukset e jashtëzakonshme në botën e financave me të drejtë e kanë vendosur ekonomistin mysliman në pozitë mjaft të vështirë. Duke qenë i detyruar të respektojë kontratat, të jetë në kërkim të fitimit dhe ky të jetë ballall, ai është tejet i ngarkuar në përgjegjësi. Prandaj fokusi kryesor është përqendruar në transaksionet bankare dhe modelet tregtare, duke lënë pas dore, dhe në një farë mënyrë, ka rënë pre e imitimit të modeleve të gatshme për sa i përket sistemit të pagesave të punonjësve. Në këtë diskutim ne kemi ngritur pyetjen nëse pagesat e punonjësve që realizohen një herë në muaj a mund të qubën një borxh i paguar me vonesë apo ndonjë nënkategori e fajdes, po ti referohemi hadithit për pagesën e menjëhershme të punëtorit! Paga e ditës së parë të muajit kalendarik merret në të njëjtën kohë me pagën e ditës së fundit, duke mos marrë parasysh aspektin kohor të përfundimit të punës që te punëtori i zakonshëm është dita e punës. Pasojat e vonesës së pagesave janë të njohura nga aspekti praktik, madje edhe marrja e pagës mujore në kohën e caktuar shoqërohet me rritje të kriminalitetit, konsumit të drogave, alkoolit dhe krijon mundësinë e marrjes së kredive afatshkurtra me kamatë të lartë. Në vazhdim hipoteza kërkon një përgjigje nga ekspertë të fikut, e ndoshta diskutim ndërdisiplinor.

Fjalë kyçe

rrogë, punë, mall, pagesë, kohë, borxh, fajde

“Jepjani punëtorit (që punon me mëditje) pagën e tij, para se t’i thahet djersa e tij”. Ky është versioni i këtij hadithi i përkthyer në shqip dhe në vazhdim është hadithi në anglisht sipas një prej përkthimeve të shtëpisë botuese Darussalam. “It was narrated from Abdullah bin Umar that the Messenger of Allah (pubh) said: ‘Give the worker his wages before his sweat dries’ (Sahih)”. [Sunan Ibn Mâjah (2443)].¹ Na ka treguar Abdullah b. Umeri se i Dërguari i Allahut (a.s.) ka thënë: **“Jepjani punëtorit pagën e tij, para se t’i thahet djersa e tij.”** (Sahih) [Sunan Ibn Mâjah (2443)]

Ky është një hadith që më ka ardhur ndërmend në kontakt me një person të caktuar. K është një punëtor i zakonshëm që punon në spital edhe jashtë orarit për një firmë të nënkontraktuar për mirëmbajtje dhe shërbime të tjera. Zakonisht këtë detyrë e ka bërë një strukturë brenda spitalit me sukses të plotë, por, tani, i është deleguar një firme private që ta realizojë me sukses edhe më të plotë. Jashtë ironisë së merituar mund të them që K pothuajse sa herë e takoj përmend Allahun xh.sh. dhe besimin që ka. Ky njeri merr një rrogë mujore punëtori dhe mban me të veten, gruan

dhe dy fëmijë. Firma në shumë raste nuk e jep rrogën për dy apo tre muaj rresht duke treguar që kjo zgjidhje është një dështim i plotë, të paktën për sistemin e pagesave, në krahasim me kohën para kontraktimit të saj kur punëtorët i merrnin rrogat një herë në muaj, në shtet, në mënyrë të rregullt. Merr borxh dhe sa herë merr rrogën e vonuar menjëherë paguan borxhet dhe likuidon listën e ushqimeve të dyqani i lagës. Kjo është një situatë e njohur dhe aspak e veçantë për punëtorët e ndershëm në Shqipëri. Hadithi më erdhi ndërmend lidhur me pagesën pa u tharë djersa, nëse ka kuptim literal apo tjetër.

Po bëj një rishikim të komponentëve të hadithit edhe pse në pamje të parë duket krejt i thjeshtë. Punëtori, paga dhe djersa janë tre komponentët e ndërlidhur me njëri-tjetrin dhe që kërkojnë sqarim. Në një përkthim në gjuhën shqipe, fjalën *punëtor-i* e gjej të përkthyer, të shoqëruar në kllapa me shprehjen ‘që punon me mëditje’. Në përkthimin në anglisht nuk ka një përkthim të tillë nga arabishtja, thuhet vetëm ‘the worker - punëtorit’. E dimë se çfarë është një punëtor me mëditje. Po sa punëtor me mëditje ka sot? Pak ose aspak! Vetëm disa punëtorë që rrinë gjithë ditën duke pritur t’i marrë dikush në punë ose disa të tjerë, që i kanë shpërndarë numrat e telefonit dhe shërbimet që ofrojnë nëpër muret e pallateve. Ky është një numër i papërfillshëm në një qytet të madh si Tërana. Të tjerët, të punësuar në shtet ose në privat, e marrin rrogën


1. Ibn Majah, M. Y. A. A. A. “Sunan Ibn Majah.” *Arabic-English by Nasiruddin al-Khattab Translation. Saudi Arabia: Darussalam* (2007), 399.

një herë në muaj. Përveç kësaj, nëse bëhet fjalë vetëm për punëtorë të tillë me mëditje, me të cilët ke kontakt vetëm një herë dhe të rastësishëm, atëherë pagesa sigurisht që është e menjëhershme ose do i mohohet fare dhe kjo mund të quhet pastaj grabitje e mundit të tjetrit, pra nuk bëhet fjalë për vonesë të pagesës siç kuptohet nga hadithi. Ka pasur punëtorë me mëditje që janë marrë çdo ditë nga pronarë dhe kjo mund të ketë qenë edhe rregull, por po mundohem ta sjell vlerën e hadithit në Tiranë dhe në vitin 2016. Prandaj mendoj që përfshirja e termit ‘me mëditje’ dhe zgjerimi i përfshirjes edhe të punëtorëve të tjerë, më duket me vend duke pranuar për më të saktë përkthimin në anglisht.

Lidhja e punëtorit me tharjen e djersës si fenomen i shkaktuar nga aktiviteti fizik mund të jetë figurative, pra të bëhet pagesa e menjëhershme, ose literal. Nuk them që tharja e djersës të merret si standard kohor. Gjëja e parë që të shkon në mend është që djersitja të merret si standard për aktivitete të caktuara që kanë aktivitete fizik, ose më mirë për aktivitete që nuk konsiderohen si punë mendore. Ndarja e punës në punë fizike dhe mendore është e mirënjohur për shoqërinë tonë, dhe gjithashtu e pranuar në diskutimin tonë. Por, hadithi, nëpërmjet shprehjes *‘para se t’i thahet djersa’*, fut në diskutim edhe komponentin kohë, meqenëse nga djersitja deri te tharja e djersës kalon njëfarë kohe. Përderisa për realizimin e një pune kërkohet gjithmonë kohë,

nuk është e paarsyeshme të diskutohet rreth saj, gjithashtu edhe koha nga mbarimi i punës deri në marrjen e pagesës. Koha është e rëndësishme. Allahu xh.sh. betohet në Kur’an: *‘Pasha kohën!’*.² Duke u nisur nga ky princip në vazhdim hipoteza jonë merr në konsideratë ndarjen e punës në mendore (intelektuale) dhe fizike, dhe në punë me kohë të caktuar dhe me kohë të pacaktuar. Punë me kohë të caktuar është konsideruar çdo lloj pune që koha e përfundimit të saj është paracaktuar që në lidhjen e kontratës ndërmjet punëdhënësit dhe punëmarrësit. Figura e mëposhtme tregon në mënyrë skematike kombinimet ndërmjet këtyre dy kategorizimeve dhe tregon për secilën nga katër kombinimet raste konkrete të aplikimit.

Fig. 1 Paraqitje skematike e konceptit të punës sipas natyrës së saj dhe kohës së mbarimit.



2. Kur’an, El Asr, 1. Përkthimi me komentim i H. Sherif Ahmetit. OPGBG – “Rilindja” – Prishtinë, 1990, 732.

Ashtu si në momentin kur caktohet koha e punës, po ashtu edhe kur nuk caktohet, pagesa bëhet pas përfundimit të saj. Puna me kohë të caktuar ka karakteristikë kryesore akumulimin e aktivitetit mbi blloqe aktiviteti të përfunduar që rreshtohen njëri pas tjetrit. Në fund të një dite pune mund ta matim me saktësi numrin e tullave të prodhuara nga një punëtor dhe gjithashtu edhe për rastet kur puna është e natyrës mendore. Një mjek apo një mësues praktikisht e mbaron me sukses apo jo ditën e punës sipas kontratës dhe vlerësimi i cilësisë së tyre zakonisht shpërblehet jo me rrogë, por me bonuse. Puna e shkrimtarit dhe kërkuesit ka karakteristika të tjera. Nuk mund t'i kërkohej një shkrimtari të shkruajë 0.32% të romanit të tij. Romani nuk mund të vlerësohet madje edhe pasi të jetë shkruar e botuar, por vetëm pasi të jetë përballur me publikun dhe kritikën e ndoshta, tamam-tamam, shumë vite pasi autori të ketë ndërruar jetë. Një kërkues mund të thotë që i është afruar zbulimit apo jo, por në fund mund të thotë që e ka realizuar ose jo. Ndërkohë, tullat në fund të ditës i kemi numëruar, kemi skarcuar ato me cilësi të papranueshme dhe pas kësaj punëtori konsiderohet se e ka realizuar kontratën ditore dhe nuk ka asnjë detyrim përkundrejt punëdhënësit.

Koha e pagesës për zanatet me kohë të pacaktuar varet nga kontrata dhe del jashtë diskutimit tonë. Ndërsa zanatet me kohë të caktuar, qofshin

punë fizike apo mendore ndjekin modelin në vazhdim. **Rroga merret një herë në muaj prandaj paga për ditën e parë të muajit merret muajin pasardhës, pra pas 30 ditësh, për ditën e dytë pas 29 ditësh e kështu me radhë deri ditën e fundit të muajit pagesa për të cilën bëhet pothuajse në kohë reale me mbarimin e punës, nëse rroga merret menjëherë në fillim të muajit pasardhës. Pavarësisht se është e sanksionuar në kontratë në këto raste kemi një kohë që zgjat nga 1 në 30 ditë deri në marrjen e shpërblimit që i takon të punësuarit nga koha e mbarimit të njësisë së punës.** Të ardhurat në formë rroge mujore duhen menaxhuar në mënyrë të planifikuar për mbulimin e nevojave mujore për jetesë dhe pagesave të borxheve dhe kredive apo krijimin e kursimeve. Para se të vazhdojmë më tej, duhet të kujtojmë që paga ditore ka qenë një mënyrë pagese e mirënjohur dhe të gjithë e njohim pagën javore të SHBA-ve të fillimshkullit të XX-të, apo pagën dyjavore që ne vetë e kemi marrë deri në fund të shekullit të XX-të. Pra diskutimi i kohës së pagës është një nocion shumë i ndryshueshëm dhe nuk ka pse të mos mbetet i tillë, i ndryshueshëm.

Perceptimi i pagës mujore

Tani, për një moment, të ndalemi te perceptimi që ka personi që punon në sektorin shtetëror për pagën reale. Paga reale është paga e axhustuar për

inflacionin duke treguar edhe fuqinë blerëse të mallrave dhe shërbimeve. Mund të shohim se çfarë ka ndodhur konkretisht në vitin 2015, sipas INSTAT. Ndryshimi mesatar vjetor i Indeksit të Çmimeve të Konsumit në vitin 2015 është 1,7 %, ndërsa Ndryshimi vjetor i Pagës Mujore në sektorin shtetëror (%) duke bërë që ndryshimi i pagës reale të jetë 0.1%.³ Ndërkohë që tabela e marrë po nga INSTAT e tregon 0%.

3. “Pagat Dhe Kosto E Punës.” (2016): n. pag. INSTAT. Web. 06 July 2016. <<http://www.instat.gov.al/al/themes/pagat-dhe-kosto-e-pun%C3%ABs.aspx?tab=tabs-5>>.

Tab. 1 Paga mesatare mujore në sektorin shtetëror, Rritja reale e pagës në sektorin shtetëror, dhe ndryshimi i pagës reale, 2000-2015


Burimi i informacionit: Të dhëna administrative⁴

Fig. 1 Paga mesatare mujore në sektorin shtetëror, Rritja reale e pagës në sektorin shtetëror, dhe ndryshimi i pagës reale, 2000-2015

Nga sa shihet më sipër, nuk është e lehtë që një individ të ndjekë

4. “Shqipëria Në Shifra, 2015.” (2016): 23. INSTAT. Web. 06 July 2016. <http://www.instat.gov.al/media/330710/shqiperia_ne_shifra__15.pdf>.

Emërtimi	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015
Paga mesatare mujore (në lekë)	14,963	17,218	19,659	21,325	24,393	26,808	28,822	33,750	36,537	40,874	43,625	46,665	50,092	52,150	53,025	54,000
Ndryshimi vjetor i pagës mujore në sektorin shtetëror (%)	17.7	15.1	14.2	8.5	14.4	9.9	7.5	17.1	8.3	11.9	6.7	6.9	7.3	4.1	1.7	1.8
Ndryshimi i pagës reale (%)	17.7	11.6	8.1	6	11.2	7.3	4.9	13.8	6	8.1	3	3.4	5.2	2	0.1	0



ndryshimet në planin ekonomik dhe raportet përfundimtare vetëm sa mund të konfirmojnë perceptimet e tyre. Zakonisht qytetari i zakonshëm arrin të perceptojë mbulimin e konsumit të tij në raport me të ardhurat mujore. Pas pagesave mujore si drita, ujë dhe taksa mbetet një shumë që duhet ta ndajë për nevoja ditore. Pyetjes praktike se sa është konsumi ditor për familjen pasi hiqen këto pagesa nuk arrin t'i përgjigjet kushdo.

Po të marrim rastin e diskutuar në fillim, kemi një familje me katër anëtarë dhe një të ardhur mujore prej 30,000 Lekë (244 USD) ose 250 Lekë (2.03 USD) për person në ditë. Kur personi që jeton me këtë standard është vazhdimisht i vetëdijshëm se ka në dispozicion 250 Lekë në ditë për frymë, pa hequr këtu pagesat mujore të zakonshme, edhe reagimi i tij në kërkesat për ndryshim të të ardhurave ose rritjes së çmimeve, qoftë edhe minimale do të jetë i ndryshëm.

Sa më i përgjegjshëm të jetë qytetari, aq më me drejtësi do të reagojë ndaj politikës dhe tregut. Një studim që merr përsipër të tërheqë vëmendjen e konsumatorëve rreth marrjes së overdrafteve dhe i shoqëroi pyetësorët me fjalë ngacmuese të problematikës së borxhit, si kontroll i shpenzimeve, monitorim i balancës bankare dhe tarifa bankare u shoqërua me rënie të fortë të marrjes së borxhit në formë overdrafti, gjë që tregon më së miri rëndësinë e të qenët i mirinformuar në marrjen e

vendimeve.⁵ Kërkesa për punësim, rritje rroge apo ndryshim politikash, madje edhe me protesta, do të ishte përgjigjja e pritshme. Sigurisht që njerëzit që jetojnë me këto të ardhura nuk kanë pse presin këto konkluzione që të perceptojnë skamjen në të cilën jetojnë, por të ndërgjegjësuar, mund ta përballojnë më lehtë dhe të drejtohen në përmirësimin e situatës. Vlera e të ardhurave e treguar më sipër nuk është larg prej asaj të varfërisë ekstreme. Varfëri ekstreme konsiderohet, sipas definicionit të Bankës Botërore, shifra prej 1.90 USD në ditë *per kapita*.⁶ Një pagë ditore, neto, mund të jetë një pasqyrë më e mirë e realitetit se paga mujore. Nëse pagën do ta konsideronim si një ndërfaqe ndërmjet fitimit dhe konsumit, paga ditore do të jepte një perceptim më real të nevojave ditore sesa ajo që merret një herë në muaj.

Perceptimi i realizimit të pasurisë gjithashtu varet nga mënyra se si përftohet ajo. Kështu që kategori të ndryshme ekonomike kanë perceptime krejtësisht të ndryshme të pasurisë. Në një ekonomi globale ku pasuria gjenerohet në shumë mënyra të tjera, të ndryshme nga ajo tradicionale

5. Stango, Victor, and Jonathan Zinman. "Limited and varying consumer attention evidence from shocks to the salience of bank overdraft fees." *Review of Financial Studies* (2014): hhu008.

6. World Employment and Social Outlook 2016: Transforming Jobs to End Poverty. Geneva: International Labour Organization, 2016. Employment / Labour Policy / Poverty Alleviation. Pdf.

e treguar nëpërmjet binomit pagë/punë, pra nëpërmjet zhvlerësimit të këtij modeli dhe fitimit të pasurisë nëpërmjet përdorimit të teknologjisë edhe perceptimi është rrënjësisht i ndryshëm.⁷

Mundësia për të planifikuar dhe abuzuar... dhe bankat në pritë

“Pse nuk merr borxh më tepër, por vetëm për një apo dy ditë?”

“Sepse kaq shkollë kam, sepse kështu më bie më mirë.”

Ky dialog i shkurtër është një nga shtysat e këtij diskutimi. Pamundësia për të planifikuar nuk është turp. Kujtdo mund t'i qëllojë të jetë i paaftë të planifikojë apo të dështojë në planifikim. Shqiptarët nuk mund të futen te planifikuesit e mëdhenj pas eksperiencave traumatike të firmave piramidale. Një investim mund të jetë i suksesshëm ose jo dhe aftësia për të ndërtuar një strategji të suksesshme është kyç. Në rastin e mësipërm, që nuk duhet të jetë i rrallë në popullatën shqiptare, duhet të pranojmë faktin që edukimi dhe aftësitë që kërkohen për planifikim është e pamundur të përmirësohen shpejt, madje mund të jetë edhe e pamundur. E vetmja mënyrë është që, përderisa të arrihet një nivel edukimi më i mirë, kësaj pjese të shoqërisë t'i ofrohen mekanizma më të afërt planifikues që i përshtaten atyre dhe lehtësojnë menaxhimin

e situatës ekonomike, tashmë të vështirë. Në terma praktikë, thjeshtimi i mekanizmave të planifikimit do të ishte i dobishëm, si p.sh., reduktimi i segmentit kohor që duhet planifikuar dhe siç e hasim në mënyrë eksplicite në dialogun e mësipërm.

Ky është rasti më i mirë i mundshëm, por kur këtij problemi i shtohen edhe abuzimet, pa frikë, krijohet skenari i një drame, të cilën e shohim çdo ditë në format e saj më të shëmtuara. Abuzimi mund të jetë me alkool, me droga, me lojëra fati dhe pa frikë mund të themi që konsumi i tyre shtohet në ditët e rrogave, sidomos në shtresat e shoqërisë, të cilat janë të privuara nga të mirat materiale, këto fenomene janë edhe më të shtuara. Duke kërkuar në literaturën mjekësore nuk është e vështirë të gjenden studime që konfirmojnë rritjen e abuzimeve në ditët e marrjes së rrogave. Zakonisht alkooli konsumohet jo për çdo ditë, por sidomos me të abuzohet në raste familjare, fundjava, ditë rrogash dhe festa.⁸ Po ashtu konsumi i drogave ndjek të njëjtat linja. Punonjës të shëndetësisë, të policisë dhe shërbimeve sociale, janë të bindur se grupet e personave me ndihmë sociale dhe probleme abuzimi me drogat, pasi u vihen në dispozicion sasi relativisht të mëdha parash, u drejtohen më tepër drogave duke sjellë rritje të sëmundshmërisë dhe vdekshmërisë.

7. McMichael, Phillip. “World-systems analysis, globalization, and incorporated comparison.” *Journal of world-systems research* 6.3 (2015): 668-689.

8. Demers, Andree, Robin Room, and Chantal Bourgault. “Surveys of drinking patterns and problems in seven developing countries.” (2000).

Policët tregojnë se trafikantët e drogës i mbushin rrugët me ‘mall’ pak ditë para marrjes së ndihmës ekonomike.⁹ Gjithashtu i pandashëm është problemi i lojërave të fatit, i cili, kur shoqërohet me vështirësi financiare, sjell rritjen e kriminalitetit.¹⁰

Deri tani kemi parë një qytetar me vështirësi në planifikimin e buxhetit dhe i rrezikuar nga fenomenet e abuzimit. I gjendur në vështirësi ai drejtohet për ndihmë financiare nëpërmjet borxhit tek të afërmit dhe miqtë, marrjes së borxhit në bankë dhe në pak raste edhe kriminalitetit. Për sistemin bankar, një person i tillë është një klient potencial, dhe dhënia e kredisë, llogaritet sipas mundësisë që ai ka për të paguar, pra e ardhura e tij e vetme, rroga, dhe interesit që është aq më i lartë sa më në vështirësi të jetë subjekti. Një sistem i tillë kreditimi që shfrytëzon këto dy karakteristika të individit janë overdraftet dhe të ashtuquajturat ‘payday loans – kreditë e ditës së pagës’. Sidomos kreditimi sipas modelit të dytë, ose *payday lending* ka lulëzuar në dekadat e fundit sidomos në vendet e zhvilluara.¹¹ Këto janë

borxhe me afat të shkurtër, interes të lartë dhe kanë si garanci rrogën. Sistemet e reja të bankimit elektronik janë në rekomandim që i lehtëson shumë këto procedura.¹² Madje personat që nuk kanë një llogari bankare quhen ‘*unbanked – të pabankë*’, megjithëse nuk përdoret si term pezhorativ, por vetëm për të treguar një kondicion të caktuar.¹³ E gjithë kjo situatë, mund të quhet pa frikë si kreditim grabitqar, aq më tepër kur shifrat tregojnë se në SHBA, 80% e kërkuesve për këtë lloj kredie nuk kanë fare para në kartat e tyre të kreditit. Ky segment i industrisë së bankimit ka filluar në fund të viteve ‘90, duke pasur në vitin 2012, 12 milionë amerikanë përdorues të këtij shërbimi dhe 50 miliardë USD aktivitet^{14, 15}. Në fund të këtij paragrafi do të kisha vetëm një pyetje: Ku do të rreshtohej një bankë nëse ka tre

world it would be great if they didn’t exist’: How Australians experience payday loans.” *International Journal of Social Welfare* 24.1 (2015): 37-47.

12. Khanna, Seema. “Customers Satisfaction and Governance-A Factor Analysis in Banking Sector of India.” *The International Journal of Business & Management* 3.6 (2015): 9.

13. Valenti, Joe. “Expanding Financial Access Through Mobile Banking.” *Center for American Progress* (2014).

14. Carrell, Scott E., and Jonathan Zinman. “In Harm’s Way? Payday loan access and military personnel performance.” (2008).

15. Bhutta, Neil, Paige Skiba, and Jeremy Tobacman. “Payday loan choices and consequences.” *Journal of Money, Credit and Banking* 47.2-3 (2015): 223-260.

9. Verheul, Glenn, Sharon Manson Singer, and James M. Christenson. “Mortality and morbidity associated with the distribution of monthly welfare payments.” *Academic emergency medicine* 4.2 (1997): 118-123.

10. Lind, Kalle, Juha Kääriäinen, and Sanna-Mari Kuoppamäki. “From problem gambling to crime? Findings from the Finnish National Police Information System.” *Journal of Gambling Issues* (2015): 98-123.

11. Banks, Marcus, et al. “In a perfect

variante për pagesën e punonjësve, në variantin e pagesës ditore, javore apo në atë mujore?!

A është puna mall?

Puna nuk është mall. Organizata Botërore e Punës nuk e konsideron si të tillë. Duhet mbajtur parasysh trajtimi i atij që punon si qenie njerëzore, duke e trajtuar me respekt dhe me dinjitet. Megjithatë, debati nëse puna konsiderohet mall apo jo vazhdon të ekzistojë. Në rastin më të mirë, në shoqërinë që respekton dinjitetin njerëzor, prapë kemi një treg pune dhe puna mendore apo fizike kanë një çmim. Këtë diskutim e quaj të nevojshëm sepse nuk e quaj të arsyeshme të reduktohet qëndrimi i Profetit (a.s.) ndaj punës dhe punëtorëve në përgjithësi te rasti i punëtorit me mëdijtje dhe as të zgjidhet një situatë bashkëkohore vetëm me anë të një hadithi. Objektivat fetarë mbeten të pandryshueshëm, por një punëtor i shekullit të VII-të është i ndryshëm nga një punëtor i shekullit të XXI-të.

Me gjithë definicionet e mësipërme, shikojmë që terminologjia e përdorur për mallrat e zakonshme dhe punën është pothuajse e njëjtë. SHBA e kanë konsideruar të nevojshëm sanksionimin e faktit që puna nuk është mall dhe artikull për shitblerje nëpërmjet të ashtuquajturit ‘Clayton Act’, të vitit 1914.¹⁶

16. Witte, Edwin E. “The doctrine that labor is a commodity.” *The Annals of the American Academy of Political and Social*

Megjithatë, presidenti Wilson, gjatë nënshkrimit të këtij akti, tha: “Më vjen keq që mund të ketë gjykatës në SHBA që duhet t’u thuhet një gjë e tillë.”¹⁷ Një deklaram i tillë tregon se pavarësisht qëndrimeve teorike, në praktikë gjërat janë disi më ndryshe. Puna është më tepër se një mall, është një mall shumë i veçantë, të cilit i shtohet komponenti i dinjitetit njerëzor dhe sa herë flitet për tregun e punës dhe çmimin e saj, nuk duhet harruar dinjiteti njerëzor.

Ajo çfarë na intereson të faktojmë është që, shoqëria jonë, pavarësisht definicioneve, flet për një treg pune dhe shkon deri në vlerësimin e kërkesës dhe ofertës në këtë treg, dy nocione aspak të ndryshme nga ata që përdoren për mallrat e tjerë.^{18,19} Kapitali njerëzor është çelësi i rritjes ekonomike. Jo vetëm që lidhet me përmirësimin e performancës ekonomike, por ndikon në rezultatet e vetë tregut të punës.²⁰

Science 69 (1917): 133-139.

17. Burns, Joe. “Strike! Why mothballing labor’s key weapon is wrong.” *New Labor Forum*. Vol. 19. No. 2. SAGE Publications, 2010.

18. Mulligan, Casey B. “Fiscal policies and the prices of labor: a comparison of the UK and US.” *IZA Journal of Labor Policy* 4.1 (2015): 1.

19. Krebs, Tom, and Martin Scheffel. “Macroeconomic evaluation of labor market reform in Germany.” *IMF Economic Review* 61.4 (2013): 664-701.

20. Quintini, Glenda. “Skills at Work: How skills and their use matter in the labour market.” (2014).

Puna, produkti, paga dhe disa hadithe që mund të na ndihmojnë

Puna është një mall të cilit i shtohet dinjiteti njerëzor. Pa e zgjidhur përfundimisht këtë çështje, mund të themi se, dinjiteti i njeriut në Islam garantohet jo vetëm nëpërmjet marrëdhënies punëdhënës/punëmarrës, por është vetë Allahu xh.sh. garantues i tij. **“Adhurojeni All-llahun e mos i shoqëroni Atij asnjë send, silluni mirë ndaj prindërve, ndaj të afërmeve, ndaj jetimëve, ndaj të varfërve, ndaj fqinjit të afërt, ndaj fqinjit të largët, ndaj shokut pranë vetes, ndaj udhëtarit të largët dhe ndaj robërve. All-llahu nuk e do atë që është kryelartë dhe atë që lavdërohet.”**²¹

Në rastin më ekstrem kur mohohet fare komponenti mall i punës, mund të themi se, jo puna por produkti i saj është mall. Rasti i punëtorit që prodhon tulla është tipik. Tullat e përfunduara janë mall ku punëtori ka investuar mundin e tij dhe, në njëfarë mënyre, është bashkëpronar derisa të likuidohet për punën e bërë.

Dy hadithet në vazhdim janë zgjedhur për të trajtuar kohën e pagesës së këtij komponenti, mall, në punën e punëtorit; meqenëse pagesa bëhet zakonisht në Lekë, që është ekuivalent i pagesës në monedha ari

nga njëra anë dhe nga ana tjetër është objekti i punës tek i cili punëtori ka të drejta.

Hadithet 2178, 2179. Na ka treguar Ali b. Abdi-l-lahi, këtij i tha Ed-Dahhak b. Mahledi, këtij Ibn Xhurejxhi, këtij Amr b. Dinar se Ebu Salih Ez-Zejjati e ka informuar se e ka dëgjuar Ebu Seid El-Hudriun r.a. duke thënë: “Dinari me dinar (monedhë ari) dërhem me dërhem, e unë i thashë: Ibn Abbasi nuk e thotë këtë?” – Ibn Seidi tha: Unë e pyeta: “A e ke dëgjuar këtë prej Pejgamberit s.a.v.s. apo e ke gjetur në librin e Allahut? Tha: S’do ta them këtë në tërësi, por ju dini më tepër mbi Pejgamberin s.a.v.s. sesa unë. Mirëpo Usame më informoi që Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë: **“S’ka kamatë përveç në pritje (të pagesës).”**²²

Hadithet 2180, 2181. Na ka treguar Hafs b. Umeri, këtij i tha Shu’be, këtij Habib b. Ebu Thabiti, i cili tha që e dëgjova El-Minhalin duke thënë: E pyeta Berra b. Azibin dhe Zejd b. Erkamini r.a. për këmbimin e parave dhe secili prej tyre (për tjetrin) thoshte: “Ky është më i mirë se unë”. Pastaj që të dy thanë: **“Pejgamberi s.a.v.s. e ka ndaluar shitblerjen e arit me argjend në formë të borxhit.”**²³

A janë paratë njëlloj si monedhat e arta dhe a është puna, apo produkti i saj, njëlloj me monedhat e argjendit?! Në ndihmë të pretendimit

21. Kur’an, Nisa, 36. Përkthimi me komentim i H. Sherif Ahmetit. OPGBG – “Rilindja” – Prishtinë, 1990, 116.

22. *Sabihu-l-Buhari, Libri 5.* Përkth. Ismail Ahmed; Prishtinë, 2002, 290-291.

23. *Sabihu-l-Buhari, Libri 5.* Përkth. Ismail Ahmed; Prishtinë, 2002, 291.

të bërë më sipër mund të shtojmë edhe qëndrimin e Ebu Hanifes, kur bëhet fjalë të zëvendësohet një mall me një mall tjetër kur është e nevojshme. Ebu Hanife e ka lejuar zëvendësimin e artikullit me vlerën e tij për të paguar zekatin e Fitrit.²⁴ Në këtë pikë i konsideroj kompetencat e mia të ezauruara për të vendosur rreth këtij përfundimi fetar, por, duke pasur parasysh rëndësinë që kjo çështje paraqet, gjykoj se i ruaj vetes të drejtën ta ngre si pyetje. Në rast se ky koment rreth këtyre dy haditheve përjashtohet nga diskutimi, nuk mund të lë pa përmendur dy aspekte të hadithit fillestar. Së pari, hadithi në mënyrë eksplicite jep mesazhin rreth të drejtës së pagesës (sapo ka mbaruar punën dhe pa vonesë) dhe duke ruajtur në mënyrën më të përsosur krenarinë e punonjësit (në mënyrë implicite pagesa e menjëhershme eliminon pamundësinë intelektuale për planifikim në kohë të gjatë).

Nëse është borxh dhe nuk paguhet në kohë ka pasoja

Hadithi 1608. Nga Ebu Hurejra r.a. transmetohet se i Dërguari i Allahut s.a.v.s. ka thënë: **“Zvarritja e pagesës së borxhit nga të pasurit është dhunë.** Nëse dikujt prej jush i kërkohet ta paguajë borxhin, ndërkohë që ka mundësi ta shlyejë, menjëherë të bindet dhe ta paguajë borxhin.” (Muttefekun alejh)²⁵

24. Sabiq, As-Sayyid, et al. *Fikhus-Sunneh*. Mileniumi i Ri, Tiranë, 2005, 404.

25. Imam En-Nevevîj. *Riad us Salehiin*.

Hadithi 1584. Nga Ebu Hurejra r.a. transmetohet se i Dërguari i Allahut s.a.v.s. ka thënë: **“Allahu i madhëruar thotë: “Me tre njerëz do të konfrontohem në Ditën e Kiametit, me njeriun, i cili premton në emrin tim dhe nuk e zbaton, me njeriun i cili e shet njeriun e lirë dhe ato të holla i përdor dhe njeriun, i cili angazhon mëditës dhe, pas kryerjes së punës, mëditjen e kontraktuar nuk e pagan.”** (Buhariu)²⁶

Këtij fenomeni mund t'i vendosësh një emër vetëm pasi të gjykohet me profesionalizëm. Ai mund të quhet borxh derisa të paguhet dhe në rastin më ekstrem mund të hidhen edhe dyshime për t'u quajtur si ndonjë nënkategori e kamatës. E gjitha kjo për vonesën, nëse do të gjykohej si vonesë, ndërsa për mospagesën e mundit të punës, Islami është i qartë.

Përfundime

Në shekullin e XXI-të, i punësuar gjendet i përfshirë në një sistem pothuajse global kontratash dhe pagesash. Ndryshimet nuk janë shumë domethënëse nga njëri vend në tjetrin. Bankimi elektronik ka standardizuar mënyrën e pagesave dhe sa herë që shfaqet një ndryshim i ri në sistem, reflektohet kudo.

Përkth. Samedin Abazi; Biblioteka Islamike “Co Kavaja Albania”, 1994, 278.

26. Imam En-Nevevîj. *Riad us Salehiin*. Përkth. Samedin Abazi; Biblioteka Islamike “Co Kavaja Albania”, 1994, 272.

Globalizimi ka efekte të pamohueshme në ekonomi, politikë dhe kulturë. Shembulli më i mirë dhe gjithashtu me ndjeshmëri shumë të madhe është pjesëmarrja masive e grave në forcën e punës.²⁷ Feja, më konkretisht feja islame, duhet të thotë fjalën e saj në këtë vorbull që ndryshon vazhdimisht. Shteti demokratik dhe social, duhet ta dëgjojë zërin e besimit, si shprehje e vullnetit të masës që kjo fe përfaqëson, sigurisht, duke respektuar të drejtat e garantuara në mënyrë kushtetuese për të gjithë. Hadithi rreth të cilit e filluam këtë diskutim, është ndoshta i vetmi fakt i pamohueshëm që Islami nëpërmjet Profetit Muhamed (a.s.) ka çfarë të thotë për trajtimin e punonjësve me pagesë. Islami është përplot me alternativa që, të përdorura në mënyrën më të mirë, do të ishin një avokaturë e drejtë për punonjësën e shekullit të XXI-të. Një mundësi është që këtë punonjës ta veshim me rrobat e shekullit të VII-të dhe t'i lexojmë hadithin, duke e quajtur situatën të zgjidhur, një situatë kjo që nuk është se nuk ndodh dhe mundësia tjetër është të vendosemi konkretisht përballë situatës ku ndodhet shoqëria jonë dhe të mundohemi ta bëjmë më të drejtë duke e parë me syrin e Kur'anit dhe Sunetit.

27. Moghadam, Val. "Gender and globalization: Female labor and women's mobilization." *Journal of world-systems research* 5.2 (2015): 366-389.

Kanë ndryshuar mjetet e prodhimit, lëvizja e kapitalit dhe bashkë me to edhe figura e të punësuarit. Konkretisht, çdo zanat ka fituar si karakteristikë superspecializimin dhe duke u vendosur përballë qoftë edhe një hadithi të vetëm, ka nevojë të jemi të vetëdijshëm për këtë fakt dhe të njohim kategoritë e këtij superspecializimi, duke u përpjekur të mos e zbatojmë atë ndryshe nga qëllimi për të cilin është transmetuar. Puna dhe mënyra e pagesës së një punëtori fabrike është e ndryshme nga cilido shembull i shekullit të VII-të. Të gjendur para një situatë të tillë vihem para dy alternativave; ta braktisim atë duke mos përfituar nga e mira e një hadithi dhe të tjerëve që lidhen me situatën e tij, që nuk më duket e drejtë, ose të përpiqemi ta implementojmë atë në kohën moderne.

Hadithi konsideron komponentin kohë në pagesën që i detyrohen punonjësit. Në mbyllje do të përmbledh vetëm dobësitë e diskutimit, tejkalimi i të cilave do ta lejonte atë të jetë praktikisht i vlefshëm dhe të sjellë rekomandime apo të drejtohet në një formë tjetër. Së pari, hadithi i diskutuar është parë me syrin e ndarjes së punës me kohë të caktuar apo jo, përkrah ndarjes tipike në punë mendore dhe fizike. Në këtë nuk shoh ndonjë problem, vetëm se hadithi shikohet i reflektuar në grupe profesionale. Nëse hadithi konsiderohet në mënyrë strikte,

vetëm për punën fizike, kërkohet ndërhyrja e një eksperti, që duhet të vlerësojë edhe dy etapat e tjera, nëse puna është mall, të cilit i mbivendoset dinjiteti i njeriut dhe mund të jetë subjekt i haditheve në vazhdim, që flasin për këmbimin e mallrave apo jo. Së fundmi, qëndron përgjegjësia ndaj vonuesit të pagesave të punonjësve. Këtu nuk ka vend për diskutim. Ajo është e dënueshme sidomos kur bëhet fjalë për punëtorët e varfër, që me vështirësi mbulojnë jetesën dhe janë të rrezikuar më shumë se të tjerët për abuzime dhe, për më tepër, kanë vështirësi në planifikimin dhe menaxhimin e buxhetit.

Koha, si për çdo gjë tjetër, edhe për pagesat është vlerë e pamohueshme dhe jo vetëm abuzimi nëpërmjet saj, por edhe mos studimi i vlerës praktike të saj, është i padrejtë. Sistemi i sotëm bankar përfiton më së shumti nëpërmjet lojës me faktorin kohë. Një pagesë e vonuar, sidomos për një të varfër, do të thotë shtyrje drejt borxhit,

abuzimit e madje edhe vjedhjes dhe krimit. Vonesa e pagës edhe nëse nuk është drejtpërdrejt një stimul për korrupsion, është një ngarkesë më tepër në supet e punonjësit që mund të rrisë tolerancën ndaj korrupsionit. **“Edhe Medjenit (i dërguam) vëllain e tyre Shuajbin që ju tha: “O popull im, adhurojeni Allahun, ju nuk keni zot tjetër pos Tij, mos matni as mos peshoni mangët, unë po shoh se jeni në gjendje të mirë jetësore, pra unë po frikësohem për ju nga dënimi që do t’ju përfshijë një ditë!””**²⁸

Nuk ka nevojë për ndryshime ligjore. Ligji e lejon që të paguash punonjës të tjerë çdo ditë. Nëse ke në varësi punonjës që janë të nevojshëm për ta marrë të ardhurën e tyre në mënyrë ditore mund ta bësh sepse nuk kushton më shumë se një klik më tepër.

28. Kur'an, El Asr, 84. Përkthimi me komentim i H. Sherif Ahmetit. OPGBG – “Rilindja” – Prishtinë, 1990, 269.

Mbikëqyrja fetare ose Ihtisabi ndaj prindërve – rregullat dhe etika - I

Dr. Sedat Islami
Prishtinë

Abstrakt

Urdhërimi për të mirë dhe ndalimi nga e keqja' është një nga institucionet fetare më të rëndësishme. Ai garanton zbatimin e ligjit të Zotit në shoqëri dhe ruajtjen e kësaj të fundit nga dukuritë negative. Për shkak të kësaj rëndësie që ka, në Kur'an (9:71), është përshkruar edhe si detyrim që rrjedh nga vëllazëria fetare. Duke qenë se ka këtë pozitë, atëherë, si institucion, është normuar me rregulla dhe etikë përkatëse, në mënyrë që të parandalohet manifestimi i gabuar i tij, i cili mund të ketë pasojat e veta. Urdhërimi për të mirë dhe ndalimi nga e keqja ka vazhduar si organ shoqëror e shtetëror për shekuj. Me kalimin e kohës, perceptimet e mangëta përkitazi me të, si institucion, filozofi dhe botëkuptim, kanë çuar në aplikimin e gabuar të tij. Është gabuar, përveç të tjerash, edhe në raport me prindërit. Ky punim vjen për të treguar aspektet se ku është gabuar me prindërit dhe cilat janë format e miratuara, fetarisht, për ushtrim të tij në raport me ta.

Fjalët kyçe: *respektimi i prindërve, mbajtja e lidhjeve familjare, urdhërimi për të mirë dhe ndalimi nga e keqja, ihtisabi ndaj prindërve, kundërshtimi i prindërve, shpëputja e lidhjeve familjare.*

Hyrje

Respektimi për prindërit në Islam ka qenë dhe mbetet vlerë dhe moral me të cilin myslimanët mburren

para njerëzimit. Pozita që i është dhënë prindërve në Islam është e papërsëritur në historinë fetare, morale e legislative të njerëzimit.

Kjo ka bërë që dijetarë dhe thirrës myslimanë¹ me kohë këtë vlerë, krahas vlerave tjera që shpërfaqin mirësitë e Islamit, ta fusin në kuadër të arsenalit predikues fetar, respektivisht ta vënë në funksion si element joshës dhe tërheqës për pranimin e fesë nga jomyslimanët.

Edhe pse bukuri prej bukurive të fesë, ky moral, për shkak të veprimeve të pamenduara dhe të pamenduara mirë të disa besimtarëve të rinj, është përbaltur paksa. Këta të rinj, të mbërthyer nga entuziazmi dhe të verbëruar nga injoranca, kanë dhënë shembuj të këqij për sjelljet e tyre me prindër, duke vënë në pikëpyetje, jo vetëm këtë moral, por moralin islam në tërësi. Sjelljet e tyre të pamatura, që u kthyen në skena tragjike para syve të botës mbarë, ku prindit nuk i kursehej madje as jeta, njollosën këtë moral me të cilin krenohemi.

Problematika e studimit

Këto veprime të shëmtuara të këtyre të rinjve kanë krijuar një konfuzion, sepse ata i janë referuar fesë. Për brutalitetin dhe arrogancën e tyre kanë dëshmuar me tekste fetare. Në fakt, ata i kanë interpretuar në mospërputhje me kriteret e parapara dhe i kanë aplikuar në kundërshtim me rregullat dhe

etikën fetare, por kjo, megjithatë, ka pasur efektin e vet negativ. Janë ngritur shumë shqetësime nëse këto interpretime dhe veprime kanë të bëjnë me Islamin dhe nëse ka lajthitje në mënyrën e kuptimit dhe interpretimit të teksteve fetare për urdhërimin për të mirë dhe ndalimin nga e keqja.

Pyetjet hulumtuese

Për ta dëshmuar se sa të gabuara janë metodat e tyre, në njërin anë, dhe për të ofruar konceptin autentik islam përkitazi me urdhërimin e prindërve për të mirë dhe ndalimin e tyre nga e keqja, i jam referuar një mori pyetjesh hulumtuese, si:

1) Cila është pozita e prindërve në fe dhe çfarë na urdhërojnë Kur'ani dhe Suneti për prindërit?

2) A urdhërohen prindërit për të mirë dhe a ndalohen nga e keqja?

3) Nëse po, atëherë cilat janë mënyrat, rregullat dhe etika e kërkuar fetarisht për ta bërë një gjë të tillë?

4) A bëjnë prindërit përjashtime nga rregullat e përgjithshme të urdhërimit për të mirë dhe ndalimit nga e keqja?

I. Respekti për prindërit në Kur'an, sunet dhe historinë islame

1. Kur'ani për respektimin e prindërve

1.1. Porosia hyjnore për mirësjellje me prindërit

1. Sa për shembull, shih: Sa'di, AbduRrahman bin Nasir. (2011). *Ed-durr-rretu el-mubtesaretu fi mebasini ed-dini el-islamijj*. Ed.5. Rijad: Errriasetu el-ammetu li-l-buhuth el-ilmijjeti ve-l-ifta, f. 26.

Në Kur'an gjejmë disa citate të cilat na obligojnë të jemi të sjellshëm me prindërit tanë. Kështu, në kaptinën En-Nisa, ajeti 36, Allahu na urdhëron: “*Adhuroni Allahun dhe mos i shoqëroni Atij asgjë (në adhurim); silluni mirë me prindërit...*” [En-Nisa: 36]²

Në kaptinën El-En'amë, ajeti 151, Allahu na urdhëron: “(Thuaju: ‘Ejani t’ju lexoj çfarë ju ka urdhëruar Allahu...’) **që të silleni mirë me prindërit...**” [El-En'amë: 151]³

Çfarë nënkupton mirësjellja me prindërit?

Nëse i kthehemi komentimit të ajeteve të cituara sipër, do të gjejmë domethënie madhështore të respektimit të prindërve. Xhessasi, fillimisht, shpjegon se bëhet fjalë për mirësjellje të obliguar nga Allahu.⁴ Në këtë aludon edhe Fahrudin Rrazi.⁵ Hasan Basriu mendon se bamirësia ndaj prindërve nënkupton të shpenzosh për ta atë që e posedon dhe të përfillësh urdhrat e tyre për aq kohë sa urdhrat nuk paraqesin mëkat ndaj Allahut.⁶ Imam Kurtubiu, në

komentim të këtij ajeti, respektivisht *mirësjelljes* me prindërit, shpjegon imazhe më të shumta të formave se si manifestohet në praktikë. Thotë se mirësjellja nënkupton ‘bamirësinë ndaj tyre, ruajtjen dhe mbrojtjen e tyre, respektimin e urdhrave të tyre, lirin nga robëria (nëse janë në të), dhe heqjen dorë nga pushteti ndaj tyre.’⁷ Begaviu shpjegon se krahas bamirësisë hyn edhe dhembshuria dhe ana emocionale.⁸ Ngjashëm kanë shpjeguar edhe Imamët Xhelaluddin Mehal-liu dhe Xhelaluddin Sujuti.⁹ AbduRrahman bin Nasir Es-Sa’di në shpjegimin e tij përmbledh të drejta morale dhe materiale. Thotë: ‘*Silluni mirë ndaj prindërve me fjalë të mira, me ligjërime të butë, me vepër të bukur duke respektuar urdhrat e tyre dhe iu shmangur ndalesave të tyre, duke shpenzuar për ta, duke respektuar ata që kanë lidhje me ta, qoftë nga lidhja e drejtpërdrejtë (farefisi), qoftë nga lidhja jo e drejtpërdrejt (miqësia e shoqëria).*’¹⁰

2. Përkthimin e ajeteve e kemi huazuar nga përkthimi i Hasan ef. Nahit.

3. Po kështu edhe në kaptinat Llukman, 14; El-Isra, 23; El-Ahkaf, 15, etj.

4. Shih: El-Xhessas, Ahmed bin Ali. (1405 h.) *Abkamu-l-Kur'an*. Verifikimi shkencor: Muhammed Sadik El-Kamhavi. Bejrut: Daru Ihjai-t-turath el-arabijj. 3/155.

5. Shih: Fahrudin Rrazi, Ebu Abdullah Muhammed bin Umer. (1420 h.). *Mefatihu-l-gajb*. Ed. 3. Bejrut: Dar Ihja et-turath el-arabijj. 10/76.

6. Shih: El-Xhessas. (1405 h.) *Abkamu-l-Kur'an*. Op. cit. 20/5.

7. El-Kurtubi, Ebu Abdullah Muhammed bin Ahmed. (1964). *El-xhamiu li-ahkami-l-Kur'an*. Verifikimi shkencor: Ahmed Berduni dhe Ibrahim Atfish. Kajro: Dar el-kutub el-misriijeh. 7/132.

8. Shih: El-Begavi, Ebu Muhammed El-Husejn bin Mes'ud. (1420 h.). *Mealim et-Tenzil fi tefsiri-l-Kur'an*. Verifikues shkencor: AbduRrezzak El-Mehdi. Bejrut: Dar Ihjai-t-turath el-arabijj. 1/615.

9. Shih edhe: El-Mehal-li, Xhelaluddin dhe Es-Sujuti, Xhelaluddin. (p.v.b.) *Tefsiru-l-Xhelalejni*. Kajro: Daru-l-hadith. F. 107.

10. Es-Sa'di, AbduRrahman bin Nasir. (2000). *Tejsiru-l-Kerimi-rr-Rrahman fi tefsiri Kelami-l-Mennan*. Verifikues shkencor:

Siç mund të shihet, respektimi i prindërve nuk përkufizohet në një fushë ose aspekt obligimesh. Fajruzabadi mendon se mirësjellja me prindërit nënkupton pafundësi në respektim të tyre.¹¹

Pra, të mos kufizohesh vetëm në një ose dy forma, por ta shndërrosh respektimin e tyre në art, në jetë, në gjithçka të bukur. Në Kur'an, duke na u ofruar limite dhe kufij, që nuk guxojmë t'i shkelim, kur është në pyetje respektimi i prindërve, na ofrohen në fakt hapësira gjigante dhe mundësi të rralla të jetësimit të shembujve më të lartë dhe më brilant të respektimit të tyre. Ja çfarë dua të citoj më konkretisht; Allahu thotë: **“Zoti yt ka urdhëruar, që të mos adhuronit askënd tjetër përveç Atij dhe, që të silleni mirë me prindërit. Nëse njëri prej tyre ose të dy arrijnë pleqërinë te ti, mos u thuaj atyre as “uh!”, mos i kundërshtoj, por drejtoju atyre me fjalë respekti. Lësho para tyre krahët e përluljes prej mëshirës dhe thuaj: “O Zoti im, mëshiroji ata, ashtu siç më kanë rritur, kur unë isha i vogël!”.**” [El-Isra: 23-24]

AbduRahman bin Mual-la El-Luvejhik. Bejrut: Muessesetu-rr-rrisale. F. 177.

11. Shih: El-Fejruzabadi, Mexhuddin Ebu Tahir Muhammed bin Ja'kub. (1996). *Besairu dbevi-t-temjiz fi letaiji-l-Kitabi-l-aziz*. Verifikues shkencor: Muhammed Ali Nexh-xhar. Ed. 3. Kajro: El-mexhlis el-a'la li-sh-shuun el-islamijeh. 2/213.

Limiti që ajeti ka caktuar dhe nuk lejon të shkelet është thënia: ‘uf’¹², që nënkupton se çdo gjë më e madhe se kjo thënie është mëkat. Hasani, i biri i Aliut (r.a.) transmetohet të ketë thënë: Po të kishte diçka nga kundërshtimi i prindërve që është dhe më i vogël se thënia ‘uh’, Allahu do ta ndalonte.¹³

Kështu, mund të themi se respektimi i prindërve përfshin atë që është shpirtërore, emocionale, etike dhe materiale. Shpirtërore, sepse është punë besimi respektimi i tyre; emocionale, sepse duhet pasur kujdes që të mos lëndohen emocionalisht, siç do të shpjegojmë më poshtë; etike, sepse duhen përzgjedhur fjalë se si flet dhe si iu drejtohesh atyre; materiale, sepse duhet shpenzuar për prindërit.

1.2. Respektimi për prindërit në pozitë me adhurimin ndaj Allahut

Ibni Kethiri në komentim të këtij ajeti (dhe të ajetit 151 nga kaptina El-En'am) thotë se jo rrallë Allahu i Madhëruar sjell paralel adhurimin për Të me respektimin për prindërit, si fjala vjen në ajetet: **“...Ne i thamë atij: “Bëhu falënderues ndaj Meje dhe prindërve të tu!...”** [Lukman:

12. Es-Sa'di. (2000). *Tejsiru-l-Kerimi-rr-Rahman*. Op. cit. F. 456.

13. Këtë thënie e ka regjistruar në tefsirin e tij Shevkani. Shih: Esh-Sheukani, Muhammed bin Ali. (1414 h.) *Fet'hu-l-Kadir*. Bejrut: Dar Ibn Kethir. 3/262.

14]; **“Zoti yt ka urdhëruar, që të mos adhuronit askënd tjetër përveç Atij dhe, që të silleni mirë me prindërit...”** [El-Isra: 23]¹⁴

Ibni Abbasi (r.a.), duke iu referuar ajetit të -14të nga kaptina Lukman, thotë se kush falënderon Allahun ndërsa nuk falënderon prindërit, nuk i pranohet, sepse këto gjëra janë të lidhura mes tyre. Kjo sepse në Kur'an, në tre kaptina, kanë ardhur paralel tre urdhëresat, që nuk pranojnë ndarjen nga njëra tjetra:

- respektimi i Allahut dhe respektimi i të Dërguarit (a.s.) (Et-Tegabun: 12),
- falja e namazit dhe dhënia e zekatit (El-Bekare: 43)
- falënderimi ndaj Allahut dhe falënderimi ndaj prindërve (Lukman: 14).¹⁵

1.3. Motive të respektimit

- 1- Përfillja e urdhrit të Zotit.
- 2- Prindërit janë shkaku i ekzistencës sonë.
- 3- Mirësjellja e tyre me ne na obligon që të jemi të mirësjellshëm me ta.

1.4. Respektimi i prindërve, pavarësisht fesë së tyre dhe pika ku nuk respektohen prindërit

Respekti për prindërit lidhet, në radhë të parë, me lidhjen biologjike.

Kjo nënkupton se respekti për prindërit nuk bie as atëherë kur ata nuk janë fare besimtarë/myslimanë. Limit është vetëm ajo që parasheh respekti. Më qartë, nëse prindërit na urdhërojnë për gjëra që feja na i ndalon, atëherë nuk i respektojmë në pranimin e urdhrit në fjalë, ndërsa respekti ndaj tyre vazhdon. Thotë Allahu: **“Ne e kemi urdhëruar njeriun, që të sillet mirë me prindërit e vet dhe: “Nëse ata të nxisin ty që të më shoqërosh Mua (në adhurim) atë, për të cilin ti nuk di asgjë, atëherë mos i dëgjo ata.” Tek Unë do të ktheheni të gjithë e do t’ju lajmëroj për gjithçka që keni bërë.”** [El-Ankebut: 8]; **“Nëse ata orvaten, që të më shoqërosh Mua (në adhurim) diçka, për të cilën ti nuk ke dijeni, mos i dëgjo, por sillu mirë me ata në këtë jetë dhe ndiq rrugën e atij që drejtohet tek Unë me devotshmëri; pastaj, tek Unë do të ktheheni dhe Unë do t’ju lajmëroj për atë që keni bërë.”** [Lukman: 15]

Në këto dy ajete flitet për respektimin e prindërve jomyslimanë. Allahu urdhëron të kemi respekt për prindërit, të sillemi butë me ta, t’i nderojmë dhe ta çojmë në vend fjalën e tyre, por me kusht që urdhri apo fjala e tyre të mos jetë diçka që feja e ndalon, siç përmendet p.sh. idhujtaria në ajet.

14. Shih: Ibn Kethir. (1999). *Tefsiru-l-Kur’ani-l-Adhim*. Op. cit.. 2/298; 3/361.

15. Shih: Es-Sefarijini, Muhammed bin Ahmed Salim. (1993.) *Gidbau-l-elbab fi sherhi mendhumeti-l-adab*. Ed. 2. Egjipt: Muessesetu Kurtube. 1/392.

Pra, nëse prindërit të urdhërojnë për këtë, madje edhe nëse insistojnë,¹⁶ mos i respekto vetëm në këtë pikë, ndryshe, vazhdo të sillesh mirë me ta duke shpresuar në shpërblimin e Allahut. Ky ajet, siç përmend Ibn Kethiri,¹⁷ ka zbritur për nënën e Sa'dit, e cila dëshironte që i biri të mos bëhej mysliman. Madje, e kishte kërcënuar se nëse nuk e braktiste fenë e re, ajo nuk do të hante derisa të vdiste, duke dashur që kështu ta godiste turpi Sa'din. Ky i fundit, me gjithë respektin e madh që kishte për nënën, kishte vazhduar të qëndronte në fenë e tij. Si konfirmim për qëndrim të duhur dhe të pranuar, Allahu kishte shpallur këtë ajet.

Pra, prindërit nëse na urdhërojnë që të bëjmë mëkat, nuk respektohen, por respektimi ka të bëjë vetëm me mos çuarjen në vend të urdhrit të ndaluar, ndryshe, pas kësaj, respekti kundrejt tyre vazhdon. Madje, edhe mos çuarja në vend e urdhrit të ndaluar nuk duhet të manifestohet me sjellje të keqe. Rast konkret të kësaj do të shohim në hadithe, në pjesën që vijon.

2. Suneti për respektimin e prindërve

2.1. Respektimi i prindërve, pozita dhe mirësitë

16. Shih: Ebu-s-Suud, Muhammed bin Muhammed. (p.v.b.) *Irshadu-l-akli-s-selim ila mezaja el-Kitabi-l-Kerim*. Bejrut: Dar ihja et-turath el-arabijj. 7/31.

17. Shih: Ibn Kethir. (1999). *Tefsiru-l-Kur'ani-l-Adhim*. Op. cit. 6/265.

1- Kënaqësia e Allahut në kënaqësinë e prindërve

I Dërguari i Allahut (a.s.) ka thënë:

“Kënaqësia e Zotit është në kënaqësinë e prindit (babait) dhe hidhërimi i Zotit është në hidhërimin e prindit.”¹⁸

Ky hadith, ndonëse tekstualisht përmend babanë, ai përfshin dhe nënën, madje edhe më parë se vet babanë.¹⁹

2- Mirësjellja e prindërve nuk kompensohet me asgjë

Prindërit kanë pozitë shumë të lartë. Njeriu, pavarësisht angazhimit në përmbushjen e kërkesave dhe nevojave të prindërve, asnjëherë nuk mund ta kompensojë atë që prindërit kanë bërë për të. Ibn Umeri (r.a.) kishte parë një jemenas që bartte nënën e tij në shpinë gjatë tavafit. Njeriu iu drejtua Ibni Umerit: O biri i Umerit, a mendon se kam kompensuar mundin e nënës sime? Ibn Umeri iu përgjigj: Jo, madje as edhe një dhimbje të vetme gjatë kohës kur të lindi ty.²⁰

18. Transmetojnë Tirmidhiu në Sunen dhe Buhariu në Edebu-l-Mufred ndërsa Albani e vlerëson autentik. Shih: *Sabihu-l-Edebi-l-Mufred*, nr. 2.

19. Shih: el-Karij El-Herevij, Ali bin Sultan Muhammed. (2002). *Mirkatu-l-mefatib sherhu Mishkati-l-mesabih*. Bejrut: Daru-l-fikr. 7/3089. Shihe dhe: El-Mudhhiri, El-Husejn bin Mahmud bin El-Hasen. (2012). *El-Mefatib fi sherbi el-Mesabih*. Kuvajt: Dar en-Nevadir. 5/209.

20. Transmeton Buhariu në Edebu-l-Mufred ndërsa Albani e vlerëson autentik. Shih: *Sabihu-l-Edebi-l-Mufred*, op. cit. nr. 13.

3- Respektimi i prindërve prej veprave më të mira

Ibn Mes'udi (r.a.) transmeton: "E kam pyetur Profetin: Cila vepër është më e dashur tek Allahu? Tha: *Namazi në kohën e vet.* Pastaj cila? pyeta. Tha: *Mirësjellja me prindërit.* Pastaj cila? Tha: *Xhibadi në Rrugën e Allahut.*"²¹

4- Jeta e lumtur dhe e gjatë

Respektimi i prindërve është vepër e cila të dhuron lumturi dhe jetëgjatësi. I Dërguari i Allahut (a.s.) ka thënë: "*Asgjë nuk e largon caktimin e Zotit përveç duasë, sikur që nuk e zgjat jetën asgjë tjetër përveç mirësjelljes.*"²²

5- Largim të pikëllimit dhe rrugëdalje nga problemet

Kushdo që ka lexuar hadithin e tre vetave që nata i zuri në rrugë dhe u strehuan në shpellë për ta bërë gjumin,²³ e kupton se sa e rëndësishme është mirësjellja me prindërit. Ata ngelën të ngujuar në shpellë dhe vendosën që ta lusnin Allahun me veprat e mira që kishin bërë. Të tre përzgjedhën nga një vepër. Njëri përzgjedhi mirësjelljen me prindër. Lutjet u pranuan, duke dëshmuar indirekt se edhe ato vepra ishin pranuar dhe se ishin vepra me shpërblim.

6- Hyrja në Xhenet

Imam Ahmedi dhe Ibn Maxheh shënojnë se Muavije Sulemiu kishte

kërkuar leje nga i Dërguari i Allahut për të marrë pjesë në xhihad me të. Ai e urdhëroi që të kthehej te nëna dhe të sillej mirë me të. Meqë insistonte, ai (a.s.) i tha: "*Mjerë për ty, mos iu ndaj këmbës së saj sepse aty është Xheneti!*"²⁴

Shaviu ka thënë se, modestia me nënat, është shkak për të hyrë në Xhenet ndërsa Sindi thotë se, në hadith, xheneti, në mënyrë figurative, ka ardhur sikur diçka që është në pronësi të nënës, e cila qëndron e ulur mbi të. Ti nuk mund të marrësh asgjë prej saj pa pëlqimin e saj.²⁵

2.2. Imazhe të respektimit

1- Të folurit me fjalë të mira e të buta

Ibn Umeri i kishte thënë Tajsale bin Mejjasit: ...A ke frikë Xhehenemin dhe a ke dëshirë të hysh në Xhenet? Po- ia kishte kthyer. Po prindërit i ke gjallë? - e pyeti. E kam vetëm nënën- ia ktheu. Tha Ibn Umeri: Pasha Allahun, nëse i drejtohesh me fjalë të buta dhe e ushqen do të hysh në Xhenet përderisa nuk ke bërë mëkate të mëdha.²⁶

2- Dhënia përparësi nënës në respekt

Respekti i nënës vihet para respektit për babanë, edhe pse kjo në asnjë rrethanë nuk interpretohet si mungesë respekti për këtë të fundit. Argument për këtë është hadithi i Ebu Hurejre i shënuar nga Buhariu e

21. Transmetim unanim.

22. Hadithin e transmeton Timridhiu ndërsa Albani thotë se është hasen.

23. Transmetim unanim. Pjesën e hadithit do ta përmendim më poshtë.

24. Albani e konsideron hadith autentik.

25. Shih: Es-Sindi, Muhammed bin Abdul Hadi. (p.v.b) *Kifajetu-l-haxheb fi sherhi Suneni Ibni Maxheb.* Bejrut: Dar el-Xhil. 2/180.

26. Hadithi është autentik. Shih: Sahihu Edebi-l-Mufred, nr. 8.

Muslimi: Erdhi një njeri tek i Dërguari i Allahut (a.s.) dhe tha: O i Dërguari i Allahut: Kush nga njerëzit meriton më së shumti shoqërimin tim të mirë? Tha: *Nëna*. Pastaj kush?- pyeti ai. Tha: *Nëna*. Pastaj kush?- pyeti. Tha: *Nëna*. Pastaj kush?- pyeti. Tha: *Babai*. Arsyeya, siç shpjegon Imam Neveviu, se përse i është dhënë përparësi nënës qëndron në lodhjet e saj në bartjen, lindjen dhe përkujdesjen për të.²⁷

3- *Tua kthesh gëzimin siç ua ke shkaktuar mërzinë*

Nëse njeriu i shkakton një mërzë prindërve, atëherë duhet të bëjë përpjekje që tua largojë atë dhe tua kthejë gëzimin. Ebu Davudi, Ibn Maxheh dhe Nesaiu transmetojnë se një njeri kishte ardhur për tu besatuar për hixhretin ndërsa i kishte lënë prindërit duke qarë. I Dërguari i Allahut (a.s.) i tha: “*Kthehu tek ata dhe kthejua buzëqeshjen ashtu sikur i bërë të qajnë*.”²⁸

4- *Shpenzimi për ta*

Në shpjegim të hadithit “*Ti dhe pasuria jote jeni të babait tënd*”²⁹, dijetarë myslimanë kanë përmendur se fëmija jo vetëm që është i obliguar të furnizojë prindërit në rast se ata janë në gjendje të rënduar ekonomike porse prindit i lejohet që, nëse fëmija refuzon ndërkohë që ai ka nevojë,

të marrë nga pasuria e tij pa lejen paraprake të fëmijës.³⁰

5- *Durimi në respektimin e tyre*

Në Sunet gjejmë porosi që në raport me prindërit të durojmë, qoftë edhe nëse dëmtohem fizikisht e materialisht. Imam Ahmedi transmeton porosinë që i Dërguari i Allahut (a.s.) i kishte dhënë Muadh bin Xhebelit (r.a.), në të cilën, përveç tjerash, i kishte thënë: “*...dhe mos i kundërshtoj prindërit, edhe nëse të imponohen ta braktisësh familjen dhe pasurinë tënde*...”³¹

6- *Respektimi i tyre pas vdekjes*

Respektimi për prindërit nuk ndalet me vdekjen e tyre. Ai vazhdon edhe pas vdekjes së tyre nëpërmjet mënyrave në vijim:

- Lutja dhe kërkimi falje për ta.
- Dhënia lëmoshë për shpirtin e tyre
- Respektimi i miqve dhe dashamirëve të tyre që janë gjallë

2.3. *Trajtimi i prindërve jobesimtarë*

1- *Nuk lejohet imponimi i fesë*

Nuk i lejohet një myslimani që t’ia imponojë fenë prindërve të tij. Ajo që duhet të bëjë është që të lutet për udhëzimin e tyre. Dëshminë më të qartë e kemi nga Ebu Hurejre (r.a.), i cili shkoi tek i Dërguari i Allahut (a.s.) t’i ankohej për nënën e tij se megjithëqë ai dëshironte ta pranonte

27. Shih: En-Nevevi, Jahja bin Sheref. (1392 h.) *El-minbaxh sherhu Sabihi Muslim bin El-Haxh-xhaxh*. Bejrut: Dar ihja et-turath el-arabij. 16/102.

28. Albani thotë se hadithi është autentik.

29. Transmetojnë Ahmedi dhe Ibn Maxheh. Albani thotë se hadithi është autentik.

30. Shih: El-Karij, Ali bin Sultan Muhammed. (1985). *Sherhu Musnedi Ebi Hanifete*. Verifikimi shkencor: Halil Muhjiddin El-Mejs. F. 216.

31. Albani në Sahihu-t-Tergib e vlerëson si hadith hasenun li gjajrihi.

Islamin, ajo refuzonte. Ai i tha: “Lute Allahun për të!” Ebu Hurejre u lut dhe nëna e tij, siç vazhdon hadithi, e pranoi Islamin.³²

2- Mbajtja e lidhjeve në bazë të asaj që përcakton afërsia familjare

Bazë për mbajtjen e lidhjeve me prindërit është aspekti biologjik. Edhe nga Kur’ani mësuam se prindërit duhen respektuar, edhe nëse nuk janë të së njëjtës fe me ne.

3- Mirësjellja

Profeti (a.s.) ka porositur që të respektohen prindërit, pavarësisht se çfarë feje kanë. Një rast konkret e kemi me Esmën, e cila rrëfen të ketë kërkuar leje nga Profeti (a.s.) për nënën e saj, e cila, ndonëse ishte ende jomyslimane, kishte shfaqur dëshirë të ishte në lidhje me vajzën e saj, pra Esmën. Ai i kishte thënë: “Po, mbaji lidhjet me nënën tënde!”³³

2.4. Mos dëgjueshmëria ndaj prindërve, manifestimi dhe pesha e mëkatit

1- Mëkat prej mëkateve më të mëdha

Kundërshtimi i prindërve është prej mëkateve më të mëdha. Ebu Bekrete (r.a.) transmeton: Kemi qenë tek i Dërguari i Allahut (a.s.), kur tha: *A t’iu rrëfej për mëkatet më të mëdha?— dhe e përsëriti tre herë. Thamë: Po, gjithsesi, o i Dërguari i Allahut! Tha: T’i përshkruash shokë Allahut, t’i kundërshtosh prindërit dhe të shpëfësh...*³⁴

32. Transmeton Buhariu në Edebul-mufred, ndërsa Albani e konsideron hasen.

33. Hadithin e shënon Buhariu.

34. Transmetim unanim.

2- Mëkat me dënim të përshpejtuar

Kundërshtimi i prindërve është prej mëkateve që kanë dënim të përshpejtuar. Ebu Bekrete (r.a.) transmeton se i Dërguari i Allahut (a.s.) ka thënë: “Nuk ka mëkat që meritojnë t’iu përshpejtohet dënimi në këtë botë, krabas dënimit që iu ruhet për botën tjetër, sikur padrejtësia dhe shpëputja e lidhjeve familjare.”³⁵

3- Privimi nga mëshira e Allahut

Kundërshtari i prindërve në Ditën e Llogarisë do të ngelë i privuar nga mëshira e Allahut. I Dërguari i Allahut (a.s.) ka thënë: “*Allahu i Madhbëruar nuk do t’i shikojë tre veta në Ditën e Llogarisë: kundërshtarin e prindërve, gruan që imiton meshkujt dhe dejjuthin (atë që pranon të keqen në shtëpi)...*”³⁶

2.5. Kufiri i respektit për prindërit

1- Nuk ka respekt në mëkat

Ashtu sikur në Kur’an, edhe në Sunet është përshkruar kufiri ku mbaron respekti për prindërit. Ky kufi ka të bëjë me ndalesat e Allahut. Nëse prindërit e urdhërojnë fëmijën të ndjekë një rrugë të gabuar, atëherë nuk është mëkat për këtë të fundit që të mos e çojë në vend fjalën e tyre, sepse: “Nuk ka respekt për krijesën nëse të urdhëron t’i bësh mëkat Krijuesit.”³⁷

Nëse prindërit të urdhërojnë t’i bësh mëkat Allahut, atëherë, referuar

35. Hadithi është autentik. Shih: *Sahihu Edebi-l-Mufred*, op. cit. Nr. 29.

36. Hadithin e shënon Nesaiu ndërsa Albani e konsideron autentik.

37. Hadith autentik. Shih: *Sahihu-l-xhami*, 7520.

këtij hadithi, nuk respektohet fjala e tyre.³⁸

II. Ihtisabi ndaj prindërve

1. Koncepti i ihtisabit në të drejtën fetare

1.1. Domethënia etimologjike dhe terminologjike e termit el-*ihtisab*

1.1.1. Domethënia etimologjike

El-Ihtisab nga ana gjuhësore mund të ketë njërin prej katër domethëniesve:

- Kërkimin e shpërblimit³⁹
- Ndalimin e të keqes⁴⁰
- Provimin dhe testimin⁴¹
- Menaxhimin dhe

administrimin efektiv⁴²

38. Shih: El-Karij. (2002). *Mirkatu-l-mefatih*. Op. cit. 1/132.

39. Shih: Ibn Mendhur, Xhemaluddin. (1414 h.) *Lisanu-l-arab*. Ed. 3. Bejrut: Dar Sadir. 1/314-315.; Ez-Zubejdi, Muhammed bin Muhammed bin AbduRrezzak. (p.v.b.) *Taxh el-urus min xhevahiri-l-kamus*. P.v.b.: Dar el-hidaje. 2/275.; El-Xheuheri, Ismail bin Hamad. (1987) *Es-Sihab taxh el-lugati ve sihabu-l-arabijjeti*. Ed. 4. Bejrut: Dar el-ilm li-l-melajin. 1/109-10.; Ez-Zemahsheri, Mahmud bin Amr bin Ahmed. (1998) *Esasu-l-belagati*. Verifikimi shkencor: Muhammed Basil Ujun Es-Sud. Bejrut: Dar el-kutub el-ilmijeh. 1/188.

40. Ez-Zubejdi. (p.v.b.) *Taxh el-urus*. Op. cit. 2/276.

41. Shih: Ibn Mendhur. (1414 h.) *Lisanu-l-arab*. Op. cit. 1/317.; El-Xheuheri. (1987) *Es-Sihab*. Op. cit. 1/109-10.; Ez-Zemahsheri. (1998) *Esasu-l-belagati*. Op. cit. 1/188.

42. Shih: Ibn Mendhur. (1414 h.) *Lisanu-l-arab*. Op. cit. 1/317.; El-Xheuheri. (1987) *Es-*

1.1.2. Domethënia terminologjike

Në terminologji, i pari që konsiderohet të ketë dhënë një definicion për Ihtisabin është Maverdi në librin e tij të njohur *El-abkam es-sultanijje*, ku thotë: ‘*El-Hisbe është: Urdhërimi për të mirën kur të paraqitet braktisja e saj dhe ndalimi nga e keqja kur të paraqitet veprimi i saj*’.⁴³

Me kalimin e kohës janë dhënë definicione të shumta e të ndryshme, sidomos kur *el-hisbe* ka pësuar zhvillim strukturor si organ i shtetit. Muhammed El-Mubarek në librin e tij ‘*Ed-deuletü ve nidhamu-l-hisbeti inde Ibni Tejmije*’ thotë se El-Hisbeh është Mbikëqyrje administrative që organizohet nga shteti nëpërmjet nëpunësve të veçantë...⁴⁴ Si organ të këtillë e sheh edhe Dr. Suud bin Ferhan Muhammed El-Hablani El-Anzi, i cili Hisben e përcakton ndërmjet të qenët mbikëqyrje individuale apo shoqërore dhe mbikëqyrje shtetërore.⁴⁵

Është evidente se gjatë përshkrimit të definicioneve janë marrë dhe nuk janë marrë parasysht

Sihab. Op. cit. 1/109-10.; Ez-Zemahsheri. (1998) *Esasu-l-belagati*. Op. cit. 1/188.

43. El-Maverdi, Ali bin Muhammed. (1989) *El-Abkam es-sultanijeh ve-l-vilajat ed-diniyeh*. Verifikimi shkencor: Dr. Ahmed Mubarek El-Bagdadi. Kuvajt: Dar Ibn Kutejbe, f. 315.

44. Shih: Mubarek, Fejsal. (1967) *Ed-deuletü ve nidhamu-l-hisbeti inde Ibni Tejmije*. Damask: Dar el-fikr, f. 73-74.

45. Shih: Dr. Suud bin Ferhan Muhammed El-Hablani El-Anzi. “*Te’sil fikhu-l-ihtisab*”, revista Mexhel-letu Xhamiati-t-Tajjibeti li-l-Adabi ve-l-Ulumi-l-Insaniyjeti, viti 4, nr. 5, 1436 h. f. 12.

elemente të caktuara të konceptit të *Hisbes*, ose është anuar drejt një mendimi dhe në bazë të tij edhe është dhënë definicioni.

Prof. Bereket bint Mudif definicionin e Maverdit e sheh si më të mirin dhe më të përmbledhurin.⁴⁶ Megjithëkëtë, Dr. Abdullah bin Muhammed Abdullah ka dhënë një definicion që, për nga mënyra e formulimit, duket më i qartë dhe më përmbledhës, ndonëse nuk është larg atij të Maverdit. Pas analizimit të një sërë definicionesh, Dr. Abdullahu ofron këtë definicion: “*Pushtet i deleguar nga feja ose i ngarkuar nga prijësi (shteti), i cili i jep njeriut autoritetin të ushtrojë urdhërimin për të mirën kur të paraqitet braktisja e saj dhe ndalimin nga e keqja kur të paraqitet veprimi i saj, si dhe të ndëshkojë kundërshtarët (shkelësit e rendit dhe ligjit) në përputhje me normat fetare dhe kompetencat e tij*.”⁴⁷

Bazuar në definicionet që përshkruam, Ihtisabi përbëhet nga dy gjëra kryesore:

- 1) Urdhërimi për të mirë, dhe
- 2) Ndalimi nga e keqja.

Çfarë synohet me të mirën dhe me të keqen?

‘E mira’ është një emër i përgjithshëm që nënkupton çdo vepër të mirë, qoftë adhurim për

Allahun, respektim të porosive profetike, bamirësi ndaj robërve të Allahut, duke përfshirë këtu çdo gjë që është urdhër nga Allahu dhe çdo gjë që feja na ka nxitur ta veprojmë. Me një fjalë, është vetë feja. Ndërsa ‘e keqja’ përfshin çdo bindje, thënie, vepër që Allahu dhe i Dërguari i Tij e kanë urryer e refuzuar.⁴⁸

1.2. Vlera e urdhërimit për të mirë dhe ndalimit nga e keqja

1.2.1. Vlera e urdhërimit për të mirë dhe ndalimit nga e keqja

Urdhërimi për të mirë dhe ndalimi nga e keqja është imazhi identifikues i këtij umeti. Allahu e përshkruan kështu umetin e Muhamedit në Kur’an: “**Ju jeni populli më i mirë i dalë për njerëzimin: (sepse) ju urdhëroni që të bëhen vepra të mira, i ndaloni të këqijat dhe besoni Allahun...**” [Ali Imran: 110]

Ibn Kethiri duke e komentuar këtë ajet vë theksin se umeti islam është më i miri për shkak se është më i dobishmi për njerëzit dhe se më e mira që iu bëhet njerëzve është urdhërimi për të mirë dhe ndalimi nga e keqja.⁴⁹

Umeti islam, duke qenë se ka këtë mirësi, është i detyruar që ta ushtrojë urdhërimin për të mirë dhe ndalimin nga e keqja. Ja çfarë urdhëron Allahu: “**Le të dalë prej**

46. Shih: Bint Mudif, Bereket. (2007) *El-Hisbetu –ta’rifuha ve hukmuha ve erkanuha ve davabituha*. Medine Munevvere: botim privat, f. 21.

47. Abdullah, Abdullah Muhammed. (1996) *Vilajetu-l-Hisbeti fi-l-Islam*. P.v.b: p.sht.b. f. 60-61.

48. Shih: El-Kasir, Abdullah bin Salih. (1411 h.) *Tedbkiretu uli-l-gireti bi-sbeireti-l-emri bi-l-ma’ruf ve-n-nehji ani-l-munker*. Rijad: Dar el-Asimeh, f. 11-12.

49. Shih: Ibn Kethir. (1999). *Tefsiru-l-Kur’ani-l-Adhim*. Op. cit. 2/93.

jush një grup që të thërrasë për në mirësi, të urdhërojnë për vepra të mira e të ndalojnë prej veprave të shëmtuara! Këta njerëz do të jenë të shpëtuarit.” [Ali Imran: 104]

Qëllimi nga ky ajet është që të jetë një grup që merren me urdhërimin për të mirë dhe ndalimin nga e keqja, ndryshe, të gjithë janë të obliguar sipas mundësive që kanë.⁵⁰

Urdhërimi për të mirë dhe ndalimi nga e keqja nuk janë shufër hekuri e kamxhik; janë para çdo gjëje elemente me të cilat ruhet shoqëria dhe vlerat e mirëfillta brenda saj. Njeriu mund të ambientohet me antivlera dhe është pikërisht feja ajo që e çliron njeriun nga presioni dhe shtypja e këtyre antivlerave, duke e transferuar në ambientin e vlerave të mirëfillta. Ky, njëherazi, është prezantuar edhe si fakt logjik për konfirmimin e nevojës dhe obligimit për urdhërimin për të mirë dhe ndalimin nga e keqja.⁵¹ Kur’ani këtë organ e sjell si mjet me të cilin garantohej jetëgjatësia e vëllazërisë fetare.⁵² Thotë Allahu: **“Besimtarët**

50. Shih: Ibn Kethir. (1999). *Tefsiri-l-Kur’ani-l-Adhim*. Op. cit. 2/91.

51. Shih: Abdul Muttalib, Mahmud Muhammed Kemal. (2011) *Ehemmijetu-l-emri bi-l-ma’ruf ve-n-nahji ani-l-munker*. Libër i nxjerrë nga Liga e Botës Islame në kuadër të revistës Da’vetu-l-hakk, viti X, nr. 110, viti 1411/1991, f. 29.

52. Shih: Esh-Shajjë, Halid bin AbduRrahman. (p.v.b.) *Mekasidu Ehlil-Hisbeti ve-l-umuri el-hamileti lebum ala amelihim fi dav’i-l-Kitabi ve-s-Sunneti*. Rijad: Dar el-Belensijeh, f. 25.

dhe besimtarët janë miq për njëri-tjetrin. Ata urdhërojnë që të bëhen vepra të mira dhe i ndalojnë të këqijat;...” [Et-Teube: 71]

Urdhërimi për të mirë dhe ndalimi nga e keqja, siç shpjegoi Ibn Kethiri, është gjëja më e mirë që i ofrohet njerëzimit, sepse ta shpëtosh dikë nga zjarri i Xhehenemit, është më me rëndësi se çdo gjë tjetër. Nga këtu, Muhamedi (a.s.) ushtrimin e këtij institucioni brenda shoqërisë myslimane e ka përshkruar si lëmoshë rrjedhëse,⁵³ pra si diçka që të sjell shpërblim të përhershëm, sepse udhëzimi i dikujt në të vërtetën është fitimi më i madh në fe që mund të realizosh.⁵⁴

1.2.2. Rreziku i anashkalimit të urdhërimit për të mirë dhe ndalimit nga e keqja

Urdhërimi për të mirë dhe ndalimi nga e keqja është organ që siguron mirëqenien e popullit. Largimi i tij paraqet rrezik me potencial shkatërrues për shoqërinë. Profeti Muhamed (a.s.) duke dashur të na e shpjegojë këtë rrezik, merr shembullin e një anije me udhëtarë, një pjesë e të cilëve të vendosur poshtë, duke mos dashur të pengojnë ata që janë sipër, duan të hapin një

53. Fjala është për hadithin: “*Kush thërret në udhëzim ai do të ketë shpërblimin sikur të gjithë atyre që e pasojnë...*”, të cilin e transmeton Muslimi.

54. Fjala është për hadithin: “*Që All-llahu ta udhëzojë nëpërmjet teje një njeri është më e dobishme për ty se pasuria më e madhe.*”, të cilin e transmetojnë Buhariu dhe Muslimi.

vrime poshtë në anije që të marrin ujë për nevojat e tyre.

Nëse ata që janë sipër i lejojnë, atëherë anija fundoset e kështu fundosen të gjithë.⁵⁵ Nëse urdhërimi për të mirë dhe ndalimi nga e keqja mungojnë në shoqëri, atëherë shkatërrohen të gjithë. Kjo është e keqja që e godet shoqërinë në përgjithësi dhe që përmendet në Kur'an⁵⁶ dhe Sunet.⁵⁷

55. Hadithin e transmetojnë Buhariu (2493) dhe Tirmidhiu (2173).

56. Shih: Kur'ani: El-Enfalë: 25.

57. Shih hadithin e Hudhejfes (r.a.): “*Pasha Atë në Dorën e të Cilit është shpirti im, o do të*

Për këtë shkak, janë mallkuar ata që kanë braktisur këtë organ dhe kanë punuar me të keqen. **“Ata izraelitë që ishin mohues, u mallkuan me gjuhën e Dautit dhe të Isait, të birit të Merjemes, për shkak se kundërshtonin, shkelnin çdo kufi dhe nuk e ndalonin njëri-tjetrin të bënin vepra të këqija. Eh, sa të shëmtuara ishin veprat që bënin ata!”** [El-Maide: 78-79]

urdhëroni për të mirë dhe të ndaloni nga e keqja, o do të ketë gjasa e mundësi që All-llahu tua dërgojë një dënim, për largimin e të cilit do ta lusni por që nuk do t’iu përgjigjet.” Albani në Sahihu-l-xhamii, 2399.

Gjashtë shekuj islam institucional në Ballkan

Akademik Feti Mehdiu

Prishtinë

Abstrakt

Tezën e përhapjes së fesë Islame me dhunë në Ballkan, nga “pushtuesit aziatikë”, e kanë hedhur poshtë studiues të huaj, por edhe ata vendas, të cilët i trajtojnë me objektivitet çështjet historike.

Studiuesit objektivë, të pavarur nga ideologji të caktuara politike, me anë të hulumtimeve të tyre shkencore, dëshmojnë se, te shqiptarët, gjurmë të fesë Islame ka pasur edhe para se të vinin osmanlinjtë në këto anë. Ky është një realitet që nuk mund të mohohet e as të injorohet. Qëndron gjithashtu fakti se, para se të vinin Osmanët në këtë rajon të Ballkanit- në hapësirën shqiptare, në radhë të parë, feja islame nuk ishte e mbështetur institucionalisht, nga subjekte relevante shtetërore. Ajo prezantohet vetëm nga individë vullnetmirë: misionarë apo tregtarë, të cilët rastësisht kalonin nëpër këto troje.

Pas shthurjes së sistemit shoqëror komunist, në rajonin e Ballkanit perëndimor, ku bën pjesë populli shqiptar, që shtrihet në disa shtete: Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, Mali i Zi, Serbi, dhe populli boshnjak, teza se fenë islame e sollën me dhunë turqit (osmanët) për të asimiluar popullatën e këtyre vendeve, po

bie dhe dita-ditës po shkatërrohet. Derisa në vitet nëntëdhjetë të shekullit njëzet ajo tezë ngufaste frymën e studimeve e hulumtimeve objektive, tani mbretëron një frymë e re, më e lirë, me çka dëshmohet se sulltanati Osman ua mbrojti identitetin popujve të caktuar.¹

1. Hasan Kalesi, *Arnavutların millibekasının esas amilleri olarak turklerin Balkanlar fet-h*

Kjo frymë e re ka hapur perspektivë për shprehje të mendimit të lirë, të mbështetur në hulumtime shkencore objektive, pa droje nga sistemi politik në fuqi. Tani, tek-tuk, mund të gjendet ndonjë zë i shterur, i cili përpiqet të akordojë melodinë e dikurshme lidhur me këtë çështje, por ai zë do të heshtë para fakteve objektive historike.

Aty ku fillojnë të flasin argumentet, marrin fund thashethemet.

Tezën e përhapjes së fesë islame me dhunë në Ballkan, nga “pushtuesit aziatikë”, e kanë hedhur poshtë studiues të huaj,² por edhe ata vendas,³ të cilët i trajtojnë me objektivitet çështjet historike.

Studiuesit objektivë, të pavarur nga ideologji të caktuara politike, me anë të hulumtimeve të tyre shkencore, dëshmojnë se, te shqiptarët, gjurmë të fesë islame ka pasur edhe para se të

vinin osmanlinjtë në këto anë.⁴ Ky është një realitet që nuk mund të mohohet e as të injorohet. Qëndron gjithashtu fakti se, para se të vinin osmanët në këtë rajon të Ballkanit - në hapësirën shqiptare, në radhë të parë, feja islame nuk ishte e mbështetur institucionalisht nga subjekte relevante shtetërore. Ajo prezantohej vetëm nga individë vullnetmirë: misionarë apo tregtarë, të cilët rastësisht kalonin nëpër këto troje.⁵

Nëse shprehemi me terminologjinë e sotme, këtë formë të prezantimit të fesë islame në hapësirën ballkanike mund ta quajmë aktivitet i shoqatave joqeveritare.

Këtu dëshiroj të theksoj, pikërisht, dy faktorë dhe rolin e tyre në përhapjen dhe kultivimin e fesë islame dhe rrugëtimin e saj deri në ditët e sotme. Ato janë:

Faktori institucional, pas të cilit qëndron shteti, dhe faktori i dytë është organizimi vullnetar, pas të cilit qëndrojnë shkolla filozofike-fetare (të veshura me petk islam, me platformë të kombinuar) të ngjyrosur me filozofi mistike, pjesërisht të krishterë.⁶

ve islamijetininin yayılması, I. Miletlerarası Türkoloji Kongresi, İstanbul, 1979; shih:Koha ditore, 11 korrik, 2015, 18 korrik, 2015, 25 korrik, 2015, Prishtinë. Në tre vazhdimë botohet për herë të parë në gjuhën shqipe me titull: Ardhja e turqve në Ballkan dhe përhapja e Islamit, shkaqet themelore të vazhdimësisë etnike të shqiptarëve.

2. Tomas Arnold, *Historia e përhapjes së Islamit*, Prishtinë, 2010.

3. Muhamet Pirraku, *Shkaqet e kalimit në islam te shqiptarët*, Hëna e Re, korrik-gusht-shtator, 1992; *Emri kombëtar i shqiptarëve nuk është dhunë islame*, Dituria Islame, nr. 81-82, 1996, Prishtinë

4. Nexhat Ibrahim, *Islami në trojet iliro-shqiptare gjatë shekujve*, Prishtinë, 2000; Ilmi Veliu, *Islami në Ballkan arriti para Osmanëve*, Kërçovë, 2006.

5. Qemajl Morina, *E vërteta dhe paragjykimet për Islamin në Botë*, Feja, kultura dhe qytetërimi islam, Prishtinë, 1995.

6. Shyqyri Hysi, *Muslimanizmi në Shqipëri: 1945 – 1950*, Tiranë, 2006.

Edhe këto OJQ islame ndonjëherë kanë pasur përkrahjen e organeve shtetërore.

Sa i përket faktorit të dytë, që në fillim ai ngërthente në vete një dozë të madhe të misticizmit e mistifikimit të veprimtarëve e shkollave të tyre, siç është rasti me legjendat për Sari Salltëkun⁷, shehlerë e njerëz tjerë “të ardhur”. Këto teori dita-ditës zbehen dhe mbesin të vetmuara. Si rrjedhojë e mungesës së argumenteve të paqëndrueshme, në njërën anë, dhe, në anën tjetër, ngritjes së vetëdijes së besimtarëve, e mbështetur kjo në burime të shpallura dhe të shkruara, dalin në shesh dobësitë e atyre platformave të mbështetura në gojëdhëna të paqëndrueshme, që nuk mund t’i bëjnë ballë realitetit aktual.

Mbështetja kryesore e tyre, përgjithësisht, janë gojëdhëna të paverifikuara, të gatuar me brumin e misticizmit. Kjo nuk qëndron në raport të shëndoshë me bazat themelore islame: Kur’anin Fisnik dhe Hadithin e Pejgamberit Muhamed a.s.

Ndërsa faktori institucional, i mbështetur në organet e sistemit shtetëror, në përhapjen e fesë islame te shqiptarët edhe te boshnjakët, që në periudhën e parë dhe kontaktet e para me këtë hapësirë, disponon argumente historikisht të pakontestueshme dhe logjikisht të pranueshme gjatë tërë kësaj periudhe gjashtë shekullore.

7. Hasan Kaleshi, *Legjenda shqiptare për Sari Salltëkun*, Përparimi, nr. 1, 1967, Prishtinë, f. 85-103.

Ky faktor, për mbështetje kryesore në përhapjen e fesë islame, kishte platformën e mbështetur në Kur’an, si mbështetjen kryesore teorike dhe në objektin për adhurim dhe edukim e veprime të tjera me interes për shoqërinë njerëzore-xhaminë.

Xhamia dhe teqeja dallojnë ndërmjet tyre për sa i përket themelimit, dedikimit dhe funksionit. Teqeja i pranon pasuesit e vet përmes një procedure të caktuar graduale, deri kur të arrijnë të marrin lidhjen e drejtpërdrejtë (të marrin dorë) tek autoriteti i caktuar sipas hierarkisë së teqeve. Ndërsa xhamia i pranon ithtarët e fesë islame vetëm përmes Kur’anit dhe hadithit. Pejgamberi Muhamed a.s., atyre që shprehnin dëshirën për të pranuar fenë islame vetëm u rekomandonte të mësojnë ndonjë pjesë, sadopak nga Kur’ani.⁸ Për të qenë mysliman i xhamisë nuk i nënshtrohesh rregullës “gir de gor”,⁹ por lirisht mund ta shohësh, të mendosh e pastaj mund të vendosësh të pranosh apo të mos e pranosh. Xhamia ka obligime të caktuara me premtime për shpërblime, për vepra të mira të kryera, ose vetëm të planifikuara, si edhe kërcënime me masa ndëshkimore, për vepra të shëmtuara të kryera. Në teqe

8. *Al-Kur’anu-l-Kerim*, përktheu Feti Mehdiu, botim i tretë, Prishtinë, 2015; *Sabihu-l-Bubari në gjuhën shqipe*, Libri 10, Kreu 65, Prishtinë, 2014.

9. Shyqyri Hysi, *Muslimanizmi në Shqipëri: 1945 – 1950*, Tiranë, 2006.

zbatohet një platformë vetëm me premtime për shpërblime, duke iu shmangur disa ajeteve të Kur'anit, në të cilat flitet edhe për masat fizike disiplinore.

Gjallërimin dhe kultivimin islam në hapësirën ballkanike shqiptare, do ta vështrojmë në prizmin e këtyre dy themeleve: *Kur'anit dhe xhamisë*. Këto dy themele nuk ka mundësi të mistifikohen. Kur'ani është i vetmi burim, i cili ka imunitet absolut ndaj qasjeve eventualisht destruktive. Prandaj, bashkë me hadithin, konsiderohen themele të pakontestueshëm.

Xhamia e ka zanafillën që me kalimin e Muhamedit a.s. nga Meka në Medine, në vitin 622, kur u ndal në Kuba – sot lagje e Medinës, dhe themeloi xhaminë e parë në Islam.¹⁰ Themelimi dhe organizimi i teqeve i përket shekujve XII, XIII e këndej.

Duhet theksuar këtu se objekti i këtij shqyrtimi është, në plan të parë, **Feja Islame** dhe *jo Kultura Islame*.

Këto dy gjëra duhet dalluar dhe shqyrtuar veçmas nga njëra-tjetra.

Jo se janë në kundërshtim njëra me tjetrën, por për faktin se, me trajtimin e tyre si një fenomen, i hapet rrugë manipulimit dhe njerëzit janë të prirur për keqpërdorim. Thirren në njërën e veprojnë sipas tjetrës. Në gojë mban fenë, por në praktikë zbaton

kulturën. Shkon në xhami vetëm për bajram! Për namaz të xhumasë nuk gjen kohë, as për namaz të sabahut e të drekës, etj. Kohëve të fundit, studiues, publicistë e shkrimtarë të ndryshëm, kur flasin për këto çështje, herë thonë *feja islame*, herë thonë *kultura islame*. Disa herë thonë edhe *ideologjia islame*. Ngatërrimi i fesë islame me ideologji, çfarëdo qoftë epiteti tjetër, që shpeshherë e hasim “ideologjia islame”, është me pasoja dhe shpie në përfundime destruktive.

Fe-ja, në gjuhën shqipe është e barabartë me **“din”**(d-j-n).

Është me burim nga Kur'ani, në të cilin përmendet dhjetëra herë në diskurse të ndryshme, si fjala vjen në suret: Bekare: 153, 256, ... Al Imran: 19, 83; Nur: 2; Nasr: 2, dhe më në fund te sureja Kafirun, ajeti 6: *lekum dijnukum ve lije dijn*.¹¹ Ndërsa termi kulturë islame dhe ideologji islame nuk përmendet asnjëherë as në Kur'an as në hadithe të Muhamedit a.s.

Dallimi ndërmjet emërtimeve *fe islame* dhe *kulturë islame* qëndron në faktin se feja islame mbështetet në Kur'an dhe në hadith. Kur'ani dhe hadithi nuk janë ekskluzivisht për një popull të caktuar, por janë për tërë popujt e botës (*rahmeten lil-alemin*). Prandaj nuk mund të ketë *fe islame arabe*, *fe islame turke*, as *fe islame shqiptare*. As nuk mund të jetë islam arab, islam turk, islam shqiptar, islam

10. Kur'an-i kerim, sureja Tevbe, ajeti 18, 108. **Innema ja'muru... le mesxhidun ussise alat-takva...**

11. Kur'an-i kerim, sureja Kafirun, ajeti 6; El -Mu'xhemu-l-mufehres li alfazi-l-Kur'ani-l-kerim, “din”.

evropian, islam aziatik etj. Ndërsa kulturën islame, skeletin islam, mund ta veshin edhe me ndonjë element të ndonjë vendi apo populli të caktuar. Kjo mund të jetë e kushtëzuar me kulturën dhe traditën vendëse, me kushtet klimatike, rrethanat historike, etj. Rrjedhimisht mund të flitet për *kulturë islame shqiptare*, por kurrësi nuk mund të flitet për *islam shqiptar*, mund të flitet për *kulturë islame arabe, aziatike, evropiane, turke*, por emërtimi *islam arab, islam aziatik, islam evropian, islam turk* etj., është tendencioz dhe i pasaktë.

Ky fakt, do të thotë se feja islame mbështetjen e ka në dy burime: Kur'an dhe hadith, e jo në ideologji apo traditë të ndonjë regjioni të caktuar gjeografik. Kjo është garanci që kjo fe të vazhdojë gjallërimin e vet për një periudhë kaq të gjatë dhe në një hapësirë kaq të gjerë.

Në hapësirën e Ballkanit, respektivisht hapësirën shqiptare, për islam institucional mund të flitet saktësisht nga viti 1389 dhe 1396.

Dëshmia më e fortë për këtë është se ushtria turke, pas fitores te lumi Marica, në vitin 1371 dhe fitores në betejën e Kosovës, në vitin 1389, kur në Prishtinë vihet gurthemeli i Xhamisë së Madhe, e cila u ndërtua në vitin 1460, i vazhdoi luftërat dhe pasi arriti të vërë nën sundimin e vet edhe Kërçovën në vitin 1394, në vitin 1396 në rrëzë të kalasë së Kërçovës ndërtoi xhaminë, e cila quhet Sulltan Pajazit, ose xhamia e çarshisë, e cila

funksionon edhe sot. Përshkrimin e kësaj xhamie e ka përfshirë edhe Ekrem Haki Ayverdi në veprën e tij për monumentet e kulturës islame në Ballkan.¹²

Ky është objekti i parë për adhurim islam në Ballkan. Ndërsa, po në këtë hapësirë, gjithashtu në vitin 1396, për herë të parë në Jeni Pazar, te miniera Gluhavica, përmendet kadiu si institucion i jurisprudencës islame të sulltanatit osman, i cili vepron sipas ligjit të mbështetur në Kur'an dhe quhet sheriat.¹³ Në fakultetin e drejtësisë është studiuar dhe quhej "e drejta e sheriatit".

Përgatitja e terrenit për shtrirjen e fesë islame në hapësirën e Ballkanit ishte bërë në mënyrë të organizuar.

Në vitin 1385-86 ushtria osmane shtrin sundimin e vet në Shtip, Veles, Prilep, Manastir dhe arrin në bregdetin shqiptar.¹⁴ Në vitin 1391 edhe Shkupi bie nën sundimin osman¹⁵. Në vitin 1394 bie Kërçova, një qytezë në Jugperëndim të Maqedonisë.

Sulltanati Osman, platformën e vet për shtrirjen dhe mbajtjen e shtetit, e mbështeste në radhë të parë në formimin dhe kultivimin e drejtë

12. Ekrem Haki Ayverdi, *Avrupa'da Osmanlı Mimari Eserleri – Yugoslavya, cilt 3*, Istanbul.

13. Noel Malkolm, *Kosova, një histori e shkurtër*, Prishtinë, 2001.

14. *Istorija na Makedonskiot narod, knjiga prva*, Skopje, 1969.

15. Halil Inalxhik, *Osmansko Carstvo*, Beograd, 1974; *Istorija na makedonskiot narod*, Skopje, 1969.

moral e shpirtëror të popullatës ndaj së cilës shtrinte pushtetin e vet.¹⁶ Prandaj, pas nënshtrimit të qyteteve të përmendura në Maqedoni, pas një stabiliteti relativ dhe fitoreve solide të sulltan Bajazidit – themelues i Sulltanatit Osman prej Danubit deri në Eufrat – xhamia e parë që është vënë në funksion, me sa dihet deri tani, është xhamia Sulltan Bajazit, respektivisht xhamia e çarshisë, në Kërçovë.

Sulltan Jëlldërëm Bajaziti i jepte shumë rëndësi ndërtimit të xhamive, si një faktor i rëndësishëm për ngritjen morale të shtetit të tij dhe në këtë mënyrë zbatonte me konsekuencë platformën shtetërore. Ai, kur e mori Bursën, përveç ndërtimit të xhamive, kishte urdhëruar që të ndërtohet edhe kalaja, si pararojë ndaj sulmeve eventuale. Gjithashtu në anën aziatike të Bosforit, në vazhdim të këtij aksioni, është ndërtuar kalaja Anadoluhisar.¹⁷ Ndërkaq në Kërçovë kalanë e gjeti të gatshme.

Edhe kjo e dhënë është një nga faktet që e mbështesin përcaktimin e tij, që vetëm dy vjet pas rënies së qytetit në duar të turqve ta zgjedhë Kërçovën si pikë strategjike ku do të ndërtohet edhe xhamia rrëzë kalasë.

Ky ishte njëri nga faktet që dëshmon për ndërtimin e kësaj xhamie.

16. Halil Inalcik, ibid; Sulejman Dashi, *Xhamitë më të vjetra në Shqipëri*, *P e r l a*, nr. 2, 1996, Tiranë.

17. Halil Inalcik, ibid.

Fakti tjetër është shënimi që gjendet në administratën e bashkësisë islame të Kërçovës, në të cilin thuhet se xhamia Sulltan Pajazit është ndërtuar në vitin 1396. Me rastin e rinovimit të xhamisë në vitin 86-1984, është hequr pllaka me kronogramin që ka qenë e vendosur mbi derën e xhamisë, nga ana e jashtme, dhe nuk është kthyer më në vendin e vet. Praktikisht është shmangur dhe rezulton e humbur!

Në administratën e Këshillit të Bashkësisë Islame në Kërçovë, gjithashtu disponojnë me dokumentacionin kur është bërë sondimi nga brenda, me ç'rast janë zbuluar themelet e para në thellësi prej 1.80 m.

Vjetërsinë e xhamisë Sulltan Pajazit në Kërçovë e dëshmon edhe stili karakteristik i ndërtimit që paraqet një kombinim të arkitekturës islame-bizantine.*¹⁸

Myslimanët, të entuziazmuar dhe të bindur se feja e tyre është fe e drejtë, ishin të frymëzuar dhe të motivuar që të arrinin ta përhapnin kudo predikimin e fesë islame.¹⁹

Kjo në të njëjtën kohë është edhe platformë e luftës së pastër islame, qëllimi i së cilës nuk ka qenë

18. J. V. Hammer, *Historija turskog* (osmanskog) Carstva, 1, 2, 3, Zagreb, 1978; (Hammer, *Büyük Osmanlı Tarihi, birinci cilt, İstanbul*, (Üç dal neşriyyat); Sami Frashëri, *Kamusu-l-a'lam*, cilt: 1-6, İstanbul, 1889-1898, s.v. İstanbul.

19. Dr. Feti Mehdiu, *Nga Kërçova për Kërçovën*, Kërçovë, 1995.

të zhdukë popullin e besimit tjetër, por vetëm të sundojë.

Ndërtimi i xhamive, përmes së cilave arrihet më me sukses formimi dhe kultivimi institucional, formimi i drejtë me moral të shëndoshë, ishte pjesë përbërëse e platformës së shtetit të themeluar mbi bazat islame, siç ishte sulltanati osman gjatë shtrirjes së mbretërimit të vet në Ballkan.

Sot, në disa shtete të Ballkanit, si: **Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, Mal i Zi, Bosnjë dhe Hercegovinë** dhe **Serbi** janë rreth 3200 (tremijë e dyqind) xhami, të cilat janë në shërbim të kultivimit të Islamit institucional. Xhamitë janë transmetuese të burimit islam: *Kur'anit* dhe *hadithit*. Krahas këtyre ka edhe teqe e zavije, të cilat, po ashtu, janë në shërbim të Islamit. Mirëpo, meqenëse këto mbështeten kryesisht në personalitete autoritative islame, si: haxhi Bektash Veliu, Abdulkader Xhejlaniu, Xhelaluddin Rumi, etj., marrin karakter ideologjik.

Islami institucional i përhapur përmes xhamisë, një institucion i themeluar me Kur'an, në disa shtete të formuara pas shpërbërjes së sulltanatit osman, në Ballkan, si: Shqipëria, Jugosllavia²⁰, Bullgaria, etj., ka përjetuar situata shumë të rrezikshme, deri në shfarosje, por ndodh ajo që do Allahu, sepse Allahu nuk përdh dhunuesit.

20. Tomas V. Arnold, *Povijest islama, historijski tokovi misije*, Sarajevo, 1989; (botimi në gjuhën shqipe, Prishtinë, 2010, përktheu Nexhat Ibrahim.)

Në Beograd, pas kryengritjeve serbe, 1804-1815, nisi rrënimi i xhamive, si objekte që kultivonin islamin institucional. Batali xhamia,²¹ e ndërtuar në vitin 1532, Imaret xhamia, e ndërtuar në vitin 1549, e cila ndodhej jo larg objektit SANU,²² të sotshëm, u shndërruan në kafene "Proleqe", në objekte të administratës serbe, etj.²³ Aktualisht, në Beograd, ka mbetur vetëm xhamia Bajrakli (në rrugën Gospodar Jevremova, afër Kalemegdanit).

Vetëm në Beograd janë rrënuar xhamitë vijuese: Xhamia Ibrahim beg, Ibrahim Çelebi, Bajram beg, Çik xhamia, Xhamia e re, xhamia Hasan Ali aga, haxhi Hasan aga, Ganish aga, haxhi Halil, Dibag, Defterdar, Reis efendi, Zejnudin aga, Seid Hasan Pasha, sulltan Sulejman, (në Kalamegdan), Xhamia sagir, Haxhi Sadik, haxhi Salih, xhamia Abdulkhebar, xhamia Ali Pasha, xhamia Haxhi Ali, Këzlaraga, xhamia Gali, Kuçuk Hysejn, Kuçuk Lazar pasha, haxhi Kuçuk Veli, Koski beg, Haxhi Mehmed, Mehmed aga, haxhi Mahmud, Sulltan Mahmud, Ket-huda Ferhat, Mustafa Çaus, Mahxhur xhamia, Haxhi Nezir, Mina, Habil efendi, Jahja pasha dhe Haxhi Veli. Disa prej këtyre xhamive i ka

21. Muhamed Mufaku, *Taribu Belgrad islami-jje*, Kuvajt, 1987.

22. Srpska Akademija Nauka i Unetnosti në Beograd.

23. Mbretëria Serbe – Kroate – Sllovene; Serbia, Kroacia, Sllovenia, Bosnja e Hercegovina, Mali i Zi, Kosova, Maqedonia.

përshkruar edhe Evlija Çelebiu²⁴ edhe Muhamed Mufaku²⁵.

Në periudhën deri në vitin 1912, në Beograd, janë rrënuar edhe mesxhidet: Ebu Bekr efendi, baba Mahmud, Bazar pasha, Bejazid, Haxhi Durak, Dedezade, Haxher mesxhid, Xheman Hatun, Sulejman han, Haxhi Suka, Shamli hoxha, Osman, Haxhi Ali, Kazakli, Kestexhi, Kuçuk Pazar pasha, Kuçuk Mustafa, Musa pasha.

Sipas të dhënave që ofron udhëpërshkruesi i shekullit XVI, Evlia Çelebiu, në veprën e tij *Seyahatname*,²⁶ shihet se ai gjatë udhëtimeve të tij vizitoi dhe përshkroi xhami e mesxhide në tërë territorin e Ballkanit.²⁷ Disa i ka prezantuar me emra, kurse në disa vende është shërbyer vetëm me shifra.²⁸

Këtu do të përmendim disa prej tyre. Në Sombor ishte xhamia Sulejman han, Xhamia e pashës; në Illok, xhamia Sulejman han dhe Mehmet aga, afër së cilës ka pasur edhe një banjë publike (hamam); në Petar Varadin ishte xhamia Sulejman han në kala dhe disa të tjera në qytet; në Pozhegë ishte xhamia Sherklot, etj.

24. Divna Gjuriq – Zamolo, *Kontribut për njohjen e xhamive të Beogradit*, *Studime Orientale*, nr. 2, 2002, Prishtinë; *Prilozi za Orijentalnu Filologiju*, XV-XVI, 1960, Sarajevo.

25. Muhamed Mufaku, *Tarihu Beograd islamije*, Kuvajt, 1987.

26. Evlija Çelebi, *Seyahatname*, 1-6 cilt, Istanbul, (Uçdal yayinlar) Istanbul, s.a.

27. Evlija Çelebi, *Putopis*, Sarajevo, 1973, p. 85.

28. Evlija Çelebi, *Putopis*, Sarajevo, 1973.

Evlia Çelebiu edhe për Shqipërinë jep të dhëna me interes. Sipas tij, në Peshkopi ishte xhamia Memi pasha; në Gjirokastrë xhamia Hëzër aga, Haxhi Murat, sulltan Pajaziti i dytë, Memi pasha, Memi beg, xhamia e Palortos; në Skrapar xhamia Pajazit han; në Berat xhamia Uzkurli, Gazi Murat pasha, xhamia e Hunqarit, xhamia Fet-hije, xhamia Çelebi Hysen pasha; në Vlorë xhamia sulltan Sulejman, e ndërtuar në vitin 949 h., xhamia Memxhi zade, Hysen Aga, xhamia e Tabakëve; në Kavajë kishte katër xhami me minare; në Peqin ishte e njohur xhamia Abdurrahman pasha dhe Hariz Zade; në Elbasan ishin xhamitë: Gazi Sinan pasha, Hasan Balli zade, Biçakçi zade, Sinan beg dhe rreth 20 (njëzet) mesxhide; në Shkup kishte vizituar xhaminë e Hunqarit, xhaminë Jahja pashë, Karlo zade, te Ura e Vardarit, Koxha Mustafa pasha, xhaminë e kuqe – Is-hak beg dhe Isa beg; Manastiri kishte xhaminë Is-hak efendi, te ura, xhaminë Mahmut efendi, Gazi Hajdar pasha, Haxhi beg, Sungur çaush; në Shkodër përmend xhamitë: Sulltan Pajazit, Hysen beg, Karahysen.²⁹

Presioni ndaj fesë islame në Ballkan, gjatë shekullit XIX, vinte duke u shtuar dita-ditës, duke zbatuar forma të ndryshme të dhunës.

E njëjta gjendje vazhdoi pas luftërave ballkanike edhe pas

29. Evlija Çelebi, *Shqipëria para tre shekujsh*, Tiranë, 1930, 2000; *Evlija Çelebiu në Shqipëri dhe në viset fqinje: Kosovë, Mal i Zi, Ohër, Tiranë*, 2008.

përfundimit të Luftës së Parë Botërore. Mbretëria Serbe – Kroate – Sllovene, vazhdoi një shtypje sistematike kundër institucionit të xhamisë dhe aktiviteteve të tij. Kohë pas kohe rrënohej ndonjë xhami me pretekstin se pengonte realizimin e planit urbanistik. Merreshin masa ndëshkuese ndaj personelit që shërbente në këto institucione, si: imam, myezin apo këshilltar xhamie. Qëllimi i këtyre veprimeve ishte të pengohej kultivimi i vlerave islame. Numri i xhamive u zvogëlua në masë të madhe. Në disa vende nuk mbeti asnjë xhami, kurse në Beograd mbeti vetëm xhamia “Bajrakli”. Gjendja në ish sanxhakun e Nishit është edhe më e errët.

Përkundër faktit se Princ Nikolla i Malit të Zi, më 20 janar 1912, e kishte emëruar me dekret mbretëror myfti për myslimanët e Malit të Zi, Murtez ef. Karagjuzoviqin, rrënimi i xhamive vazhdonte. Vetëm në Mal të Zi u rrënuan me themel xhamitë: Sulltan Selim, Sulltan Murati i tretë (Orta xhami), Ahmed beg – Lonxha, Shkanjeviqja – në Tivar; Gradska xhamia, xhamia Hareme – në BERANE; xhamia Bihor, Handar pasha, Fetahija, xhamia Bioça, Haxhidanusha në ashik mëhallë, Haznedar Mehmed aga, xhamia në Ivanj dhe xhamia Zaton – në Bjello Polje, Kollashin dhe Mojkovac; xhamia e kalasë – në Nikshiq, Sulltan Ahmet, Hysejn aga, xhamia e mëhallës, xhamia e Grlit – në Shpuz (Danilovgrad); Sulltan Mehmeti i dytë-Fatih, sulltan Pajaziti i dytë-te sahat kulla, Sinan pasha, Murteza pasha, pastaj edhe

mesxhidi Sulejman agë Rama, haxhi Abdullah aga, xhamia në Risan, xhamia në Sutorini, xhamia e bardhë në Hercegnovi - dhe këtu nuk ka asnjë xhami sot. Xhamitë u rrënuan edhe në: GUSI: Sulltan Ahmet xhamia, Gjylbegu, Alibegu, Qosaj (ndërmjet Gusinje dhe Vuthajve); PLAVË: në Nokshiq, Turi, xhamia e nizamit, Rzhanica e epërme; PLEVLJE: Xhamia haxhi Hasan, Odabasha, Misirli Ahmed beg Jusuf kadi, Bubica, Hamidija; PODGORICË: Mehmed Han xhamia, Draçka, Glavatoviqi, Hadroviqi xhamia në Medun, Golubovci, Goriqani; Stara Crna Gora: Zhabljak, Çekliqi, Balija, Virpazar, Staniseljiqi, Obod, Cetinje dhe xhamia në Dupil; ULQIN: Xhamia e marinarëve - Rana, xhamia Meraje, xhamia Meterizi.³⁰

Gjatë sundimit të mbretërisë SKS (serbe- kroate- sllovene), në Shkup, tek Ura e gurit – në të djathtë të lumit Vardar, është rrënuar Burmal xhamia, objekt emblematik i arkitekturës islame.

Xhamia si institucion islam e pësoi shumë rëndë nga sistemi komunist që u instalua në Shqipëri pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore.³¹

Pas përfundimit të Luftës Dytë Botërore – me ngadhënjimin e sistemit komunist – Tiranë zyrtare nisi përndjekjen sistematike kundër xhamisë dhe elementit fetar në

30. Hadžiosmanović, Husein, *G l a s n i k* VIS-a, nr. 2, 5, 1982, Sarajevo.

31. Sabit Uka, *Jeta dhe veprimtaria e shqiptarëve të Sanxhakut të Nishit*, Prishtinë 1995 (libri 4.)

përgjithësi. Në vitin 1967, me dekret shtetëror nr. 4262, të lëshuar nga Presidiumi i Kuvendit Popullor, me datë 1 prill 1967, u ndaluan të gjitha aktivitetet fetare dhe “... të gjitha pasuritë, e tundshme dhe të patundshme të komuniteteve fetare kaluan në dispozicion të komiteteve të partisë... ose iu dorëzuan kooperativave bujqësore.” Mbylli, rrënoi apo ua ndërroi funksionin 2169 objekteve fetare, pa përjashtim: të krishtera apo islame, kështu që qindra xhami u zhdukën fare.³² Dekreti i Presidiumit për ndalimin e fesë, i vitit 1967, u inkorporua në Kushtetutën e Shqipërisë të vitit 1976.³³ Kjo situatë më së shumti goditi elementin islam dhe xhaminë, sepse të krishterët edhe më tutje ditën e diel e kishin të lirë – festë zyrtare javore – kurse dita e xhuma, namazi kolektiv i definuar me Kur’an,³⁴ deri në vitin 1990 u harrua tërësisht në kufijtë e Shqipërisë politike, respektivisht Shqipërisë Londineze.³⁵

Pas këtij akti të paprecedent në historinë e shteteve, vetëm në Tiranë u rrënuan ose iu ndryshua funksioni: Xhamia e Sulejman Pashës, xhamia e Met Firës, xhamia e Zajmit, e Stërmasit, xhamia e Karapicit, e Tetovës, xhamia e Balit, xhamia e Vathit, xhamia e varrit të Bamit, xhamia e Bërxollit, e Islam Allës, Sheh Zelës, Xhamia me

teneqe, xhamia e sheh Voglit, xhamia e Tabakëve, xhamia Dine Hoxha, etj.³⁶

Të njëjtin fat e pësuan qindra xhami në kufijtë e Republikës së Shqipërisë.

Në Kosovë, Maqedoni, Bosnje e Hercegovinë dhe Mal të Zi, që ishin në përbërje të shtetit të quajtur Jugosllavi, zyrtarisht ishin të lira institucionet fetare – edhe xhamia, por vazhdimisht mbahej nën lupë, si institucione që nuk e përkrahnin sistemin shtetëror komunist, sepse ishte sistem i imponuar me dhunë. Rrënimi i xhamive vazhdonte, me arsyetimin se ishin pengesë e realizimit urbanistik. U rrënuan xhamia Junus efendi në Prishtinë, te Teatri kombëtar i Kosovës, Tupan xhamia, në Tetovë, në mes të qytetit, që sot është park i Shtëpisë së Kulturës, xhamia në qendër të Gostivarit, që aktualisht është park i qytetit.

Kohë pas kohe arrestohej dhe dënohej me burgim të rëndë ndonjë imam apo pari tjetër islame, si element i rrezikshëm për sistemin komunist, si Hysejn Xhozo, në Sarajevë, hafiz Sulejman Shehapi, hafiz Abdullahu, mulla Garipi, në Tetovë, Shaban efendija në Kumanovë, hafiz Jakupi në Prizren, hafiz Nazimi në Kërçovë³⁷, etj.

Këto veprime ishin sinkronizim i projektit për ndjekjen deri në shfarosje të elementit joslav në këto troje, të cilin

32. Bajro Agović, *Džmaije u crnoj Gori*, Podgorica, 2001.

33. Roald Hysa, *Xhamitë e Tiranës*, Tiranë, 2008.

34. Musa Ali Basha, *Rrugëtimi i fesë islame në Shqipëri: 1912 -1967*, Tiranë, 2011, f. 525.

35. Ibid. f. 429.

36. Roald Hysa, ibid.

37. Feti Mehdiu, *Hafizët tanë*, Prishtinë, 2010, f. 206; Të burgosurit politik shqiptarë të Kërçovës, 1944-1994, Prishtinë, 2011.

e kishin përpiluar Ilija Garashanini, Vasa Çubrilloviqi, i bekuar nga Ivo Andriqi³⁸ dhe e zbatonte aparati shtetëror i Jugosllavisë Avnojiste. Kulmimi i kësaj gjendje arrin me luftërat e fundit që bëri Serbia (në emër të Jugosllavisë) në vitet 1991-1999, në Kroaci, në Bosnje dhe në Kosovë.

Në Bosnje dogji dhe shkatërroi 94 xhami,³⁹ në Kosovë, vetëm në periudhën e luftës së fundit -1997-1999, u dogjën dhe u shkatërruan 218 xhami.⁴⁰ Madje kjo valë – djegia e shembja e xhamive – e përfshiu edhe Maqedoninë.⁴¹ Gjatë luftës së fundit në Kosovë 1997-1999, përveç vrasjes së disa imamëve, u përdor edhe djegia e trupit të tyre.⁴²

Sistemi komunist, që u vendos pas Luftës së Dytë Botërore, në këtë pjesë të Ballkanit, ushtroi presion shumë më të madh, sidomos në Shqipëri, me **burgosje dhe dënime deri në 20 vite, me pushkatime e me internime. Me burg u dënuan:** hafiz Ibrahim

38. Spastrimi etnik, Tiranë, 2010; *Serbian barbarities against islamic monuments in Kosova: February '98 june '99*, Prishtina, 2000 (me legjenda në gjuhën angleze dhe arabe).

39. Glasnik VIS-a, 1982- 1988, Sarajevo

40. *Serbian barbarities against islamic monuments in Kosova: February '98 june '99*, Prishtina, 2000.

41. Plagët e pavdekshmërisë (wounds of eternity), Shkatërrimi dhe dëmtimi i objekteve fetare islame gjatë luftës në Maqedoni, Shkup, 2002. E përgatiti Behixhidin Shehapi.

42. Ramadan Shkodra – Sadik Mehmeti – Agim Gashi, Imamët shehidë në luftën e fundit në Kosovë, 1989-1999, Prishtinë, 2010.

Dalliu, hafiz Ismet Dibra, hafiz Sabri Koçi, Haki Sharofi, Jonuz Bulej, Vexhi Buharaja, Ibrahim Hasnaj, Ismail H. Muçej, Faik Q. Hoxha, Hasan Tahsin – Haveriku, hafiz Sherif Langu, hafiz Musa Dërguti, hafiz Ali Tari, hafiz Mustafa Varoshi, sheh Ali Pazari, etj.

U pushkatuan: Shyqyri Myftiu, Baba Hajro Progonati, sheh Ibrahim Karbunara, sheh Qerim Delvina, etj.

U internuan: hafiz Ali Korça, Baba Reshat Bardhi, dr. Behxhet Shapati, sheh Qazim Hoxha, etj. Disa vdiqën nëpër burgje: Halil Hoxha, Hoxhë Dusha i Tropojës, Imam Shabani, Baba Myrteza Kruja, Nebih Novosella, Zenel Hoxha, Baba Muço, etj.⁴³

Megjithatë, mbijetesa dhe gjallërimi i xhamive, si institucion i themeluar sipas platformës Kur'anore, sepse: *“ussise alat-takva...”* pas këtyre peripecive vazhdoi rrugëtimin e tij. Aktualisht në Kosovë janë 713 xhami, në Maqedoni, 657, në Shqipëri ka 694 xhami, në Mal të Zi janë 123, kurse 71 janë rrënuar pas vitit 1912 - dhe nuk ekzistojnë më,⁴⁴ në Bosnje dhe Hercegovinë ka rreth 800 xhami, në Sanxhak e Luginë të Preshevës - Serbi, janë 220 xhami.

Qëndresën – rezistencën e Islamit institucional në Ballkan e ka ndihmuar në masë të madhe institucioni i vakëfit dhe dhuruesit e devotshëm të vakëfeve, të cilët në vakëfet e dhuruara

43. Musa Ali Basha, *Rrugëtimi...* Tiranë, 2011, f. 427.

44. Bajro Agović, *Džmaije u crnoj Gori*, Podgorica, 2001.

e kishin caktuar shumë qartë që në xhaminë, së cilës i referohet vakëfi, të lexohej Kur'an pas namazit të jacisë, pas namazit të sabahut, pas namazit të drekës, etj. Disa herë e kishin caktuar edhe cila sure të lexohej: Jasin, Kehf, Fet-h, etj., dhe si të lexohej. Kishin theksuar se ai që këndon duhet të ketë zë të bukur, të lexojë me texhvid. Kishin saktësuar edhe sa duhet të paguhet.⁴⁵

Mënyra tjetër e përhapjes së fesë islame në këto troje ka të bëjë me misionarët e ndryshëm, të cilët më vonë i gjejmë nën platformën e shkollave filozofike islame. Me fjalë të tjera i gjejmë të organizuar si drejtime sufiste, të cilat historia shqiptare i njeh si sekte fetare islame. Shkolla më e njohur filozofike islame, apo tarikati më i njohur në trojet shqiptare, madje në përgjithësi në Ballkan, është tarikati Bektashi, themeluar në Anadoll nga Haxhi Bektash Veliu, në shekullin 13 dhe 14.

Sot, në hapësirën ballkanike: Kosovë, Shqipëri, Maqedoni, Bosnjë e Hercegovinë, gjallërojnë edhe shkolla të tjera filozofike islame, (sekte fetare) si Sadi, Kaderi, Melami, Halveti, Rifai, etj.⁴⁶

45. Hasan Kaleshi, *Vakufnamet më të vjetra në gjuhën arabe në Jugosllavi*, Prishtinë, 2012.

46. Xhemal Qehajiq, *Dervishki redovi u Jugoslovenskim zemljama*, Sarajevo, 1986; Jashar Rexhepagiq, *Dervishët, rendet dhe teqetë*, Prishtinë, 1999; Dr. Mehmet Eroz, *Türkiye'de alevilik –bektashilik*, Istanbul, 1977.

Të gjitha këto, nëse i shikojmë në prizmin e zhvillimeve bashkëkohore të aktiviteteve politike e shoqërore, sipas funksionit dhe rolit që kanë luajtur gjatë historisë, madje që vazhdojnë ta kenë edhe sot, mund të quhen Organizata Joqeveritare Islame (OJQI). Nuk ka dyshim se, edhe këto, me angazhimin e tyre, kanë kontribuar në përgatitjen e këtij opinionit për të pranuar normat e reja fetare, normat islame, të cilat ngarkonin ithtarët, që sapo i bashkoheshin kësaj feje, me disa obligime, të cilat më parë nuk i kanë njohur banorët e këtyre trojeve, si agjërimin një muaj, namazin pesë herë në ditë-individualisht, një herë në javë dhe dy herë në vit me namaz kolektiv, ashtu edhe me dhënien e zekatit, që nuk ishin të njohura deri atëherë. Këto norma, në atë kohë, i zbatonin personalisht ithtarët e këtyre shkollave dhe pasuesit e tyre.

Institucionet shtetërore të kohës sigurisht i kanë përcjellë aktivitetet e këtyre shkollave (OJQI) dhe pas plotësimit të detyrave të precizuara me Kur'an dhe me hadith (shariat), atyre u është lejuar edhe një aktivitet tjetër si superstrukturë shoqërore, nën petkun e së cilës, më vonë, disa prej atyre shkollave përqaftuan vetëm zbatimin e akteve të superstrukturës dhe i injoruan, ose i deformuan disa nga detyrat themelore islame të përcaktuara në Kur'an, si namazi, agjërimi, etj.

Këto rryma të Organizatave Joqeveritare Islame, në mungesë të burimeve të shkruara e të sakta nga themeluesit e atyre shkollave, platformën e veprimeve të tyre e mbështesnin në traditën gojore në një rreth hermetik. Në këtë mënyrë, dalëngadalë, në disa sosh u ngulitën lloje adhurimi dhe doktrina nga filozofitë e Lindjes, që kishin depërtuar tek ata përmes krishterimit. Të përmendim këtu, si ilustrim, formën e agjërimit, i cili është si agjërimi i të krishterëve. Ky lloj agjërimi është për një kohë të caktuar ku nuk përdoren yndyrëra. Ushqimet e tjera dhe pijet, përveç ujit, nuk i ndalin.

Disa syresh kanë prekur edhe në bazat e besimit islam. Ata, në kundërshtim me Kur'anin, sipas të cilit... *inne ekremekum indallahi etkakum...*⁴⁷ mendojnë se familja e Muhamedit a.s. ka privilegje vetëm për faktin se rrjedh nga pejgamberi dhe këtyre u takon të vazhdojnë qeverisjen e popullit arab, pas vdekjes së Muhamedit a.s. Kjo qasje ka shkaktuar luftëra e gjakderdhje ndër vëllazërore në mesin e shoqërisë islame të sapo formuar, për qëllime të primatit politik. Atyre qëllimeve politike u kanë veshur ngjyra fetare-islame, duke u përpjekur të fusin në lojë edhe Kur'anin dhe hadithin si burime të pakontestueshme për bazat e mirëfillta islame.

47. Kur'an, El-Huxhurat, 13.

Kjo çështje del në sipërfaqe menjëherë pas vdekjes së kalifit të katërt, Aliut r.a. dhe e përcjell zhvillimin e jetës islame, deri sot, diku më shumë e diku më pak.

Prandaj këtu duhet ndarë feja islame nga kultura islame. Kjo forma e dytë është shprehje e kulturës islame, e ngjizur në periudha dhe rrethana të caktuara arabe.

Në këto interpretime ata strehohen nën hije të autoriteteve reale ose të imagjinuar dhe në mendimin e lirë të individëve të politizuar, për të futur grindje ndërmjet ithtarëve të fesë islame. Ata u japin interpretime kuturu disa ajeteve të Kur'anit, vetëm për të gjetur hapësirë ideja e tyre për ndonjë ndalesë, siç është alkooli, apo për të siguruar marrjen e pushtetit - me anë të linjës trashëgimore.⁴⁸

Këtu nuk jemi thelluar në historikun e lindjes dhe zhvillimit të atyre dallimeve, por mendoj se këto dallime, që janë të pranishme sot, nuk kanë ekzistuar në kohën kur kanë jetuar Haxhi Bektashi, Xhejlani, Muhjiddin Arabiu e mistikë të tjerë. I përmendëm këtu me qëllim të sqarimit të këtyre dy formave të gjallërimit islam, përhapjes, mbijetesës dhe aktualitetit të fesë islame deri në kohën tonë.

48. Xhemal Qehajiq, Dervishki redovi u Jugoslovenskim zemljama, Sarajevo, 1986; Jashar Rexhepagiq, Dervishët, rendet dhe teqetë, Prishtinë, 1999; Dr. Mehmet Eroz, Türkiye\de alevilik -bektashilik, Istanbul, 1977.

Këto dy forma të depërtimit dhe të kultivimit islam në Ballkan janë edhe sot. Mendimet e studiuesve e të pseudostudiuesve, mendime se feja islame në Ballkan, te shqiptarët dhe boshnjakët, ka arritur, ka gjallëruar dhe do të gjallërojë falë aktivitetit të rrymave apo shkollave filozofike islame, të cilat ata i quajnë sekte mistike, përparimtare dhe të përshtatshme për nevojat kombëtare, nuk qëndrojnë.

Ndërkaq argumentet flasin se fillimet, përhapja dhe gjallërimi islam në Ballkan, konkretisht në hapësirën shqiptare, janë të lidhura ngushtë edhe me një lidhje të qëndrueshme e afatgjatë me veprimin e institucionit të xhamisë, si një institucion i mbështetur në Kur'an. Institucionet shtetërore të sulltanatit osman, kur arritën ta vënë nën sundim Ballkanin, në mbështetje të Kur'anit dhe hadithit, si dy burimet e pakontestueshme të fesë islame, ndërtuan mekanizmat e nevojshme legale për veprim dhe zbatim të këtyre dy burimeve të Islamit. Ndërtuan xhami si parakusht për të përgatitur njerëz me moral të shëndoshë, në formë legale. Këtë e dëshmon fakti se në të njëjtin vit kur u ndërtua xhamia e parë në këto

hapësira, në vitin 1396 - në Kërçovë, kemi edhe caktimin e institucionit të jurisprudencës islame - kadiun në Jeni Pazar, si një instrument përcjellës i zbatimit të bazave islame.

Këto institucione erdhën duke u shtuar dhe asnjëherë nuk ranë në ndikimin e ideologjive të ndryshme, sepse për to Kur'ani ishte, mbi të gjitha, rregulluesi më i mirë i jetës, në luftë, në paqe dhe pas paqes.

Vetëm ashtu arritën që deri më ditët e sotme, për 620 vitet e kaluara, të bëjnë jetë aktive, herë më shumë e herë më pak, por asnjëherë të gjunjëzuar para ideologjive, si platforma të përgatitura nga njerëzit e zakonshëm, nën ndikim të qarqeve të ndryshme. E ardhmja e tyre do të jetë e ndritshme nëse vazhdojnë të ndjekin rrugën e Kur'anit dhe të sunetit të Muhamedit a.s.

Historia duhet mbështetur në argumente morale dhe materiale, të verifikuara. Nëse mbështetet në mite nuk ka ardhmëri.

Popujve të Ballkanit u mjaftojnë argumentet për një histori të mirëfilltë.⁴⁹

49. *Ky studim është botuar në turqisht në **Balkanlar'da Islam**, Vëllimi i tretë, Ankara, 2016. Në gjuhën shqipe botohet për herë të parë.*

Sanxhaku i Shkupit në fund të shek. XIX dhe në fillim të shek. XX

Dr. Hasan Bello
Qendra e Studimeve Albanologjike,
Instituti i Historisë, Tiranë

Abstrakt

Vilajeti i Kosovës pjesë e të cilit ishte Sanxhaku i Shkupit në fund të shek. XIX dhe në fillim të shek. XX, shtrihet në pjesën perëndimore të territoreve evropiane të Perandorisë Osmane, me një sipërfaqe prej 32.000 km. Në Lindje ai kufizohet me Bullgarinë, në Perëndim me Vilajetin e Shkodrës, Bosnjën dhe Malin e Zi, në Jug me Selanikun, ndërsa në Veri me Serbinë. Për shkak të pozitës gjeopolitike që zinte ky vilajet, e në këtë kuadër edhe Sanxhaku i Shkupit, e kishin kthyer atë në vilajetin më të rëndësishëm e njëkohësisht një nga më problematikët e perandorisë.

Duke pasur parasysh infrastrukturën (stacionin hekurudhor), shëndetësinë, rrjetin telegrafik, kushtet e nevojshme që evitonin harxhimet suplementare, si dhe faktin se ky qytet nuk gjendej në zonë kufitare, Shkupi - sipas tij - i kishte të gjitha premisat për t'u bërë qendër vilajeti. Në vitin 1888, qeveria osmane, me të drejtë vendosi që qendra e Vilajetit të Kosovës të zhvendosej në Sanxhakun e Shkupit.

I.-Struktura administrative e Sanxhakut të Shkupit

Vilajeti i Kosovës, pjesë e të cilit ishte Sanxhaku¹¹ i Shkupit në fund të

1. Sanxhaku ishte një nga njësitë administrative më të rëndësishme të strukturës së Perandorisë Osmane. Kuptimi etimologjik i kësaj fjale turke vjen nga shkopi me majë të mprehtë në të cilin

shek. XIX dhe në fillim të shek. XX,

vendoset flamuri. *Shih: J. Deny, "Sancak", Islam Ansiklopedesi, İstanbul: Türkiye Diyanet Vakfı, 1988, X. cilt, s. 187; M. Fuad Köprülü, "Bayrak", Islam Ansiklopedesi, İstanbul: Türkiye Diyanet Vakfı, 1988, II. cilt, s. 401; İsmail Hakkı Uzunçarşılı, Osmanlı devleti teşkilâtına medhal, İstanbul: Türk Tarih Kurumu, 1970, s. 73; Metin Kunt, Sancaktan Eyalete 1550-1650 Arasında Osmanlı Ümerası ve İl İdaresi, İstanbul: Boğaziçi Üniversitesi, 1978, s. 16.*

shtrihej në pjesën perëndimore të territoreve evropiane të Perandorisë Osmane, me një sipërfaqe prej 32.000 km². Në Lindje ai kufizohej me Bullgarinë, në Perëndim me Vilajetin e Shkodrës, Bosnjën dhe Malin e Zi, në Jug me Selanikun, ndërsa në Veri me Serbinë. Për shkak të pozitës gjeopolitike që zinte ky vilajet, e në këtë kuadër edhe Sanxhaku i Shkupit, atë e kishin kthyer në vilajetin më të rëndësishëm e njëkohësisht një nga më problematikët e perandorisë.

Megjithëse qendra e vilajetit ishte në Sanxhakun e Prishtinës, nga dokumentacioni i kohës vihet re se më 4 gusht 1878, disa persona nga paria e Prizrenit i drejtojnë autoriteteve të kohës kërkesën që qendra e vilajetit të zhvendosej në këtë qytet me justifikimin se, në Prishtinë, nuk ekzistonin kushte të përshtatshme për administratën dhe nëpunësit. Ndërsa në Prizren ato ishin më të mira, për shkak se ky qytet kishte qenë edhe më parë qendër vilajeti.²²

Në vitin 1888 u ngrit përsëri si çështje që qendra e vilajetit të zhvendosej në Sanxhakun e Shkupit, sepse Shkupi shërbente si nyje lidhëse për të gjithë zonën, aty gjendeshin edhe disa konsullata të huaja, si konsullata austriake, ruse, serbe, greke, etj.³³ Në një shkresë që valiu

i Kosovës i dërgoi kryeministrisë më 18 gusht 1887, duke mbështetur variantin e mësipërm, argumentonte se, që kur Nishi i ishte aneksuar Serbisë, Prishtina e kishte humbur peshën dhe rëndësinë politiko-administrative. Duke pasur parasysh infrastrukturën (stacionin hekurudhor), shëndetësinë, rrjetin telegrafik, kushtet e nevojshme që evitonin harxhimet suplementare, si dhe faktin se ky qytet nuk gjendej në zonë kufitare, Shkupi - sipas tij - i kishte të gjitha premiset për t'u bërë qendër vilajeti.⁴⁴ Në vitin 1888, qeveria osmane, me të drejtë vendosi që qendra e Vilajetit të Kosovës të zhvendosej në Sanxhakun e Shkupit.⁵

Nga pikëpamja administrative, Vilajeti i Kosovës, në vitet 1877-1878 përbëhej gjithsej nga shtatë sanxhaqe (nga Sanxhaku i Prishtinës, Sanxhaku i Prizrenit, Sanxhaku i Shkupit, Sanxhaku i Nishit, Sanxhaku i Shehirkujit, Sanxhaku i Pazarit të Ri dhe Sanxhaku i Dibrës), të cilët, përfshinin gjithashtu edhe disa njësi

4. BOA, IRADE MECLIS-I MAHSUS 4241.

5. Përpjekjet për zhvendosjen e qendrës së vilajetit nga popullsia e qytetit të Prishtinës dhe Prizrenit vazhduan në mënyrë të pandërprerë, duke i dërguar vazhdimisht kërkesa dhe lutje qeverisë osmane, por, megjithatë ato nuk u morën në konsideratë dhe deri në vitin 1912 qendra e vilajetit vazhdoi të mbetej Sanxhaku i Shkupit. BOA, YA-Hus. 405/88; H. D. Andreasyan, "Osmanlı Rumelisi Tarih ve Coğrafyası", *Güney Doğu Avrupa Araştırmaları Dergisi* 2-3, (1972-1974), s. 11-88 dhe 4-5 (1975-1976), s. 101-152.

2. Başbakanlık Osmanlı Arşivi (Arkivi i Kryeministrisë së Perandorisë Osmane, më tej: BOA), ŞD. MLK 1965/12.

3. *Kosova Vilayeti Salnamesi*, Hicri 1314 (1896-1897), s. 178-179.

më të vogla administrative si: 27 kaza⁶, 8 nahije⁷ dhe 1400 fshatra.⁸

Pas luftës ruso-turke nga ky vilajet do të shkëputet Sanxhaku i Nishit dhe Sanxhaku i Shehirkojit, të cilët do t'i aneksohen Serbisë duke e zbritur në pesë numrin e sanxhaqeve.

Ndërsa në vitet 1878-1879 Vilajeti i Kosovës përbëhej nga:

1. Sanxhaku i Prishtinës (si qendër vilajeti), me kazanë e Prishtinës, Pejës, Gjilanit dhe Preshevës.

2. Sanxhaku i Shkupit, me kazanë e Shkupit, Kumanovës, Koçanës, Kratovës, Palankës, Ishtipit, Radovishtës dhe nahijen e Kaçanikut.

3. Sanxhaku i Prizrenit, me kazanë e Prizrenit, Tetovës,

6. Kazaja ishte pjesë përbërëse e sanxhakut dhe në krye të saj qëndronte kadiu; si njësi administrative ajo filloi të aplikohet në gjysmën e dytë të shek. XVI dhe në fillim të shek. XVII, ndërsa pas shek. XVIII atë e gjejmë kudo nëpër territoret e Perandorisë Osmane. *Shih: Mehmet Ali Ünal, Osmanlı Müesseseleri Tarihi*, Isparta: "Fakülte Kitabevi", 1997, s. 235.

7. Nahija bashkë me fshatin ishte njësi më e vogël administrative, kryesisht ajo përfshinte një zonë me karakteristika të veçanta gjeografike dhe sipas rregullores së organizimit administrativ të vitit 1864, çdo fshat popullsia e të cilit kalonte 500 frymë, kishte të drejtën të formonte një nahije. *Shih: M. Tayyib Gökbilgin, "Nâhiye", İslam Ansiklopedisi*, İstanbul: "Türkiye Diyanet Vakfı", 1988, IX. cilt, s. 36-37; İlber Ortaylı, *Tanzimat'tan Cumhuriyete Yerel Yönetim Geleneği*, İstanbul: "Hil", 1985, s. 92-93.

8. *Salname-i Devlet-i Aliye-yi Osmâniye*, H. 1295 (1877-1878), s. 336-338.

Gjakovës, Lumës, Gucisë dhe nahijet e Gostivarit, Kalishës e Rahofçës.

4. Sanxhaku i Dibrës, me kazanë e Dibrës, Elbasanit, Dibrës së poshtme (Debre-i Zir) dhe Matit.

5. Sanxhaku i Pazarit të Ri, me kazanë e Pazarit të Ri, Senicës, Prepolit, Mitrovicës, Varoshit të Ri, Tashllëxhës, Tragovishtës, Beranës, Akovës dhe Majkovaçit.⁹ Pra, sipas listës së mësipërme, ky vilajet përbëhej nga 5 sanxhaqe, 31 kaza dhe 4 nahije. Ndërsa po t'i referohemi vjetarëve statistikorë (*salnameve*)¹⁰ të Perandorisë Osmane duke marrë në konsideratë vetëm Sanxhakun e Shkupit për vitet 1882-1883, ky sanxhak përbëhej nga Kazaja e Shkupit që ishte njëkohësisht edhe

9. *Kosova Vilayeti Salnamesi*, Hicri 1296 (1878-1879), s. 60-120.

10. Fjala *salname* (vjetar) e ka prejardhjen nga persishtja "*sal*" që do të thotë vit dhe "*name*" që do të thotë libër. Në gjuhët perëndimore kjo haset me emrat "*annuaire*", "*annus*", "*annale*" dhe "*almanac*". *Salnameja e parë e Perandorisë Osmane doli në vitin 1847, ndërsa salnamet e vilajeteve filluan të dalin në vitin 1866. Disa vilajete kanë botuar vetëm nga një të tillë, e disa të tjerë mund të kenë botuar deri në mbi njëzet salname. Vilajetet që kanë botuar më shumë të tilla janë Vilajeti i Bursës dhe ai i Selanikut. Për historianët, këta vjetarë, kanë rëndësi të dorës së parë. Shih: Hasan Duman, Ottoman year-books: (salname and nevsal), İstanbul: "Research Centre for Islamic History, Art and Culture (IRCICA)", 1982, p. 5-7; Hasan R. Ertuğ, "Osmanlı Devrinde Salnameler", *Hayat Tarih Mecmuası* 10, no: 103, 104 (1973); Justin McCarthy & J. Denis Hyde, "Ottoman Imperial and Provincial Salnames", *Middle East Studies Association Bulletin* 13, no. 2, 1976, p. 10-20.*

qendër e këtij sanxhaku, Kazaja e Ishtipit, Kumanovës, Radovishtës dhe Palankës. Në këtë sanxhak gjithashtu bënin pjesë edhe Nahija e Kaçanikut, Maleshit dhe Bijanicës.¹¹

Tabela 1.
Struktura administrative e Sanxhakut të Shkupit 1882-1883¹²

Sanxhaku	Kazaja	Nahija
Shkup	Shkup	Kaçanik
	Ishtip	
	Kumanovë	
	Radovishtë	
	Palankë	
	Koçanë	Malesh, Bijanicë
	Kratovë	

Në dhjetëvjeçarin e parë të shek. XX, në strukturën administrative të Sanxhakut të Shkupit vihet re një rritje e numrit të kazave dhe nahijeve, nga 7 dhe 3 që kishin qenë në fund të shek. XIX (*shiko*: Tabelën .1.) në 10 dhe 9 të tilla (*shiko*: Tabelën .2.). Kjo rritje, së bashku me numrin e fshatrave, erdhi si rezultat i shtimit të numrit të popullsisë.

Në vitet 1908-1909 Sanxhaku i Shkupit vazhdoi të mbetej qendër e Vilajetit të Kosovës, në përbërje të të cilit bënin pjesë Kazaja e Shkupit, përsëri si qendër sanxhaku, Kazaja e Ishtipit, Koçanës, Kyprylsë,

Kratovës, Kumanovës, Orhanijes, Osmanije-Maleshit, Palankës dhe Radovishtës. Në këtë sanxhak bënin pjesë edhe nahijet e Bereketlisë, Ishtipit, Leskovicës, Koçanës, Bijanicës, Bogomilit, Kyprylsë, Nikodimit dhe Kumanovës, si dhe 660 fshatra.¹³

Tabela 2.
Struktura administrative e Sanxhakut të Shkupit 1908-1909¹⁴

Sanxhaku	Kazaja	Nahija	Nr. i fshatrave
Shkup	Ishtip	Bereketli, Ishtip, Leskovicë	140
	Koçanë	Koçanë, Bijanice	92
	Kyprylly	Bogomil, Kyprylly, Nikodim	91
	Kratovë		69
	Kumanovë	Kumanovë	
	Orhanije		19
	Osmanije-Malesh		3
	Palankë		46
	Radovishtë		54
	Shkup		152

II.-Struktura demografike dhe religjioze e Sanxhakut të Shkupit

Një nga vështirësitë më të mëdha për studiuesit dhe historianët është dhe përcaktimi i strukturës

11. *Kosova Vilayeti Salnamesi*, Hicri 1300 (1882-1883), s. 60-120.

12. *Po aty*.

13. *Osmanlı Asırlarında Türk Devletinin Mülki idare Taksimatı ve Yer isimlerinin. Mukayeseli Tablîli*, Ankara: "Başbakanlık Devlet Arşivleri Genel Müdürlüğü", 1989, s. 1-3.

14. *Po aty*.

demografike të Perandorinë Osmane. Kjo për faktin se, të dhënat shpeshherë na paraqiten kontradiktore, qoftë për arsye objektive (teknike), të cilat kanë të bëjnë me mënyrat se si është realizuar regjistrimi i përgjithshëm i popullsisë, qoftë për arsye subjektive, sepse në vilajetet shqiptare, apo në disa vilajete të tjera të kësaj perandorie, pjesa dërrmuese e popullsisë, si ajo myslimane ashtu edhe ajo e krishterë, nuk pranonte për arsye fanatizmi të tregonte numrin e grave apo të vajzave që kishte çdo shtëpi.

Regjistrimi i përgjithshëm i popullsisë në Perandorinë Osmane, për herë të parë është kryer në vitin 1831.¹⁵ Sipas shumë studiuesve në këtë regjistrim nuk u arrit të përfshiheshin të gjitha njësitë administrative të perandorisë. Regjistrimi i dytë daton në vitin 1844, i treti në vitin 1859-1860¹⁶, i katërti në vitin 1885 dhe i pesti në vitin 1907. Këta dy të fundit janë dhe më të rëndësishmit për arsye se përfshijnë të dhëna specifike mbi moshën, gjininë, vendlindjen, profesionin, statusin civil, etninë dhe fenë.¹⁷

15. *Shih*: Enver Ziya Karal, *Osmanlı İmparatorluğu'nda ilk nüfus sayımı 1831*, Ankara: "T.C. Başbakanlık Devlet İstatistik Enstitüsü", 1997, s. 3-4; Justin McCarthy, *The Arab World, Turkey and the Balkans (1878-1914): A Handbook of Historical Statistics*, Boston: "G.K.Hail and Co", 1982.
16. Vedat Eldem, *Osmanlı İmparatorluğu'nun İktisadi Şartları Hakkında Bir Tetkik*, Ankara: "Türk Tarih Kurumu Basımevi", 1994, s. 10.
17. Cem Behar, "Osmanlı Nüfus İstatistikleri ve 1831 Sonrası Modernleşmesi", *Osmanlı*

Kosova për herë të parë përmendet si vilajet më vete në vjetarin statistikor të Perandorisë Osmane (*Salname-i Devlet-i Aliye-yi Osmâniye*) të vitit 1878, sipas të cilit numri i përgjithshëm i popullsisë në këtë vilajet ishte 898.772 banorë, nga të cilët në Sanxhakun e Shkupit gjendeshin 104.123 banorë.¹⁸ Siç e kemi përmendur dhe më sipër pas përfundimit të luftës ruso-turke dhe aneksimit të Sanxhakut të Nishit dhe Sanxhakut të Shehirkosit në rang vilajeti kemi një pakësim të numrit të përgjithshëm të popullsisë në 496.078 banorë.¹⁹ Ndërsa e kundërta ka ndodhur me popullsinë e Sanxhakut të Shkupit për shkak të muhaxhirëve të ardhur nga Serbia dhe Bullgaria. Pas një viti ajo ka pësuar një rritje të ndjeshme prej 8.424 banorësh, me gjithsej 112.547 banorë (*shiko*: Tabelën .3.).

Sipas ndarjes religjioze, pjesën dërrmuese në këtë sanxhak e zinte popullsia ortodokse me 67.204 banorë, pas tyre vinin myslimanët me 43.303 banorë dhe hebrenjtë me 420 banorë.

Tabela 3. **Struktura demografike dhe religjioze e popullsisë së Sanxhakut të Shkupit 1878-1879²⁰**

Devleti'nde Bilgi ve İstatistik, Ankara: "Devlet İstatistik Enstitüsü", 2000, s. 70-71.

18. *Salname-i Devlet-i Aliye-yi Osmâniye*, H.1295 (1878), s. 336-338.

19. *Kosova Vilayeti Salnamesi*, Hicri.1296 (1878-1879), s. 121-123.

20. *Po aty*.

Tabela 3.

Struktura demografike dhe religjioze e popullsisë së Sanxhakut të Shkupit 1878-1879

Sanxhaku	Kazaja	Myslimanë	Ortodoksë	Hebrenj	Evgjitë
Shkup	Shkup	16.462	14.586	160	307
	Kumanovë	5.264	14.360	-	156
	Ishtip	11.400	10.750	260	230
	Palankë	510	15.000	-	267
	Radovishtë	4.398	3.016	-	269
	Koçanë	239	6.205	-	4.232
	Kratovë	1.037	3.287	-	61

Popullsia e Sanxhakut të Shkupit do të vijë duke u rritur gjithnjë e më shumë. Pas katër vitesh, sipas vjetarit statistikor (*salnames*) të vitit 1882-1883, ky sanxhak kishte gjithsej 126.657 banorë, nga të cilët jo myslimanët zinin pjesën dërrmuese me 77.754 banorë dhe myslimanët vinin përsëri pas tyre me 48.543 banorë.²¹

Ndërsa pas dhjetë vitesh vëmë re se popullsia e këtij sanxhaku është dyfishuar në 267.008 banorë, nga të cilët, duke i qëndruar besnik artikullimit të tyre etnik dhe religjioz, sipas vjetarëve osmanë (*salnameve*), 113.926 ishin myslimanë, 7.016 rum (ortodoksë ose grekë?), 143.917 bullgarë, 1.265 hebrenj, 103 protestantë, 35 katolikë dhe 746 evgjitë jo myslimanë.²²

Tabela 4.

Struktura etnike dhe religjioze e popullsisë së Sanxhakut të Shkupit 1893-1894²³

Në Sanxhakun e Shkupit ekzistonte edhe një numër i konsiderueshëm objektesh kult. Kështu në vitet 1878-1879 në Shkup kishte gjithsej 30 xhami, 1 kishë dhe 1 sinagogë; në Kazanë e Radovishtës 6 xhami, 2 teqe dhe 1 kishë; në Kazanë e Kratovës 5 xhami; në Kazanë e Koçanës 3 xhami; në Kazanë e Palankës 2 xhami; në Kazanë Ishtipit 5 xhami dhe 9 teqe; në Kazanë e Kumanovës 4 xhami dhe 1 kishë. Gjithsej në këtë sanxhak kishte 55 xhami, 11 teqe, 3 kisha dhe 1 sinagogë, pra në total 70 objekte kult.²⁴

21. *Kosova Vilayeti Salnamesi*, Hicri.1300 (1882-1883), s. 138-139.

22. *Kosova Vilayeti Salnamesi*, Hicri 1311 (1893-1894), s. 220-223.

23. *Po aty*.

*Numri i përgjithshëm i popullsisë

*M-Myslimanë

*R-Rum

*B-Bullgarë

*H-Hebrenj

*P-Protestantë

*K-Katolikë

*E-Evgjitë jo myslimanë

24. *Kosova Vilayeti Salnamesi*, Hicri 1296 (1878-1879), s. 124-125.

Tabela 4.
Struktura etnike dhe religjioze e popullsisë së Sanxhakut të Shkupit 1893-1894

Sanxhaku	Kazaja	Nr. i pop*	M*	R*	B*	H*	P*	K*	E jo m*
Shkup	Shkup	63.331	34.863	6.307	21.265	723	-	24	148
	Ishtip	42.227	23.970	-	17.714	542	-	-	-
	Kumanovë	41.189	12.362	87	28.729	-	-	11	-
	Koçanë	27.800	11.120	90	16.590	-	-	-	230
	Radovishtë	18.273	10.571	-	7.599	-	103	-	-
	Palankë	22.725	2.203	426	19.937	-	-	-	159
	Kratovë	21.333	3.396	37	17.691	-	-	-	209
	Kaçanik	6.649	6.580	69	-	-	-	-	-
	Malesh	24.052	8.860	-	15.192	-	-	-	-

Tabela 5.
Sasia e objekteve të kultit sipas kazave në Sanxhakun e Shkupit 1878-1879²⁵

Sanxhaku i Shkupit	Xhami	Teqe	Kisha	Sinagoga
Shkup	30	-	1	1
Radovishtë	6	2	1	-
Kratovë	5	-	-	-
Koçanë	3	-	-	-
Palankë	2	-	-	-
Ishtip	5	9	-	-
Kumanovë	4	-	1	-
Shuma	55	11	3	1

25. Po aty.

Në vitet 1896-1897, në këtë sanxhak kemi një shtim të objekteve të kultit. Kështu numri i xhamive shkon në 108, i mesxhideve (objekte që shërbejnë pak a shumë si xhamitë, por pa minare) 17, i teqeve 31, i kishave 29 dhe i sinagogave 2.²⁶ Pra, në total kishte 187 objekte kulti, duke e kthyer këtë sanxhak në një nga sanxhaqet me më shumë faltore në Vilajetin e Kosovës.

III.-Shkollat, medresetë dhe bibliotekat në Sanxhakun e Shkupit

Në Sanxhakun e Shkupit në fund të shek. XIX dhe në fillim të shek. XX ekzistonin gjithashtu edhe një numër i madh shkollash fillore, të cilat, në gjuhën turke njihen me emrat Sëbjan (*Sıbyan mektepleri*)²⁷ dhe Iptidaie (*Iptidai mektepleri*).²⁸

Në bazë të Rregullores së Arsimit Publik (*Maarif-i Umûmiye Nizamnâmesi*) të vitit 1869 këtyre shkollave u jepej një rëndësi e veçantë. Seksioni i rregullave, që kishin të bënin me shkollat fillore, ndahej në katër pjesë: në rregulla të përgjithshme, të orëve të mësimi dhe provimeve, të mësuesve dhe

të çështjeve financiare. Rregullat e përgjithshme përfshinin gjëra të tilla si: në çdo lagje apo fshat duhet të hapej të paktën një shkollë fillore që të ofronte një arsim katër vjeçar, djemtë duhet të ndiqnin shkollën nga mosha 6-10 vjeç kurse vajzat nga 7-11 vjeç dhe nëse kishte dy shkolla në një lagje, një duhet të ishte për djem dhe tjetra për vajza. Në rregullat e orëve të mësimi dhe provimeve kërkohej një plan mësimor dhe ky plan mund të ndryshohej vetëm me lejen e Ministrisë së Arsimit (*Maarif Nazırlığı*). Provimet duhet të bëheshin në prani të këshillit të lagjes apo fshatit, mësuesit duhet të ishin të diplomuar në Shkollën Normale të Djemve. Të ardhurat e këtyre shkollave duhet të vinin nga burimet e vakëfeve, taksat lokale, pronat e atyre që nuk linin trashëgimtarë, lëmosha e Ramazanit, etj.²⁹

Në kushtetutën e vitit 1876 (*Kânûn-i Esâsî*) arsimi fillor zinte një vend të rëndësishëm. Një nen i Kushtetutës e bënte atë të detyrueshëm, sipas tij, të gjithë rinisë osmane i kërkohej të përfundonte fazën e parë të sistemit arsimor.³⁰ **Në vitin 1879 u formua dhe një zyrë e shkollave fillore** (*Mekatib-i Sıbyaniye Dairesi*), e cila u nda në dy departamente, një për shkollat Sëbjan, që ofronte arsimin tradicional,

26. *Kosova Vilayeti Salnamesi*, Hicri 1314 (1896-1897), s. 211.

27. *Shih*: Osman Nuri Ergin, *Türk Maarif Tarihi*, Istanbul: "Eser Neşriyat", 1977, I-II. cilt, s. 82; Mehmet Zeki Pakalın, *Osmanlı Tarih Deyimleri ve Terimleri Sözlüğü*, III.cilt, Istanbul, "Millî Eğitim Basımevi", 1971, s. 201.

28. Yahya Akyüz, *Türk Eğitim Tarihi*, Ankara: "A. Ü. E.B. F. Yayınları", 1989, s. 182.

29. İsa Halis, *Tanzimat Dönemi Eğitim Sistemi ve Yeniden Yapılanma Çabaları*, Konya: "Serhat Kitabevi", 2005, s. 53-59.

30. Bayram Kodaman, *Abdülhamid Devri Eğitim Sistemi*, Ankara: "Türk Tarih Kurumu", 1999, s. 67.

dhe tjetra për shkollat Iptidaie, që ishin hapur gjatë kësaj periudhe. Ndërsa në vitin 1882, ministri i Arsimit u përpoq që të hiqte këtë sistem të dyfishtë, duke i shndërruar të gjitha shkollat Sëbjan në shkolla Iptidaie. Programi mësimor në këto shkolla përfshinte mësimin e abetares, leximin, shkrimin, moralin, matematikën, historinë, gjeografinë, lëndët fetare, si dhe leximin e Kur'anit.

Në Sanxhakun e Shkupit, *përgjatë viteve 1893-1894, sipas kazave, kishte 8 shkolla Sëbjan në Shkup, 1 në Koçanë, 2 në Radovishtë, 2 në Palankë, 2 në Kratovë dhe 2 në nahijen e Maleshit*.³¹ Pra, gjithsej 17 shkolla Sëbjan me përafërsisht 371 nxënës.

Tabela 6.
Shkollat Sëbjan në Sanxhakun e Shkupit 1893-1894³²

Sanxhaku	Kazaja (ose Nahija)	Nr. i shkollave Sëbjan	Nr. i nxënësve
Shkup	Shkup	8	-
	Koçanë	1	44
	Radovishtë	2	82
	Palankë	2	145
	Kratovë	2	100
	Malesh (N)	2	-

Ndërsa shkollat fillore të tipit Iptidaie, të cilat ishin hapur në kuadër të reformave arsimore të ndërmarra nga sulltan Abdylhamidi i II (1876-1909) në zonat ku ishte përqendruar kryesisht popullsia myslimane (sidomos në Rumeli), po për të

njëjtën periudhë kohore, kishin një numër më të madh. Sipas të dhënave, në Kazanë e Shkupit kishte 29, në Kazanë e Ishtipit 6, në Kazanë e Koçanës 31, në Kazanë Kumanovës 4, në Kazanë e Kratovës 7, në Kazanë e Radovishtës 30, në Kazanë e Palankës 3, në Nahijen e Kaçanikut 1 dhe të Maleshit 2. Gjithsej në këtë sanxhak kishte 113 shkolla Iptidaie, të cilat frekuentoheshin nga 5840 nxënës dhe 130 mësues.³³ Edhe në këto shkolla programi mësimor, pak a shumë, ishte i ngjashëm me atë që zhvillohej në shkollat Sëbjan (*Sıbyan mektepleri*).

Tabela 7.
Shkollat Iptidaie në Sanxhakun e Shkupit 1893-1894³⁴

Sanxhaku	Kazaja (ose Nahija)	Nr. i shkollave Iptidaie	Nr. i nxënësve	Nr. i mësuesve
Shkup	Shkup	29	2154	40
	Ishtip	6	569	9
	Koçanë	31	1375	31
	Kumanovë	4	316	5
	Kratovë	7	254	7
	Radovishtë	30	283	31
	Palankë	3	215	4
	Kaçanik (N)	1	40	1
	Malesh (N)	2	30	2

Në strukturën e sistemit arsimor osman, pas shkollave fillore që përmendëm më sipër, vinin shkollat e ndërmjetme ryshdije (*Rüştiye Mektepleri*), të cilat ishin institucione përgatitore për shkollat e mesme. Në vitin 1847 kishte vetëm katër ryshdije në Stamboll, ndërsa në vitin

31. *Kosova Vilayeti Salnamesi*, Hicri 1311 (1893-1894), s. 130-135.

32. *Po aty*.

33. *Po aty*, s. 224-227.

34. *Po aty*.

1848 qeveria osmane vendosi që të hapte edhe 25 të tilla në qendrat kryesore të vilajeteve. Duke filluar që nga viti 1867 në këto shkolla filluan të pranoheshin edhe nxënës jo myslimanë.³⁵ Sipas Rregullores së Arsimit Publik (*Maarif-i Umûmiye Nizâmnamesi*) të vitit 1869, në çdo vend që kishte të paktën 500 shtëpi, duhej të ndërtohej nga një rryshdije, për të cilat, shpenzimet e ndërtimit, do të paguheshin nga Arka e Arsimit të provincës (*Maarif Sandığı*). Në varësi të numrit të nxënësve, në shkollat do të kishte një ose dy mësues, një mbikëqyrës dhe një roje. Gjatësia e ciklit të shkollave rryshdije ishte caktuar të ishte katër vjet dhe ata që e përfundonin me sukses do të pranoheshin në shkollat e mesme.³⁶ Sipas nenit 23 të rregullores, programi mësimor i shkollave rryshdijeve përfshinte lëndë të tilla si: principet e fesë islame, gramatikë osmane, bukurshkrim, krijimtari, gramatikë arabe dhe perse, kaligrafi, aritmetikë, metoda për mbajtjen e librave të llogarisë, bazat e gjeometrisë, histori botërore, histori osmane, gjeografi, gjimnastikë dhe së fundmi, në vitin e katërt, mësim të gjuhës së vendit përkatës dhe mësim të gjuhës frënge.

Sipas vjetarit statistikor (*Salname-i Devlet-i Aliye-yi Osmâniye*) në kufijtë e perandorisë, në vitin 1876, kishte gjithsej 423 shkolla

35. Isa Halis, *vep. e cituar.*, s. 66-67.

36. Selçuk Akşin Somel, *The Modernization of Public Education in the Ottoman Empire 1839-1908: Islamization, Autocracy and Discipline*, Leiden: "E. J. Brill", 2001, p. 145.

rryshdije, të cilat frekuentoheshin nga rreth 20.000 nxënës.³⁷

Në vitin 1881, Komisioni mbi Arsimimin e redukttoi në dy numrin e viteve të programit të rryshdijeve dhe i kombinoi këto shkolla me idadijet, që ishin shkolla të mesme. Në vendet ku nuk kishte shumë nxënës u vendos që godinat e rryshdijeve të ktheheshin në idadije. Në vitin 1892 programet u rishikuan dhe cikli i studimeve u rrit nga dy në tre vjet, ku lëndët fetare dhe të etikës zinin vend të dukshëm. Në të njëjtën kohë edhe jo myslimanët u pajisën me shkollat e tyre, duke bërë që rryshdijet të merrnin një karakter më kombëtar.³⁸

Në Vilajetin e Kosovës në vitet 1878-1879 kishte gjithsej 14 shkolla rryshdije, 5 në Shkup, 4 në Dibër, 3 në Prizren, 1 në Prishtinë dhe 1 në Pazarin e Ri.³⁹ Numri i tyre në këtë vilajet do të vijë duke u rritur në 18 në vitet 1886-1887⁴⁰, në 23 në vitet 1893-1894 nga të cilat 8 vetëm në Sanxhakun e Shkupit⁴¹ dhe në 35 në vitet 1906-1907 (24 për djem dhe 11 rryshdije për vajza) nga të cilat 10 në Sanxhakun e Shkupit, 8 në Prishtinë, 6 në Pejë, 4 në Prizren, 4 në Tashllëxha dhe 3 në Senicë.⁴²

37. Bayram Kodaman, *vep. e cituar.*, s. 95.

38. *Po aty*, s. 112-113.

39. *Kosova Vilayeti Salnamesi*, Hicri.1296 (1878-1879), s. 124-125.

40. *Kosova Vilayeti Salnamesi*, Hicri.1304 (1886-1887), s. 74-111.

41. *Kosova Vilayeti Salnamesi*, Hicri.1311 (1893-1894), s. 224-227.

42. Bayram Kodaman, *vep. e cituar.*, s. 103.

Sipas kombësive jo myslimane, në Sanxhakun e Shkupit, numrin më të madh të shkollave për vitet 1898-1899 e zinin shkollat e komunitetit bullgar me 6 ryshdije dhe 1 idadije (shkollë e mesme), pastaj vinin ato të komunitetit grek, serb dhe hebre me nga 1 shkollë secili.⁴³

Tabela 8.

Shkollat e popullsive jo myslimane në Sanxhakun e Shkupit 1898-1899⁴⁴

Në vitet 1899-1898 shkolla idadije e Shkupit kishte 121 nxënës, nga të cilët 111 ishin myslimanë dhe 10 jo myslimanë⁴⁵, ndërsa në vitet 1903-1904 kishte 222 nxënës dhe vetëm 17 ishin jo myslimanë.⁴⁶ Programi mësimor i shkollave idadije përfshinte lëndët: hartim, kaligrafi, frëngjisht, jurisprudencë, ekonomi, gjeografi, histori, shkenca natyrore, algjebër, kontabilitet, gjeometri, planimetri, filozofi, kimi dhe pikturë.⁴⁷

Në Sanxhakun e Shkupit

Sanxhaku	Kazaja	Komuniteti	Kategoria	Nr. i nxënësve	Data e hapjes
Shkup	Shkup	Serb ortodoks	Ryshdije	97 djem	1889-1890
	Shkup	Hebrenj	Ryshdije	150 djem	1888-1889
	Shkup	Bullgar	Idadije	390 djem	1839-1940
	Shkup	Bullgar	Ryshdije	200 djem dhe 150 vajza	1872-1873
	Shkup	Grek	Ryshdije	50 djem	1876-1877
	Koçanë	Bullgar	Ryshdije	50 djem	1856-1857
	Palankë	Bullgar	Ryshdije	100 djem dhe 60 vajza	1844-1845
	Ishtip	Bullgar	Ryshdije	90 djem dhe 35 vajza	1875-1876
	Kumanovë	Bullgar	Ryshdije	190 djem	1872-1873
	Kratovë	Bullgar	Ryshdije	153 djem 54 vajza	1877-1878

Në Vilajetin e Kosovës, shkolla e parë idadije (*idadi mektebi*), e cila ishte një shkollë e nivelit të mesëm në sistemin arsimor osman, për herë të parë u hap në Sanxhakun e Shkupit në vitin 18,1891 vjet pas hapjes së idadijes së parë në Perandorinë Osmane, me drejtim kryesor kualifikimin e brezit të ri si nëpunës të administratës.

43. Maarif Salnamesi, Istanbul: "Matbaa-i Amire", Hicri.1316 (1898-1899), s. 1142-1143.

44. Po aty.

ekzistonin gjithashtu edhe një numër medresesh, shkolla të cilat kishin si drejtim kryesor arsimimin e brezit të ri si kuadro fetarë. Nga 35 medrese që kishte në Vilajetin e Kosovës në vitet 1893-1894, 12 prej tyre ndodheshin vetëm në këtë sanxhak.⁴⁸

45. Po aty, s. 1134-1135.

46. Maarif Salnamesi, Istanbul: "Matbaa-i Amire", Hicri.1321 (1903-1904), s. 626-628.

47. Bayram Kodaman, *vep. e cituar.*, s. 222-223.

48. Kosova Vilayeti Salnamesi, Hicri.1311

Tabela 9.
Medresetë e Sanxhakut të Shkupit 1893-1894⁴⁹

Sanxhaku	Kazaja	Nr. i medreseve	Nr. i mësuesve	Nr. i nxënësve
Shkup	Shkup	7	7	160
	Ishtëp	1	1	20
	Kumanovë	1	1	50
	Kratovë	1	1	5
	Radovishtë	1	1	11
	Palankë	1	-	-

Tabela 10.
Bibliotekat e Sanxhakut të Shkupit 1898-1899⁵⁰

Sanxhaku	Kazaja	Emri i bibliotekës	Lagjja ku ndodhej	Themelues	Nr. i librave	Data e themelimit
Shkup	Radovishtë	Xhamia e Madhe	Xhamia e Madhe	Sekretari i Komandës Ushtarake	534	1773-1774
	Kratovë	Ahmed efendi	Mustafa bej	Ahmed efendi	100	1859-1860
	Palankë	Bajram pasha	Bajram pasha	Hysein efendi	300	1853-854
	Koçanë	Ebubekir efendi	Esbak pasha	Myftiu Esbak Ebubekir efendi	300	1w895-1896

Nga vjetari statistikor i Ministrisë së Arsimit (*Maarif Salnamesi*) i viteve 1898-1899 vëmë re se në këtë njësi administrative ka pasur dhe disa biblioteka, prej të cilave më e vjetra daton të jetë themeluar në vitin 1774-1773.

(1893-1894), s. 224-227.

49. *Po aty*.

50. *Maarif Salnamesi*, Istanbul: Matbaa-i Amire, Hicri 1316 (1898-1899), s. 1142.

Në kërkim të pavarësisë

Nuredin Nazarko

Abstrakt

Pavarësia e Shqipërisë e ardhur si rezultat i kombinacioneve të rrethanave historike, u sollë shqiptarëve në jetë një shtet të gjymtuar, pa kohëzimin gjeografik e demografik, aq të nevojshëm për të vendosur bazat e një të ardhmeje për zhvillim të qëndrueshëm të trojeve shqiptare. Shqiptarët fituan një shtet të cinguar, por humbën pjesë të konsiderueshme të territoreve të tyre, humbje e cila nuk ishte vetëm e natyrës politike, por edhe demografike e ekonomike. Secila pjesë e territorit shqiptar mori rrugë të ndryshme zhvillimi, sipas shteteve ku gjendej. Kohëzimi i tregut të brendshëm u thye dhe pasuritë nën dhe mbitokësore të territoreve shqiptare, që u copëtuan, do të shfrytëzoheshin tashmë nga shtetet që këto territore i përkësinin, pas 1913. Shqiptarët me fitimin e pavarësisë provuan, edhe pse dhimbshëm, “dashurinë” e kombeve të qytetëruara ndaj tyre, edhe pse me të madhe ishte shpresuar se Evropa e qytetëruar do të dinte të vendoste pikat mbi i, në rastin e tyre.

Më 28 nëntor 2015 u mbushën plot 103 vjet, nga deklarimi i shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë nga Perandoria Osmane. Kjo datë konsiderohet kurorëzim i përpjekjeve të vazhdueshme të atdhetarëve shqiptarë për formimin e shtetit të pavarur shqiptar, si dhe një moment kthese i rëndësishëm në historinë e shqiptarëve. Padyshim që, akti i shpalljes së pavarësisë, mbetet një akt i rëndësishëm, si pikënisje e një shteti të ri në Ballkan, shtetit

shqiptar, por ky akt u krye në kushte tejet të rënduara dhe të pafavorshme për shtetin e ri, që po kristalizohet si formacion i mëvetëm politik.

Shqiptarëve përgjatë historisë së tyre u është dashur që të përballen me shumë pushtues të huaj, ballkanikë apo jashtë-ballkanikë. Në këtë përballje nuk patën arritur ndonjëherë që të krijonin formacionin e tyre shtetëror të pavarur, por, në shekullin e formimit të komb-shteteve në Evropë, as shqiptarët nuk mbetën prapa, si të

pavetëdijshtëm për përkatësinë e tyre kombëtare. Popullsitë e tjera ballkanike si grekët, serbët, bullgarët, rumunët i kishin hyrë më herët se shqiptarët, lëvizjeve për pavarësim nga Perandoria Osmane, gjë që do të çonte në ndryshime të reja në Ballkan, jo vetëm në ndryshimin e kufijve të këtij rajoni, por edhe në shpërfajjen e urrejtjes gjenetike ndaj popullatës shqiptare, që do të kulmonte me makabritete nga më të padëgjuarat ndaj këtij populli.

Shqiptarët e të katër vilajeteve (Shkodrës, Kosovës, Manastirit, Janinës), edhe pse nuk ecën në gjurmët e shteteve të tjera ballkanike, nuk është se ishin të pavetëdijshtëm për identitetin e tyre kombëtar, kulturor e fetar, edhe pse shpesh perceptoheshin si banorë të një vendi të egër e të prapambetur. Zgjimi i nacionalizmave në Ballkan me prapavija të qarta shoviniste dhe ekstremiste, i vendosi shqiptarët dhe trojet e tyre historike, në një rrezik të madh, rrezikun e copëtimit ndërmjet Serbisë, Greqisë, Malit të Zi dhe Bullgarisë. Ky rrezik u bë evident që me traktatin e Shën-Stefanit, 3 mars 1878, si dhe Kongresin e Berlinit, 13 qershor 1878, i mbledhur për të rishqyrtuar vendimet e Shën-Stefanit, por jo për t'i zhbërë ato. Tashmë, për atdhetarët shqiptarë, ishte e qartë se synimet aneksioniste të fqinjëve shovinistë, kishin fituar përkrahje edhe në qarqet ndërkombëtare si rezultat i mbështetjes së pakufishme

që Rusia ofronte ndaj interesave të tyre dhe interesit të saj për një sferë të gjerë influence në Ballkan, përballë Austro-Hungarisë. Ata e kuptuan se, me dobësimin e vazhdueshëm të Perandorisë Osmane, shovinistët ballkanas nuk do të ndaleshin asnjëherë për realizimin e aspiratave të tyre të mbrapshta. Të gjendur mes një perandorie në dobësim të vazhdueshëm, gjithnjë e më të ndërvarur nga ndërhyrjet e Fuqive të Mëdha në punët e saj të brendshme dhe shpërthimit të nacional-shovinizmave ballkanikë, atdhetarët shqiptarë vlerësuan se të qëndruarit nën hijen e perandorisë ishte zgjidhja më e mençur diplomatike e kohës që u siguronte atyre mbrojtjen e nevojshme nga rreziku i copëtimit, por kjo nuk do të thoshte shpëtim i përhershëm nga ky rrezik. Mbrojtjen që iu sigurohej nga të qëndruarit nën hijen e perandorisë, u përpoqën ta shfrytëzonin për forcimin e vilajeteve shqiptare dhe bashkimin e tyre në një njësi të vetme autonome.

Kërkesa për ruajtjen e integritetit territorial të trojeve shqiptare, del në pah që në momentin kur traktati i Shën-Stefanit copëtoi trojet historike të shqiptarëve. Bashkë me kërkesën për ruajtjen e integritetit territorial të trojeve shqiptare që në maj 1878, nga Prizreni i kërkohet sulltanit që të garantojë bashkimin e trojeve shqiptare në një provincë të vetme, e pashkëputur nga perandoria.

...Armiqtë tanë përpiqen kush e kush më shumë të shpifin kundër nesh, me qëllim që të bindin madhërinë tuaj se ne kemi ndërmend të shkëputemi nga perandoria juaj. Po ne nuk dëshirojmë gjë tjetër veç përparimin, zhvillimin dhe lulëzimin e Shqipërisë dhe besojmë se këto përfundime nuk mund të arrihen veçse në kushte të caktuara, domethënë vetëm me anë të respektimit të tërësisë së të gjithë territorit tonë, me formimin e të gjithë Shqipërisë si një provincë e vetme, nën drejtimin e një guvernatori të përgjithshëm të emëruar nga Porta e Lartë, dhe, më në fund, me zbatimin e reformave serioze dhe të përshtatshme me nevojat e qytetërimit dhe me traditat kombëtare.

Ky është mendimi i të gjithë shqiptarëve, të cilët janë gati të bëjnë çfarëdo flijimi, mjafton që të përmirësojnë gjendjen e trishtuar të vendit të tyre...¹.

Kërkesa për autonomi administrative sa vjen e bëhet edhe më e fortë. Shqiptarët nuk reshtën së kërkuari autonomi edhe në momentet më të vështira për ekzistencën e kombit shqiptar. Dy ditë para fillimit të Luftës së Parë Ballkanike, më 8 tetor 1912, autonomia mendohej si zgjidhje optimale edhe nga atdhetarët shqiptarë në SHBA.

1. *Akte të Rilindjes Kombëtare Shqiptare, 1878-1912*, (1978) Tiranë: f. 19-20.

New England, (SHBA) 6 tetor 1912

Rezolutë

“Në mbledhjen që mbajtën shqiptarët kombëtarë të New-Englandit më 6 të vjeshtës së dytë, dyke marrë në sy që po të mundet Turqia shtetet e Ballkanit do ta ndajnë Shqipërinë në mes tyre, u dha funt që:

Është detyrë e atdhetarëve shqiptarë të jenë plotësisht të bashkuar me guvernën otomane kundër armiqve të Mbretërisë”²

Po kështu në 12 nëntor 1912 nga Durrësi i dërgohet një memorandum perandorit të Austro-Hungarisë, Franz Jozefit II, për të siguruar përkrahjen e tij ndaj çështjes shqiptare. Ndër të tjera thuhej:

Madhni,

Shum të vështira e të rrezikshme janë këto dit për ne shqypnarët e për nanën ton Shqypninë, qi të katër shtetet e Ballkanve po rrahin me e përpi e me e coptue. Na, me sa fuqi kena, mundohena, edhe Perëndisë i lutemi qi Mbretnia jon të muisi (t'i mundë) këta anmiq e të na prui (të na mbrojë) prej sish. Por, për fat të keq, gjasat nuk po na duken fort të mira, e po shohim se shumë vende të katër vilajeteve të Shqypnisë, Kosovë, Manastir, Shkodër e Janinë gjinden ndën kambë të hueja.

2. Po aty, f. 255.

Për këtë shkak po marrim lejen m'u sjellë kah Madhnia jote, si Perandorit të një Perandorisë së Madhe, qi asht ma e afërmja e jon e ka pjesë në Ballkan me Bosnie-Herzegovinë, e me ju lutun qi në çështjet të Ballkanve të merrte parasysh Shqypnin, në mënyrë që kufit e saj mos të bërkiten (të preken) e mos shtyhen prej kurkuj e qi Shqypnia kështu e pabërkome (e paprekur) e e pavoglueme të ketë një autonomi të plotë ndën Mbretninë Otomane.³

Në kushtet kur shqiptarët ishin ende nën sovranitetin e Perandorisë Osmane, fqinjëve ballkanikë nuk u interesonte aspak një Shqipëri autonome, madje ata ishin të tronditur nga frika se mos autonomia fitohej.

Stavro Skëndi në librin e tij “Zgjimi kombëtar shqiptar”, citon një dokument të datës 5 gusht 1912, sipas të cilit, “I dërguari bullgar pranë Portës, Sarafof, i tha Pallavicinit (*ambasador i Austro-Hungarisë në Stamboll, N. N.*) se lajmet rreth një bashkimi të mundshëm të katër vilajeteve shqiptare në një njësi administrative autonome qenë tronditëse. Një masë e këtillë, tha ai, do t'i jepte elementit shqiptar një dominim absolut dhe do të rrezikonte interesat jetësorë të elementëve të tjerë bullgarë, serbë dhe grekë që banonin në ato vilajete.”⁴

3. Po aty, f. 257-258.

4. Skëndi, S. (2000), *Zgjimi kombëtar shqiptar*,

Ky shqetësim ndër fqinjët ballkanikë kishte qenë i kahershëm, pasi një autonomi e pranuar nga autoritetet osmane do të thoshte paqe mes shqiptarëve dhe Portës së Lartë dhe kjo paqe ishte minim për synimet e tyre aneksioniste. Shtetet ballkanike të interesuar drejtpërsëdrejti për copëtimin e trojeve historike të shqiptarëve, për të hequr vija demarkacioni midis tyre, punonin që shqiptarët vazhdimisht të ishin në konflikt të armatosur me Portën e Lartë, pasi, sipas tyre, ndezja e këtyre lloj konfliktesh ishte në interes të vetë ballkanikëve, duke çuar në dobësim të fuqisë luftarake, si të shqiptarëve ashtu dhe të osmanëve. Ky dobësim do të ishte aleati më i mirë në momentin kur do të vendosnin për të invaduar dhe ndarë tokat shqiptare, pasi shqiptarët do t'i kishin harxhuar fuqitë e tyre luftarake në luftë të padobishme kundër osmanëve. Për këtë qëllim serbët dhe malazezët vazhdimisht nxisnin kryengritje të shqiptarëve kundër osmanëve.

“Mbasi shtetet ballkanike kërkonin luftën kundër Turqisë dhe toka që ata lakmonin qe Shqipëria, kërkesat e përsëritura të shqiptarëve për autonomi i kishin tronditur thellësisht. Paqja midis Turqisë e Shqipërisë qe në dëm të tyre, në mënyrë të veçantë po të shoqërohej me njohjen e një Shqipërie etnike, si pasojë, ata nxisnin revoltat.”⁵

Tiranë: Phoenix, f. 403.

5. Po aty, f. 402-403.

Në kushtet kur shqiptarët ende shpresonin për një autonomi brenda Perandorisë Osmane, veprimtaria antishqiptare e qarqeve ballkanike realizohej sipas parimit “përça e sundo”.

Sipas Misha Glenny në librin e tij “Histori e Ballkanit 1804-1999”, arma politike më e frytshme, që mund të përdornin shtetet e Ballkanit, ishte “përça e sundo”.

Edhe Serbia, edhe Mali i Zi i nxitën shqiptarët e Kosovës e të Shqipërisë Veriore të ngrinin krye kundër turqve në vigjilje të Luftërave Ballkanike, duke vënë kështu armiq aktualë e të ardhshëm kundër njëri-tjetrit. Kur Mali i Zi hyri në Shqipërinë Veriore, ushtritë e tij në fillim u përkrahën nga malësorët, fise katolikësh shqiptarë. Mbreti Nikolla i kishte bindur malësorët se të drejtat dhe traditat e tyre do të ishin më mirë të mbrojtura nën shtetullën e një sundimtari të krishterë, qoftë ortodoks ose sllav, sesa nën qeverisjen e shqiptarëve myslimanë. Nuk u desh të kalonte shumë kohë dhe malësorët e kuptuan se kishin kryer një gabim.⁶

Qëllimi i qarqeve ballkanike ishte mbajtja ndezur e konfliktit mes shqiptarëve dhe osmanëve, i cili u sfumua, kur më 8 tetor 1912 Mali i Zi i shpalli luftë Perandorisë Osmane dhe kështu nisi Lufta e Parë Ballkanike. “Forcat osmane (*përfshti dhe forca shqiptare*, N. N.) u detyruan të

luftonin në katër fronte të ndryshme: kundër bullgarëve në Thrakë; kundër bullgarëve, serbëve e grekëve në Maqedoni (*territoret shqiptare*, N. N.); kundër serbëve e malazezëve në Shqipërinë veriore e në Kosovë; dhe kundër grekëve në Shqipërinë Jugore.”⁷

Qëllimi kryesor i kësaj lufte ishte pushtimi dhe copëtimi i trevave shqiptare, duke dëbuar njëherë e mirë Perandorinë Osmane nga Ballkani. Kjo luftë zgjati vetëm gjashtë javë dhe askujt nuk i kishte shkuar nëpër mend se Perandoria Osmane do të mundej kaq shpejt përballë aleatëve ballkanikë. Ushtritë ballkanike pushtuan territoret shqiptare. Humbja dhe tërheqja e trupave shqiptaro-osmane, pas luftimesh të ashpra, i la vendin masakrave dhe gjenocidit ndaj popullsisë shqiptare.

Tashmë shqiptarët gjendeshin përpara një situatë të rrezikshme, tejet kërcënuese për ekzistencën e kombit shqiptar, pasi aleati i saj i vetëm ushtarak ishte mundur dhe Fuqitë e Mëdha, pavarësisht kërkesave të vazhdueshme dhe të përsëritura të atdhetarëve shqiptarë për mbështetjen e çështjes shqiptare, me tepër ishin të interesuara për shmangien e konflikteve ndërmjet tyre, sesa për zgjidhje reale të kësaj çështjeje në respekt të drejtësisë ndaj shqiptarëve.

Frika e shqiptarëve, sipas fjalës së Ismail Qemalit thënë një figure

6. Glenny, M. (2007), *Histori e Ballkanit 1804-1999*, Tiranë: Toena, f. 241.

7. Po aty, f. 229.

të shquar të politikës hungareze në Paris, Bela de Rakovszky, që në nëntor 1911, qëndronte në faktin se mos ndizej lufta në Ballkan, e cila do të shkaktonte ndarjen e Shqipërisë në mes të fqinjëve të saj.⁸ Tashmë kjo frikë ishte shndërruar në realitet. Realizimit të kësaj frike i bashkëngjitej edhe mos gatishmëria e Austro-Hungarisë, për të pranuar kërkesën e shqiptarëve artikulluar nga Ismail Qemali që në 28 tetor 1911, se në rast të prishjes së Turqisë në Ballkan, shqiptarët do të dëshironin një protektorat austro-hungarez, pasi Shqipëria nuk ishte ende e përgatitur në rast se Perandoria Osmane përmbysje.⁹

Pikërisht në këto kushte aspak shpresëdhënëse për të ardhmen e territoreve shqiptare, u mor vendimi për shpalljen e pavarësisë së Shqipërisë. Sikundërse është e kuptueshme, jo se shqiptarët nuk e dëshironin pavarësinë dhe nuk kishin sakrifikuar për të, por, të kërcënuar në ekzistencën e tyre nga nacional-shovinizmat dhe moskokëçarja e Fuqive të Mëdha për pranimin e realitetit shqiptar, ishin më të interesuar për të qëndruar nën mbrojtjen e një fuqie të madhe, pasi të vetëm nuk do të mund të ndalnin copëtimin e trojeve të tyre historike. Kur u bë e qartë se Perandoria Osmane humbi përfundimisht në Ballkan dhe protektorati i shpresuar dukej i pamundur, atdhetarët shqiptarë, të

shtrënguar nga rrethanat, vendosën shpalljen e pavarësisë, si mundësia e pashfrytëzuar, me shpresën se fjala e tyre do të dëgjohej nga Fuqitë e Mëdha dhe Shqipëria do të shpëtonte nga copëtimi. Ndërkohë që shpallej pavarësia, territoret shqiptare ishin të pushtuara nga ushtritë ballkanike dhe pavarësia e shpallur nuk u njoh as nga vendet ballkanike dhe as nga Fuqitë e Mëdha, pavarësisht kërkesës së dërguar në drejtim të tyre. Mosnjohja e pavarësisë nga Fuqitë e Mëdha e vendoste shtetin e ri në një udhë pa krye, duke pritur me ankth se çfarë do të ndodhte me të. Pavarësisht situatës, I. Qemali formoi qeverinë e kryesuar prej tij dhe u përpoq, me aq sa i lejonte situata të përpiquej, pavarësisht dëshirës së tij, të vinte në jetë njohuritë e tij qeverisëse për të mirën e kombit shqiptar. Qeveria e tij veprroi 14 muaj dhe nuk mundi ta shtrinte autoritetin e saj mbi katër vilajetet shqiptare, pjesa më e madhe e të cilave vazhdonte të qëndronte e pushtuar nga ushtritë ballkanike. Për zgjidhjen e situatës së krijuar në Ballkan dhe që të mos shpërthente ndonjë konflikt në mes vetë Fuqive të Mëdha, më 17 dhjetor 1912 u thirr Konferenca e Ambasadorëve në Londër, e cila diskutoi për kufijtë e Shqipërisë deri në gusht të 1913, meqenëse pavarësia e shpallur nga shqiptarët ende nuk ishte njohur nga ana e këtyre fuqive, nën kryesinë e ministrit të jashtëm anglez Eduard Grei.

8 Shih, *Zgjidhje kombëtar shqiptar*, faq. 402

9 Shih, po aty, faq. 402

Në përfundim të punimeve konferenca vendosi padrejtësisht copëtimin e trojeve të shqiptarëve, për të kënaqur lakmitë shoviniste ballkanase dhe për të siguruar një paqe të qëndrueshme mes vetë Fuqive të Mëdha. Bashkë me copëtimin e trojeve shqiptare, në sajë të përkrahjes dhe mbështetjes së Austro-Hungarisë dhe Italisë, u njoh edhe pavarësia e Shqipërisë më 29 korrik të vitit 1913. Kjo ishte një zgjidhje e imponuar për shqiptarët nga diplomacia evropiane, që, edhe pse e paraqiste veten si djep të kulturës e qytetërimit, mbrojtëse të lirisë dhe drejtësisë, kreu një nga aktet më të turpshme diplomatike, duke sakrifikuar në altarin e shovinizmit dhe pangopësisë, të drejtat e një populli nga më të lashtët e Evropës.

Në përfundim të punimeve të Konferencës së Londrës për kufijtë e Shqipërisë, ministri i jashtëm anglez do të deklaronte: “Unë e di fare mirë se, kur gjithçka do të bëhet e njohur, kjo zgjidhje në shumë pika do të japë shkas për kritika të forta nga kushdo që e njeh vendin dhe që e gjykon çështjen nga një pikëpamje e ngushtë vendore. Qëllimi kryesor ka qenë që të ruhej marrëveshja ndërmjet vetë Fuqive të Mëdha dhe në qoftë se vendimi ndërmjet vetë Fuqive të Mëdha, e ka siguruar atë, ai atëherë ka bërë punën më të rëndësishme në të mirë të paqes në Evropë.”¹⁰ Vendimi i 29 korrikut

10. Histori 4, tekst mësimor për shkollat e

1913, edhe pse i padrejtë i detyronte ushtritë ballkanike t’i lëshonin ato territore shqiptare, për të cilat Fuqitë e Mëdha kishin rënë dakord të formonin një shtet të pavarur.

Në këtë mënyrë, me vendimet e Londrës, mori fund ankthi i shqiptarëve për çështjen e një shteti kombëtar në trojet e tyre historike. Politika reale evropiane tregoi edhe njëherë se kur ndeshen elefantët nuk duan t’ia dinë për barin që do të shkelet.

Kështu, më shumë nga rrjedha e ngjarjeve sesa e dëshiruar vetëdijshtë, lindi një shtet i pavarur shqiptar që nuk e lidhte më asgjë me Perandorinë Osmane veç fesë së shumicës së popullsisë së saj dhe një historie të përbashkët 500 vjeçare.¹¹

Pavarësia e ardhur si rezultat i kombinacioneve të rrethanave historike, u solli shqiptarëve në jetë një shtet të gjymtuar, pa kohezionin gjeografik e demografik, aq të nevojshëm për të vendosur bazat e një të ardhmeje për zhvillim të qëndrueshëm të trojeve shqiptare. Shqiptarët fituan një shtet të cunguar, por humbën pjesë të konsiderueshme të territoreve të tyre, humbje e cila nuk ishte vetëm e natyrës politike, por edhe demografike e ekonomike. Secila pjesë e territorit shqiptar mori rrugë të ndryshme zhvillimi, sipas

mesme, (2006), Tiranë: Pegi, f. 178.

11. Bartl, P. (2006), *Myslimanët shqiptarë në lëvizjen për pavarësi kombëtare (1878 – 1912)*, Tiranë: Dituria, f. 226.

shteteve ku gjendej. Kohezioni i tregut të brendshëm u thye dhe pasuritë nën dhe mbitokësore të territoreve shqiptare, që u copëtuan, do të shfrytëzoheshin tashmë nga shtetet që këto territore iu përkisnin, pas 1913. Shqiptarët me fitimin e pavarësisë provuan, edhe pse dhimbshëm, “dashurinë” e kombeve të qytetëruara ndaj tyre, edhe pse me të madhe ishte shpresuar se Evropa e qytetëruar do të dinte të vendoste pikat mbi *i*, në rastin e tyre.

Me pavarësinë e dhënë nga 1913, shqiptarët nuk realizuan dot ëndrrën e tyre për pavarësi, pasi pavarësia do të konsiderohej e tillë vetëm në qoftë se do të njihej integriteti territorial dhe kohezioni, historiko-kulturor, i katër vilajeteve. Parë në perspektivën

afatgjatë të zhvillimeve ballkanike, pavarësia e 1913, iu hoqi të drejtën shqiptarëve për të qenë faktor vendimtar në stabilitetin e Ballkanit. Me një Shqipëri të cunguar, që do ta kishte të vështirë të rimëkëmbte veten, influenza shqiptare në Ballkan do të ishte e pandjeshme. Përfitimi kryesor i shqiptarëve nga pavarësia londineze, ishte mbetja hapur e një dritareje shprese, që në të ardhmen, ky shtet, nëse do t’ia dilte të mbijetonte, të luante rolin e violinës së parë në kërkimin e pavarësisë. Prandaj, edhe sot e gjithë ditën shqiptarët ende janë në kërkim të pavarësisë, të asaj pavarësie që iu mohua padrejtësisht, me një pavarësi, të pjellë nga ngjizja e interesave të Fuqive të Mëdha dhe zgjatimeve të tyre ballkanike.

Bibliografia

- Akte të Rilindjes Kombëtare Shqiptare, 1878-1912*, Tiranë, 1978.
SKËNDI, Stavro *Zgjimi kombëtar shqiptar*, Tiranë, 2000.
GLENNY, Misha *Histori e Ballkanit 1804-1999*, Tiranë, 2007.
Histori 4, tekst mësimor për shkollat e mesme, Tiranë, 2006.
BARTL, PETER *Myslimanët shqiptarë në lëvizjen për pavarësi kombëtare (1878 – 1912)*, Tiranë, 2006.

Rreth fesë dhe lirisë

Turki El-Hamed

Abstrakt

Urtësia hyjnore thelbësore, të cilën e nxjerrim nga narrativa e krijimit, është se, prezenca e të kundërtave është e domosdoshme për të njohur thelbin e tyre, por pa pasur askush të drejtë të monopolizojë njohjen e natyrshme të të kundërtave. Gjërat e humbasin vlerën pa prezencën e të kundërtave. Diversiteti i ngjyrave është i domosdoshëm për të bërë dallimin mes tyre. Diversiteti mes njerëzve është i domosdoshëm për jetën dhe për ta çuar atë përpara. Në të kundërt, jeta shndërrohet në një pellg të qelbur, ku uji ka humbur shijen e tij karakteristike, por dhe ajri ka marrë erë të keqe. Pa pluralizëm, pa diversitet dhe pa të kundërtat, gjithçka e humb shijen dhe kuptimin, gjithësia shndërrohet në një akumulim pa formë dhe kuptim.

Në rrëfimin kuranor të krijimit të njeriut, histori të cilën e ka përshkruar në mënyrë të mrekullueshme Kur'ani fisnik, përballemi me disa fragmente, tek të cilat ia vlen të ndalemi, për të krijuar një kuptim më të thellë të disa pikave kyçe, të cilat mbeten enigmatike dhe polemike edhe sot e kësaj dite.

Fragmenti i parë tek i cili do të ndalojmë është debati që u zhvillua

mes Zotit të lartësuar dhe mes shejtanit, kur ky i fundit refuzoi ti përulej Ademit, e për rrjedhojë u shndërrua nga Azazil engjëllor, në shejtan të mallkuar. Me këtë rast vlen të theksoj se emri Azazil nuk është cekur fare në Kur'an, por është futur si term nëpërmjet rrëfenjave izraelite të transmetuara nga Ibnu Abas, Ebu Hurejre, Kab El-Ahbar, Munebih ibnu Vehb, etj.

Urdhri hyjnor nga Krijuesi i Universit, drejtuar shejtanit, që ti përulej në shenjë respekti Ademit (a.s.), ishte i qartë dhe i prerë, e megjithatë, shejtani u rebelua ndaj këtij urdhri dhe refuzoi ti bindej, duke u bazuar në këndvështrimin e tij personal, i vetëdijshëm se po i flet Zotit dhe Krijuesit të tij.

Si reagoi Krijuesi i gjithësisë ndaj këtij refuzimi?

Zoti i madh e kishte në dorë që shejtanin ta flakë menjëherë në mes të zjarrit të xhehenemit. Madje, jo vetëm kaq, por e kishte në dorë ta zhdukë nga ekzistenca një herë e mirë, ashtu siç e kishte sjellë në ekzistencë nga hiçi. E megjithatë, Zoti nuk e bëri as njërën dhe as tjetrën. Jo vetëm kaq, por Zoti i lejoi shejtanit të shprehë edhe mendimin e vet dhe të justifikojë qëndrimin refuzues të urdhrit hyjnor. Edhe pse Zoti e dinte motivin e rebelimit të shejtanit, Ai e pyeste dhe dialogonte me të. Në fund, ai e përzuri nga mbretëritë qiellore dhe i dha afat deri në ditën e Kiametit, ditën e shuarjes së konceptit kohë dhe vend. Iblisi vazhdon edhe sot e kësaj dite me rebelimin dhe refuzimin e bindjes.

Madje, Zoti e lejoi që të hyjë dhe në parajsë, aty ku jetonte Ademi dhe Havaja, për ti helmuar dy bashkëshortët me helmin e tij të vesveseve, derisa i nxori nga parajsa. E megjithatë, Zoti i jep afat deri në ditën e Kiametit.

Pyetja që shtrohet në këtë rast është: “Përse Zoti e la të lirë shejtanin, pavarësisht se është burim i ligësive, mëkateve, të këqijave dhe se përfaqëson opozitarin e urdhrave hyjnore?” Sigurisht që duhet të ekzistojë një urtësi në këtë mes. Zoti, nuk ka krijuar asgjë kot dhe në mënyrë abuzive. Por, cila është kjo urtësi? Askush nuk mund të pretendojë se e di këtë urtësi hyjnore të fshehtë, e megjithatë, s’ka përse të heqim dorë nga meditimimi dhe përpjekja për ta kuptuar atë. Ashtu siç nuk është krijuar kot gjithçka tjetër, edhe mendja nuk është krijuar kot.

Liria për të zgjedhur

Liria për të zgjedhur është fjalëkalimi i gjithçkaje. Shejtani zgjodhi rebelimin dhe kundërshtimin e urdhrit për t’iu përulur Ademit (a.s.). Ademi dhe Havaja, më pas, gjithashtu, zgjodhën të hanë nga pema e ndaluar. Shejtani ishte përgjegjës për zgjedhjen që bëri, ashtu siç ishin përgjegjës dhe Ademi me të shoqen për zgjedhjen e tyre. Që këtu e kupton logjikën e drejtë të kërkimit të llogarisë dhe drejtësisë hyjnore Ditën e Gjyqit të Madh. Nuk ka përgjegjësi pa liri, nuk ka llogaridhënie pa përgjegjësi dhe për rrjedhojë, nuk ka llogaridhënie pa liri.

Problemi i krijesave njerëz qëndron te përpjekja e disave për të detyruar të tjerët që të ndjekin të njëjtën linjë me të tyre, të besojnë se linja e tyre është e vërteta absolute. Po, ata mund të jenë të sinqertë në

qëllimet dhe objektivat e veta, por nuk është e thënë që objektivat e tyre të përshtaten me objektivat e njerëzve të tjerë.

Në një analizë më të thellë, kupton se këta “disa” me këtë gjest, realisht cenojnë vetë thelbin e urtësisë hyjnore të cilën e gjejmë të shpalosur në epikën kuranore të krijimit të njeriut. Të bindur se, me këtë akt, ata i binden Krijuesit, në fakt, ata kanë shkelur dhe cenuar urtësinë hyjnore të krijimit.

Edhe nëse janë në të drejtën absolute, siç besojnë me sinqeritet dhe me bindje, ata nuk i kanë trajtuar të tjerët me urtësinë dhe durimin që i madhi Zot trajtoi shejtanin e rebeluar.

Zoti është e vërteta absolute dhe pavarësisht kësaj, nuk iu imponua shejtanit dhe nuk e detyroi ti përulej Ademit, edhe pse është i Plotfuqishëm për këtë. Në vend të imponimit, Ai i hapi rrugën e dialogut dhe i dha afat deri ditën e Gjyqit të Madh. E nëse e vërteta absolute nuk i imponohet të pavërtetës absolute, si ia lejon krijesa njerëzore vetes që të veprojë atë që nuk e vepron as Krijuesi i saj nga hiçi?! Kjo nga njëra anë, ndërsa nga ana tjetër, edhe nëse i justifikojmë këta “disa” në imponimin që duan tu bëjnë njerëzve për ti tërhequr në rrugën e tyre të vetme të së mirës dhe së vërtetës, e cila nuk ka të dytë, me këtë akt, ata bien ndesh me pluralizmin dhe diversitetin e natyrshëm, falë të cilit dallohet e mira nga e keqja, e vërteta nga e pavërteta dhe pas së

cilës qëndron krijimi i tre botëve; engjëllore, njerëzore dhe djallëzore.

Këtu i kupton edhe fjalët e Zotit drejtuar engjëjve që e pyetën mbi qëllimin e krijimit të njeriut, para se ta krijonte atë, ku u përgjigjet: **“Unë di atë që ju nuk e dini”**. Ata ishin krijuar vetëm për të bërë mirë, prandaj edhe çuditëshin përse duhej një krijesë e re!

Zoti e kishte bashkëngjitur Azazil-in me engjëjt e tjerë adhurues, pavarësisht se e dinte në dijen e Tij të pafund se pikërisht ai do të shndërrohej në një shejtan rebel dhe nuk do i bënin fajde adhurimet e së shkuarës; pavarësisht se e dinte se ai do i nxirrte Ademin dhe Havanë nga xheneti me vesveset e tij. Por, e gjitha kjo ndodhi për një urtësi specifike. Po të mos ishte zbritja e çiftit të parë njerëzor nga xheneti, nuk do të ishte populluar toka, nuk do ishin ngritur civilizime, nuk do të kishim histori, gjë të cilat janë objektiva të krijimit të njeriut që para se të krijohej, e që shprehet në Kur'an me fjalët:

“Kur Zoti yt u tha engjëjve: ‘Unë do të krijoj një mëkëmbës (që do të zbatojë ligjet e Zotit) në tokë’, ata thanë: ‘A do të vësh atje dikë që do të bëjë çrregullime e do të derdhë gjak në të, ndërkohë që Ne të madhërojmë, të lavdërojmë dhe të lartësojmë ashtu si të takon Ty?’” Ai tha: **“Unë di atë që ju nuk e dini”**.¹

1. Kur'an, Bekare: 30.

Historia e krijimit

Çdo gjë në univers është e mirë-llogaritur nga Krijuesi që para se të ekzistojë, por, lind pyetja: A nuk kishte mundësi Zoti që ta krijojë gjithçka që donte të krijojë, pa u hyrë gjithë këtyre ngjarjeve dramatike, fundin e të cilave e dinte? Aq më tepër që ai i bën gjërat me një të thënë “bëhu”?!

Pikërisht për këtë edhe fragmenti i dytë, tek i cili do të ndalemi, është ai historisë interesante të krijimit. I Gjithë-urti dëshiron ti japë kuptim dhe qëllim robërve të Tij nëpërmjet një imazhi të prekshëm, i cili qartësohet falë ngjarjeve dhe fragmenteve të krijimit. Këtë njeri, i cili do të bëjë shkatërrim, do të derdhë gjak e do të veprojë çfarë i lejohet e çfarë nuk i lejohet (historia), pavarësisht kësaj, Zoti do e nderojë dhe lartësojë mbi krijesat e tjera, madje edhe mbi vetë engjëjt, të cilët nuk dalin nga vija që u është përcaktuar as sa maja e gishtit. Kjo shpaloset qartë me urdhrin hyjnor drejtuar engjëjve të krijuar nga drita, që ti përulen krijesës nga balta e zezë. Madje, edhe pas mëkatit të ngrënies nga pema e ndaluar dhe nxjerrjes nga parajsja, njeriu mbetet krijesa më e preferuar e Zotit.

“Në të vërtetë, Ne i kemi nderuar bijtë e Ademit: ua kemi bërë të mundur që të udhëtojnë në tokë dhe në det, u kemi dhënë ushqime të mira e të lejuara dhe i kemi ngritur lart mbi shumë prej atyre që kemi krijuar.”²

2. Kur'an, Isra: 70.

Përse dhe mbi ç'bazë bëhet kjo preferencë, pavarësisht rebelimit të përhershëm, shkatërrimit të përsëritur dhe gjakderdhjes?

E gjitha kjo, për një arsye të vetme dhe kjo arsye është fakti që, kësaj krijese të re, i është dhënë një specifikë e re “arsyeja”, e cila ka si karakteristikë kryesore aftësinë për të zgjedhur. Që këtu, liria do të përbënte thelbin e sjelljes, pasi nuk ka aftësi për të zgjedhur pa pasur liri dhe nuk mund të mbahet përgjegjësi pa pasur arsye.

Engjëjt, si krijesat më sublimë, nuk e kanë instinktin e të gabuarit, veprojnë dhe u binden urdhrave pa shtuar dhe hequr gjë prej tyre. Kështu, ata janë krijesa vetëm për tu bindur, nuk mund të zgjedhin dhe nuk kanë hapësirë lirie për të vendosur ndryshe.

Sakaq, krijesat më të ulëta në univers, kafshët, udhëhiqen vetëm nga instinktet, duke iu bindur instinkteve në gjithçka, pa pasur lirinë e zgjedhjes.

Ndërkohë që njeriu, i cili është mes dy të parave, gëzon lirinë dhe aftësitë për tu ngritur në statusin e sublimes, por edhe të zbresë në gradat më të ulëta, edhe më poshtë se kafshët. E gjitha kjo, me vullnetin e njeriut dhe pikërisht vullneti përbën shpirtin e lirisë. Është vullneti ai që bën zgjedhjen dhe në bazë të kësaj zgjedhjeje të lirë mban përgjegjësi. Në momentin që kemi të bëjmë me detyrim dhe imponim,

zhbëhet logjika e përgjegjësisë dhe llogaridhënies.

Ti imponosh njeriut “engjëlloren” apo “kafshëroren” është shkelje e vullnetit të Krijuesit, i Cili deshi që kësaj krijese me emrin njeri, ti japë lirinë e zgjedhjes, sepse prej kësaj lirie buron dhe përgjegjësia e tij. Ai jep llogari vetëm në bazë të kriterit të lirisë.

Liria për të zgjedhur

Pasi përfundoi krijimi i Ademit (a.s.) dhe i dha shpirt, Zoti e vendosi në parajsën e amshuar. Më pas Ai i krijoi dhe bashkëshorten e tij. Për hir të së vërtetës, Kur’ani nuk e citon askund emrin që mbante e shoqja e Ademit (a.s.), duke e përmendur vetëm si bashkëshorte. Ademi dhe bashkëshortja e tij kishin të drejtë dhe liri për të shijuar gjithçka që gjendej në parajsë, përveç një peme të vetme. Ata jo vetëm që nuk duhet të hanin nga frutat e saj, por as edhe ti afroreshin asaj peme. Megjithatë, Ademi dhe e shoqja nuk mundën ti rezistojnë tundimit dhe hëngrën nga pema, si rrjedhojë zbuluan se tashmë kishin mbetur lakuriq. Ajo që kishte ndodhur kishte qenë një transformim në vetëdije. Të dy u zbritën në tokë, e cila u shndërrua në banesën e tyre. E njëjta gjë i ndodhi dhe shejtanit.

Në fragmentin e pemës së ndaluar, vlen të meditojmë te një pikë shumë e rëndësishme: Nëse Zoti i lartësuar nuk donte që çifti të

hante nga kjo pemë e ndaluar, përse ua vendosi në mes të parajsës, aty ku e shihnin dhe u shkonte goja lëng nga frutat e saj? Ajo i joshte gjer në ekstrem edhe për faktin se ishte e ndaluar dhe nuk ia dinin shijen. Pika tjetër është prezenca e shejtanit në parajsë, pavarësisht se ishte dëbuar nga mbretëria qiellore pas refuzimit për t’iu përulur Ademit, **“shejtani u bëri vesvese”**.

Një pikë tjetër që meriton meditim rreth saj është dhe bindja e dy bashkëshortëve ndaj vesveseve të shejtanit. Kur’ani nuk e përmend që ishte e shoqja ajo që e nxiti Ademin të hajë nga pema e ndaluar, siç ceket në rrëfenjat izraelite. Çiftit i ishte thënë paraprakisht se shejtani ishte armiku i tyre, do i tundonte dhe se mund të bëhej shkak për ti nxjerrë nga parajsa. Besoj se vendosja e pemës së ndaluar në mes të parajsës ishte diçka e qëllimtë, pasi spontaniteti nuk është cilësi e Zotit. Pema ishte vendosur atje për të vënë në provë bindjen e Ademit ndaj urdhrave të Zotit, me vullnetin e tij të plotë dhe lirinë për të zgjedhur. Prezenca e pemës së ndaluar dhe e shejtanit ishte e domosdoshme për realizimin e përvojës së parë njerëzore. Pa këta dy elementë, njeriu do të mbetej i pafuqishëm për të bërë zgjedhje, për rrjedhojë, nuk do të dallonte me kafshët që udhëhiqen nga instinkti, apo nga një engjëll i programuar vetëm për tu bindur.

Ai është njeri sepse është i lirë. Ai është i lirë sepse është i arsyeshëm. Për rrjedhojë, ai është njeri sepse është i arsyeshëm. Zoti e lartësoi dhe preferoi ndaj shumë krijesave për vetë faktin se është i lirë falë arsyes dhe përgjegjësisë. Që njeriu të jetë i përgjegjshëm për veprat e veta dhe i lirë në zgjedhjen e rrugës së vet, ishte një zgjedhje e lirë që në gjenezë.

“Ne ua ofruam përgjegjësinë qiejve, Tokës dhe maleve, por ato nuk pranuan ta marrin përsipër dhe u frikësuan ta pranojnë atë, kurse njeriu e pranoi. Me të vërtetë, njeriu u tregua i padrejtë me veten dhe i paditur (për pasojat e kësaj përgjegjësie).”³

Ai ishte i paditur dhe i bëri padrejtësi vetes për faktin se nuk e vlerësoi madhësinë e përgjegjësisë që rridhte nga liria e dhënë; humbjen e qetësisë absolute që do të gëzonte në rastin e refuzimit të lirisë së zgjedhjes; shmangien e llogaridhënies, ndëshkimit dhe shpërblimit. Në fund, njeriu i lirë është përgjegjës për sjelljet e tij, edhe nëse këto sjellje bëhen gabimisht. Nga kjo përgjegjësi buron edhe madhështia e njeriut, i cili mbart në vetvete frymën e parë hyjnore. Nëse njeriu gëzon njëfarë lirie, Zoti gëzon lirinë absolute, vepron ç’të dojë, kur dëshiron diçka i thotë “Bëhu!” dhe ajo bëhet. Që këtu, mund të themi se njeriu mbart diçka nga hyjnorja dhe që këtu kuptojmë arsyen e

përzgjedhjes dhe superioritetit të tij ndaj shumë krijesave të tjera. Një sjellje e zgjedhur nuk është si një sjellje e diktuar. Prandaj edhe shohim që shpërblimi është sipas mundit dhe mundi është më i madh në rastin e lirisë së zgjedhjes. Besimtari që zgjedh të jetë i devotshëm në një shoqëri që nuk e motivon devocionin, ka shpërblim më të madh se besimtari që e gjen veten të devotshëm për shkak të shoqërisë që e imponon devocionin.

Urtësia hyjnore thelbësore, të cilën e nxjerrim nga narrativa e krijimit, është se, prezenca e të kundërtave është e domosdoshme për të njohur thelbin e tyre, por pa pasur askush të drejtë të monopolizojë njohjen e natyrshme të të kundërtave. Gjërat e humbasin vlerën pa prezencën e të kundërtave. Diversiteti i ngjyrave është i domosdoshëm për të bërë dallimin mes tyre. Diversiteti mes njerëzve është i domosdoshëm për jetën dhe për ta çuar atë përpara. Në të kundërt, jeta shndërrohet në një pellg të qelbur, ku uji ka humbur shijen e tij karakteristike, por dhe ajri ka marrë erë të keqe. Pa pluralizëm, pa diversitet dhe pa të kundërtat, gjithçka e humb shijen dhe kuptimin, gjithësia shndërrohet në një akumulim pa formë dhe kuptim. Madje, edhe feja e humbet kuptimin kur shndërrohet në një mendim të vetëm, një metodë të vetme, një institucion të vetëm:

3. Kur'an, Ahzab: 72.

“Mos u bëni si ajo gruaja që e shprish dhe e bën fije-fije atë që e ka tjerre fort, duke i përdorur betimet tuaja si mjet mashtrimi të njëri-tjetrit, nga frika se mos një grup të jetë më i madh se tjetri. Allahu, me këtë, vetëm sa u vë në provë e, me siguri, Ai do t’jua tregojë në Ditën e Kiametit, çështjet për të cilat ju nuk pajtoheshit.”⁴

Fjala përfundimtare pas së cilës çdo fjalë tjetër e humbet kuptimin i përket vetëm Krijuesit të këtij universi dhe autorit të tij, Ditën e

4. Kur’an, Nahl: 92.

Gjyqit të Madh. Sakaq, para kësaj dite do të mbetet diversiteti dhe liria e diversitetit është tipar njerëzor. Organizimi dhe disiplinimi i këtij diversiteti, si dhe bashkekzistenca me të, mbetet një nga objektivat e ekzistencës njerëzore mbi tokë. Ndërsa zhdukja e diversitetit, qoftë dhe në emër të Zotit, bie ndesh me vullnetin e të Gjithëmëshirshmit dhe me natyrën e njeriut.⁵

Përktheu: Elmaz Fida

5. Artikull i marrë dhe përkthyer nga adresa:
<http://www.alarab.co.uk/?id=20079>

Kleriku atdhetar Sheh Hamid Kraja (1870 -1926)

Muharrem Shqarri

Abstrakt

Hamid Kraja i përket atij brezi që jetoi dhe veproi në periudhën e fundit të Rilindjes Kombëtare Shqiptare dhe periudhën e parë të pavarësisë së vendit. Ai ka punuar dhe ka luftuar me të gjitha forcat e mundësitë e tij fizike dhe mendore duke u vënë plotësisht në shërbim të çështjes kombëtare. Ai ishte njohës i mirë i jurisprudencës, i ligjeve dhe kodeve zakonore, një teolog i shkallës së lartë, po ai ishte njëkohësisht dhe atdhetar i flaktë, që punoi me shpirt e me mendje për bashkimin e shqiptarëve pa dallim feje për të fituar dhe për të mbrojtur pavarësinë e vendit nga pushtuesit, që krijuan ndarje e përçarje deri brenda Islamit.

Sistemi monist që u vendos pas çlirimit të vendit, ndoqi një politikë përzgjedhëse ndaj veprimtarëve e atdhetarëve që qenë përkushtuar për çështjen kombëtare e rilindëse. Ai e pakësoi në maksimumin më të skajshëm listën e atdhetarëve klerikë që kishin dhënë ndihmesë për pavarësinë e përparimin e Shqipërisë, për bashkimin rreth shtetit amë të trojeve kombëtare të lëna jashtë kufirit dhe kishin shfaqur

prirje demokratike. Nga ky kriter nuk bëri përjashtim edhe figura e Sheh Hamid Krajës.

Hamid Kraja ose siç njihej, Sheh Hamidi, lindi në Kavajë në vitin 1870¹. Ai ishte i biri i sheh Mahmudit. Familja Kraja mendohet të jetë me origjinë të hershme nga krahina e Krajës, e cila ndodhet në verilindje të liqenit të Shkodrës, aktualisht bën pjesë në Republikën

1. AQSH, F. 266, V. 1926, D. 329, fl. 1.

e Malit të Zi. Shkaqet e largimit të saj nga trojet e hershme nuk dihen, por mendohet të jenë për arsye të kontradiktave që ka pasur me fqinjët malazezë, të cilët synonin epërsinë e tyre ndaj banorëve shqiptarë ose detyrave që mund t'u jenë ngarkuar si nëpunës administrate në kuadër të Perandorisë Osmane apo të funksioneve fetare.

Fillimisht familja Kraja u vendos në qytetin e Krujës, ku besohet se të parët e saj kanë ushtruar e përhapur tarikatin Halveti të fesë myslimane, që është një nga dy tarikatat më të rëndësishme (pas atij Bektashi), që gjetën vend në Shqipëri.

Familja Kraja u vendos përfundimisht në qytetin e Kavajës, besohet, për arsye fetare (ose të ndonjë funksioni në administratën e Perandorisë).

Pozicioni dhe kompleksi i ndërtimeve të bëra në Kavajë nga kjo familje si: ndërtimi i shtëpisë, ndërtimi i teqesë, ndërtimi i një hani dhe i disa dyqaneve paralel me rrugën kryesore të qytetit, që ndodhen rreth 200 metra nga Xhamia Kubelie, në qendër të qytetit, të bëjnë të mendosh e të pranosh hershmërinë e vendosjes së të parëve të kësaj familjeje në qytetin e Kavajës, atëherë kur qyteti ishte duke u formësuar.

Që në krye të herës, në burime të shkruara, familja mbajti mbiemrin Kraja, që ishte toponimi i origjinës së largët të saj.

Evlija Çelebiu në shënimet e tij për Kavajën e gjysmës së dytë të shekullit XVII përmend dy teqe.² Kemi mendimin se njëra prej tyre ishte ajo e ndërtuar nga paraardhësit e Hamid Krajës. Ndërtimi i teqesë së familjes Kraja në krye të një rruge që nis nga rruga kryesore, i dha emrin asaj duke u emërtuar “Rruga e Teqesë”. Pranë saj ishte edhe tyrbja me varret e paraardhësve.

Hamid Kraja vinte nga një familje e nderuar me tradita patriotike e fetare të qytetit të Kavajës. Ai ishte djali i vetëm i Sheh Mahmudit dhe i Zades. Ndjenjat atdhetare e fetare ia ushqyen prindërit që në fëmijëri dhe ai vetë i thelloi dhe i plotësoi me studimet që bëri.

Ky personalitet jetoi dhe veproi në kapërcyell të shek. XIX dhe në fillim të shek. XX, atëherë kur lufta për liri kombëtare kërkonte angazhim mendor e praktik. Prandaj, ky gërshtim do të vihet re gjatë gjithë veprimtarisë së Sheh Hamidit.

Në jetëshkrimin e tij, Hamid Kraja, na bën me dije se ka kryer “shkollën mestare të qytetit të Kavajës” ku studioi dhe “mori diplomën”.³

Më pas studioi në Stamboll për teologji dhe shariat (ligjshmëri), në një kohë kur Rilindja Kombëtare

2. Evlija Çelebiu në Shqipëri dhe në viset fqinje: Kosovë, Mal i Zi, Ohër, përgatitur nga Robert Elsie, Sh. B. “55”, Tiranë, 2008, f. 101.

3. AQSH, Fondi 803, Dosja I-15, fl. 31.

Shqiptare kishte arritur pjekurinë e saj dhe ka ndikuar në edukimin e tij patriotik. Burime të tërthorta na bëjnë me dije se ai e ka shkruar herët gjuhën shqipe me alfabetin e Stambollit.

Hamid Kraja i përket atij brezi që jetoi dhe veproi në periudhën e fundit të Rilindjes Kombëtare Shqiptare dhe periudhën e parë të pavarësisë së vendit. Ai ka punuar dhe ka luftuar me të gjitha forcat e mundësitë e tij fizike dhe mendore duke u vënë plotësisht në shërbim të çështjes kombëtare. Ai ishte njohës i mirë i jurisprudencës, i ligjeve dhe kodeve zakonore, një teolog i shkallës së lartë, po ai ishte njëkohësisht dhe atdhetar i flaktë, që punoi me shpirt e me mendje për bashkimin e shqiptarëve pa dallim feje për të fituar dhe për të mbrojtur pavarësinë e vendit nga pushtuesit, që krijuan ndarje e përçarje deri brenda Islamit.

**Veprimtaria si mësues,
drejtues i arsimit, i zgjedhur në
pushtetin vendor, kadi, gjyqtar
dhe përfaqësues i qarkut të
Kavajës në kuvendet rajonale e
kombëtare**

Në jetëshkrimin e tij Sheh Hamidi shkruan se, pasi mori diplomën, hyri në Medrese, në të cilën vazhdoi 10 vjet, nga viti 1309 deri më 1319 allaturka.⁴

Veprimtaria mësimore e Hamid Krajës në Medresenë e Kavajës përfshin një periudhë 10-vjeçare. Nga një dokument arkivor i shkruar në

osmanisht, që ndodhet në dosjen mbi biografinë e tij, mësojmë se Hamid Kraja është personi më i rëndësishëm (drejtues) i këshillit të zyrës së arsimit në Kavajë, i cili jep pëlqimin për programet mësimore, miraton afatet e kohëzgjatjes së mësimave dhe përcakton rregullat për zhvillimin e provimit në shkollat ruzhdije. Në këtë dokument (Paraqitje) tregohet se ai është kujdesur që nxënësit në shkollë (medrese) të marrin njohuri të gjera duke u dhënë rëndësi lëndëve gjuhësore, shkencore dhe teknike. Tërheq vëmendjen fakti se qysh në atë periudhë të largët është vlerësuar dhe janë hedhur hapa konkrete për mësimin e profesioneve, duke futur në program dhe lëndë teknike profesionale që nxënësi të aftësohej për jetën, duke pasur parasysh se jemi rreth 20 vite para ditës së pavarësisë.

Në dokument shkruhet: “[...] Hamid efendiu e vlerëson të rëndësishëm nivelin e shkollave profesionale.”⁵

Edhe të dhënat gojore e sjellin Hamid Krajën si një mësues e drejtues të përgatitur, serioz, të përkushtuar, kompetent në trajtimin e çështjeve të sistemit arsimor, të ligjshmërisë, atyre fetare dhe administrator i zoti. Nëpërmjet edukimit që bëhej në shkollë realizohej, krahas të tjerave, edhe edukimi atdhetar sipas motos islame “për fe dhe atdhe”. Dashuria për gjuhën amtare dhe dashuria për atdheun u mbajt e ndezur në këtë vatër të dijes dhe të edukimit.

4. Po aty, fl. 30.

5. AQSH, F. 803, D. I-15, fl. 30.

Në periudhën para shpalljes së pavarësisë, më e rëndësishmja e kësaj kohe është përpjekja e tij e vazhdueshme, krahas kolegëve të tjerë, për t'u mësuar nxënësve gjuhën shqipe në medrese, në shtëpinë e tij e kudo. Në këtë vështrim, ai, si dhe kolegët e tij, është cilësuar me të drejtë ndër të parët atdhetarë kavajas që hodhën themelet për t'u mësuar nxënësve të vet gjuhën shqipe.

Qysh në moshë të re Hamid Kraja u dallua për zgjuarsë e mprehtësi. Gjatë gjithë periudhës së mësuesisë ai e prezantoi veten në të gjitha aspektet jo vetëm si njeri i aftë e i kompletuar në fushën e njohurive, por edhe i ndershëm, komunikues, i ëmbël, zemërmadh e autoritar. Për këto e të tjera cilësi, ai qysh në moshë të re gëzoi respektin, mirënjohjen dhe besimin e bashkëqytetarëve të tij, të cilët nuk nguruan të kërkonin emërimin e tij në pushtetin vendor të qytetit të Kavajës.

Pas një periudhe pune të suksesshme dhe futjes së një fryme të re në medrese, Hamid Kraja do të shkëputet nga medreseja dhe do të bëhet pjesë e administratës drejtuese në Katundarinë (bashkinë-M. Sh.) e Kavajës. "Më 1320 deri më 1324 u emnuesh me pëlqim të popllitë antarë në Katundarit Kavajës,"⁶ shkruan ai në jetëshkrimin e tij.

Pas ndarjes nga jeta të babait të tij, sheh Mahmudit, në sajë të njohurive e formimit të tij, Hamid Kraja mori titullin fetar "Sheh". Që nga ajo kohë ai mori administrimin e Teqesë

Halvetiane që ndodhej pranë shtëpisë së tij në lagjen Sharrë të qytetit të Kavajës dhe, që nga ajo kohë, do të thirrej "Sheh Hamid" nga besimtarët e bashkëqytetarët e tij.

Sheh Hamidi, besimtar jofanatik e "njeri me parime moderne", ishte një atdhetar i devotshëm, po ashtu, atdhetarë i kishte edhe miqtë e bashkëpunëtorët e tij më të ngushtë. Ai do të shquhej si një veprimtar aktiv në shërbim të lëvizjes për çështjen kombëtare, që zhvillohej në Kavajë, përkrah patriotëve demokratë të qytetit si: Bajram Xhanit, Ahmet Bejtagës, Andrea Ekonomit, Mustë Carës, haxhi Isuf Kazazit, Abdurrahim Sedjes, Stavro Stavrit, Besim Sinellës, Hasan Elhykës, Pal Xhumarit, av. Haxhi Nijazit, Hasan Gjeçit, Qazim Fortuzit, Hamdi Ohrit, Mehmet Rreshkës (Hushi) etj. Krahas bashkëpunimit me patriotët kavajas, në veprimtarinë e tij në dobi të atdheut të dashur, Hamid Kraja - Sheh Hamidi, pati kontakte e bashkëpunoi me mjaft patriotë brenda e jashtë Atdheut.

Ashtu siç ishin të shumta problemet që kishte Shqipëria e atyre viteve, edhe fushat ku u përfshi kontributi i Sheh Hamidit, qenë të shumta.

Ai e shkriu jetën e tij për "shqiptarizmen", për përhapjen e gjuhës shqipe, për shkrimin dhe leximin e saj, për hapjen e shkollave shqipe në vend, për pavarësinë e vendit, për stabilitetin e qeverisjes dhe zhvillimin e institucioneve vendore, në ngritjen, organizimin

6. Po aty, fl. 31.

dhe funksionimin e institucioneve të drejtësisë, për zhvillimin e demokracisë në Shqipërinë feudale, për ruajtjen dhe forcimin e zakoneve e të traditave më të mira fetare e kombëtare të popullit shqiptar.

Cilësi të figurës së Sheh Hamidit si teolog ishin dashuria për njerëzit, zemërgjerësia, thjeshtësia dhe durimi. Këto janë parime të rëndësishme të fesë islame dhe me ato ai pasuronte vazhdimisht jetën e tij shpirtërore, duke ushqyer edhe besimtarët me këto cilësi.

Brenda e jashtë Shqipërisë në rend të ditës shtrohej çështja e çlirimit kombëtar. Pjesë e lëvizjes së gjerë iluministe, letrare, kulturore, në fushën diplomatike etj., për fitoren e pavarësisë kombëtare, kanë qenë edhe përpjekjet dhe aktiviteti i rilindësve tanë, të cilët shkrinë energjitë e tyre për edukimin e popullit shqiptar me ndjenjën kombëtare. Ndër ta, në këto situata edhe Sheh Hamidi “iden kombëtare e ka pranue qysh në kohërat e errëta të sundimit osman”.⁷ Ai u bë pjesë e gjithë lëvizjes kombëtare që zhvillohej në vendin tonë dhe që në vijën e parë të kësaj lëvizjeje në qytetin e tij të lindjes. Sheh Hamidi përqafoi dhe vuri në jetë moton e Rilindjes Kombëtare: “Dritë e diturisë përpara do të na shpjerë”.

Sheh Hamidi, ashtu si shumë mëmëdhetarë që dinin të shkruanin gjuhën shqipe, është përpjekur dhe ka punuar për mësimin dhe

përhapjen e gjuhës shqipe në kohën e sundimit osman. Nga dëshmi të bashkëkohësve të tij kemi mundur të faktojmë se “Sheh Hamidi ka qenë një patriot i flaktë për çështjen e pamvartësisë së Shqipërisë dhe aktivitetin e ka filluar që para vitit 1912 për përhapjen e gjuhës shqipe”.⁸ Sheh Hamidi e kishte kthyer shtëpinë dhe teqenë e tij në një shkollë ilegale, ku u mësohej shqipja fëmijëve dhe të rriturve.

Ai ka qenë anëtar i një klubi mëmëdhetarësh “qi kishte përmbledh në gji shqiptarët e vërtet dhe s’ka mungue të përqafojë me kurajo çdo vendim të grupit shqiptar të Kavajës”.⁹ “Shpallja e Hyrietit, - thuhet në një material, - u dha mundësi patriotëve të Kavajës me punue lirisht për çështjen kombëtare. Ata çelën shpejt një klub, që u ba vatra e gjithë atyne që punojshin për shqipen e Shqipërinë. Kështu lëvizja kombëtare rritej dita-ditës. Patriotët Ahmet Haxhiu, haxhi Isuf Kazazi, Sheh Hamidi, Haxhi Niaziu, Besim Sinella dhe Hasan Gjeçi, u munduan me çelë një shkollë shqipe, por mjerisht autoritet u qitshin shumë pengime, prandaj këta abetaren ua mësojshin njerëzve nëpër shtëpitë e tyre, tue marrë masa qi kjo punë të mos i vente në vesh qeverisë”.¹⁰

8. Deklaratë e veteranit Y. Ejupi.

9. AQSH, F. 266, V. 1926, D. 329, fl. 1.

10. Lufta për çlirim kombëtar në vitet 1878-1912. (Kujtime nga lëvizja për çlirimin kombëtar), Botim i Universitetit Shtetëror të Tiranës dhe i Institutit të Historisë dhe të Gjuhësisë, Shtypshkronja “M. Duri”,

7. AQSH, F. 266, V. 1926, D. 329, fl. 1.

Librat dhe materialet e tjera shqipe silleshin në Shqipëri fshehurazi me kuaj nga qiraxhinjtë dhe tregtarët shqiptarë që bënë rrugë nga Manastiri, Ohri, Elbasani, Berati etj. Kjo ishte një punë mjaft e vështirë dhe e rrezikshme.

Sheh Hamidi i vlerësonte librat, revistat e gazetat e shkruara në shqip, si sendet më të çmuara. Abetarja e vogël shqipe ruhej si një gjë e shenjtë, me të cilën mund të mësoheshin gjëra të mëdha: mund të ndihmohej atdheu. Duke shfrytëzuar petkun fetar dhe respektin që gëzonte në popull, ai shkonte në fshatrat e zonës së Kavajës, të Rrogozhinës deri në Çermë të Lushnjës, ku kishte influencë fetare e lidhje miqësore dhe përhapte idetë kombëtare e domosdoshmërinë e shkrimit të shqipes me alfabetin që përcaktoi Kongresi i Manastirit. Përveç kësaj, edhe ceremonitë e ritet fetare në teqenë e tij, Sheh Hamidi, i zhvillonte në gjuhën shqipe.

Mësuesi veteran Zenel Shehu shkruan: “Sheh Hamidi nuk ka qenë vetëm një patriot atdhetar, por është përpjekur dhe për përhapjen e gjuhës shqipe. Këto i mbaj mend dhe i di fare mirë”.¹¹ Madhështia e rilindësve qëndron në faktin se ata e kuptuan që shqiptarët mund të bashkoheshin, të çliroheshin e të zhvilloheshin vetëm duke i kapërcyer ndasitë fetare, duke e vënë kombësinë mbi fenë, pavarësisht se qenë besimtarë e shpesh herë edhe klerikë.

I tillë ishte edhe Sheh Hamidi. Në tërë veprimtarinë e tij ai u përpoq me energji për bashkimin e popullit shqiptar pa dallim feje, por edhe për bashkimin e trojeve shqiptare në një qeverisje shqiptare.

Sheh Hamidi godiste herë pas here veprimet dhe propagandën antikombëtare të shkollës greke në Kavajë.

Fillimi i Luftës Ballkanike në tetor 1912 dhe sulmi i ushtrisë serbo-malazeze nuk ishte i papritur për atdhetarët shqiptarë. Për të realizuar qëllimin e tyre, trupat malazeze i përqendruan përpjekjet ushtarake kundër qytetit të Shkodrës dhe, që në ditët e para të luftës, më 15 tetor 1912, e patën rrethuar atë.

Sheh Hamidi dhe atdhetarët e tjerë kavajas krijuan një komision që do të organizonte mobilizimin e luftëtarëve kavajas për mbrojtjen e Shkodrës. Krahës kësaj, në teqenë e tij ai bënte thirrje për mbrojtjen e qytetit verior, madje, thuhet se ai dhe atdhetarë të tjerë ndihmuan edhe materialisht familjet e luftëtarëve që niseshin drejt Shkodrës.

Duke vlerësuar rrezikun që i kanosej Shqipërisë, diplomati Ismail Qemali dhe patriotët të tjerë shqiptarë vendosën të shpallnin mëvetësinë e Shqipërisë. Ata u nisën drejt Shqipërisë dhe zbritën në Durrës. Ismail Qemali, duke parë gjendjen e rëndë në Durrës, vendosi që të nisej për në Vlorë.

Në udhëtimin historik drejt Vlorës, Ismail Qemali pati një

Tiranë, 1962, f. 263.

11. Kujtime të mësuesit veteran Z. Shehu.

qëndrim të shkurtër në Kavajë, ku arriti në paraditen e 23 nëntorit 1912 dhe pati një takim me patriotët kavajas, si: Qazim Fortuzi, Sheh Hamidi, Mustë Cara, haxhi Isuf Kazazi, Andrea Ekonomi, Zenel Biturku, Pal Xhumari, Haxhi Xhoi, Besim Sinella e të tjerë.

Në grupin e patriotëve që morën pjesë në takimin që Ismail Qemali zhvilloi te Hani i Trujës, mori pjesë dhe Sheh Hamid Kraja, kujtojnë bashkëkohësit e tij.

Ismail Qemali i njohu atdhetarët kavajas me gjendjen kritike në të cilën ndodhej Shqipëria dhe masat që duhet të merreshin sa më parë. Ai i porosi ata të ngrinin sa më parë flamurin kombëtar, sepse serbët kishin vendosur të mësynin drejt Shqipërisë së Mesme. Ishte e rëndësishme që, kur serbët të hynin në Kavajë dhe në qytetet e tjera ku do të kalonin, të gjenin të ngritur flamurin kombëtar, që tregonte se populli e kishte bërë zgjedhjen e tij, atë të shkëputjes nga Perandoria Osmane dhe pavarësinë.

Pas takimit të zhvilluar në Kavajë, Ismail Qemali mori udhën për në Vlorë, atje ku do të mbledheshin përfaqësuesit e kombit shqiptar.

Patriotët kavajas u kujdesën për sigurimin e udhëtimit dhe shoqërimin e Ismail Qemalit edhe për faktin se situata në vend ishte e ngarkuar me ngjarje të shumta dhe të papritura.

“Meqenëse Sheh Hamidi ishte një person me mjaft ndikim

në Kavajë, është kujdesur për përcjelljen e plakut mjekërsermë me anën e miqve të tij si Bajram Xhani e të tjerë”.¹²

Pas takimit me Ismail Qemalin, grupi i njerëzve me mendje të kthjellët dhe largpamës për të ardhmen e Shqipërisë, u përgatitën për ngritjen e flamurit kombëtar në Kavajë, sipas porosisë së Plakut të Vlorës. Por nuk ishte e lehtë. Më 27 nëntor 1912, patriotët kavajas Qazim Fortuzi, Sheh Hamidi, Mustë Cara, Andrea Ekonomi, haxhi Isuf Kazazi, Pal Xhumari, Besim Sinella, Haxhi Xhoi, Zenel Biturku etj., dolën në ballkonin e katit të dytë të nënprefekturës së Kavajës dhe ngritën flamurin kombëtar. Për rolin dhe ndihmesën që dha Sheh Hamidi në këtë periudhë, një dokument i hershëm arkivor, duke karakterizuar figurën e tij, shkruan:

“...Sheh. Njeri me parime moderne, iden kombëtare e ka pranue qysh në kohrat e errta të sundimit osman [...] Shqiptar i flaktë dhe atdhetar i deklaruem...”¹³

Të nesërmen e ngritjes së flamurit në Kavajë, u krye akti final në Vlorë. Shqipëria më 28 nëntor 1912 shpalli pavarësinë.

Gëzimi për ngritjen e flamurit kuq e zi për popullin e Kavajës nuk zgjati shumë. Forcat serbe po përparonin dita-ditës në brendësi të trojeve shqiptare, gjatë luginës së Shkumbinit.

12. Deklaratë e veteranit Y. Ejupi.

13. AQSH, Fondi 266, viti 1926, D. 167, fl. 1.

Më 17/30 vjeshta e tretë 1328/1912 bëhet ky njoftim: “Ju bajmë me ditë se pas lajmimit të komandës së gjindarmëriës së Lushnjes, ushtria serbe e shkeli Kavajën”.¹⁴

Në mënyrë që të protestohej pranë autoriteteve serbe për heqjen e flamurit kuq e zi në qytetet ku kishin hyrë serbët, duke kërkuar prej tyre të respektonin të drejtën e shqiptarëve për vetëqeverisje, pushimin e veprimeve armiqësore dhe largimin e forcave serbe, pasi Shqipëria ishte një shtet i pavarur, Ismail Qemali, në emër të Qeverisë së Vlorës, përgatiti tekstin e një telegrami. Këtë telegram të Kryetarit të Qeverisë së Përkohshme, me porosi të tij, Sheh Hamidi ia paraqiti vetë komandantit të forcave serbe në Kavajë duke protestuar për pushtimin e qytetit dhe heqjen e flamurit kombëtar.

Me gjithë protestën e bërë nga Sheh Hamidi në emër të Qeverisë Provizore Shqiptare për të kundërshtuar heqjen e flamurit kombëtar prej ushtrisë serbe nga ndërtesa e nënprefekturës, zaptuesit serbë vazhduan në të tyren. Flamuri kuq e zi u hoq. Kjo tronditi mjaft zemrat e atdhetarëve e të patriotëve kavajas. Dhimbjen e shkaktuar nga ky akt i serbëve, Sheh Hamidi u përpoq ta lehtësojë disi duke e mbajtur flamurin kombëtar në shtëpinë e tij.

14. Lef Nosi, Proklamimi i Indipendencës shqiptare, në “Dokumenta Historike për t’i shërbye historisë tonë kombëtare”, Elbasan, Shtypshkronja “Elbasani”, Nr. 9, viti I, Vjeshtë III (Nëntor) 1924, f. 269.

Që nga kjo kohë Sheh Hamidi e bëri flamurin kuq e zi pjesë të pandarë të jetës.

Në një dokument që ruhet në Arkivin Qendror të Shtetit mësojmë se Sheh Hamidi “flamurin kombëtar e mbante në shtëpi me nderim të madh mbas Shpalljes së Indipendencës.”¹⁵ Qeveria e Vlorës siguroi disa rezultate të dukshme në përpjekjet për t’i bashkuar tokat shqiptare nën pushtetin e saj. Vëmendje të posaçme ajo i kushtoi organizimit të shtetit shqiptar. U krijuan gjykatat shtetërore, u përcaktuan detyrat e tyre etj.

Për kontributin dhe vlerat e tij, pjesë e administratës së re të Shqipërisë së pavarur do të ishte dhe sheh Hamid Kraja, i cili u ngarkua për të shërbyer në organet e drejtësisë shqiptare të ngritur nga Qeveria e Vlorës.

Nisur nga cilësitë morale, njohja e sheriatit (ligjeve), formimi kulturor dhe përvoja e tij, Sheh Hamidi emërohet gjyqtar në gjykatën e Kavajës.

Detyrën si gjyqtar Fillore në Kavajë, në Qeverinë e Ismail Qemal Vlorës, Sheh Hamidi do ta kryejë për 5 muaj.¹⁶ Shkaku i ndërprerjes së detyrës si anëtar i gjykatës pas pesë muajve ka qenë shkëputja e Kavajës nga juridiksioni i Qeverisë së Vlorës, ngaqë Esat Toptani formoi në tetor 1913 “Pleqësinë e Shqipërisë së Mesme”, me të cilën Sheh Hamidi nuk u pajtua kurrë.

Si mbështetës i qeverisë së Vlorës,

15. AQSH, Fondi 266, viti 1926, D. 167, fl. 1.

16. AQSH, F. 803, D. I – 15, fl. 30.

ai mbante një qëndrim kundërshtues ndaj veprimtarisë dhe propagandës antikombëtare të Esat Toptanit, e cila helmonte mendjet dhe zemrat e njerëzve.

Me këtë qëndrim e veprimtari Sheh Hamidi kishte fituar respektin dhe besimin e njerëzve të thjeshtë për virtytet e larta të karakterit të tij. Duke qenë se ai ishte mbështetës i Qeverisë së Ismail Qemalit, Sheh Hamidi “ka qenë kundërshtar i seperatizmit esadist dhe njeri me ideal patriotik”. Për këtë arsye ai nuk mund të ishte pjesë e qeverisjes esadiste.

Më 29 korrik 1913, Konferenca e Ambasadorëve të Fuqive të Mëdha, e mbledhur në Londër, mori vendimin përfundimtar për Shqipërinë: Fuqitë e Mëdha vendosën formimin e një “principate autonome; sovranë, trashëgimore dhe neutrale, nën garancinë e 6 Fuqive. Ndonëse vendimi i 29 korrikut 1913 ishte një akt ndërkombëtar shumë i rëndësishëm për njohjen e pavarësisë së Shqipërisë, çështja shqiptare mbeti e pazgjidhur plotësisht. Gjysma e territoreve shqiptare nuk e fitoi lirinë.

Për Sheh Hamidin, sikurse për gjithë atdhetarët e vërtetë, ky fakt ishte i trishtueshëm dhe kërkonte zgjidhje sa më të afërt dhe të drejtë.

Në nëntor 1913, Fuqitë e Mëdha emëruan gjermanin Vilhelm Vidi si princ të Shqipërisë. Qeveria e Përkohshme e Vlorës prirëj ta shikonte ardhjen e një princi të huaj, ashtu si ishte vendosur nga Fuqitë e Mëdha, si një operacion që nuk do

të bëhej duke përjashtuar Qeverinë e Përkohshme.

Më 7 mars 1914, Princ Vidi, me emrin Vilhelmi I, dhe Princeshë Sofia arritën në Shqipëri. Princi Vidi u prit në portin e Durrësit nga delegacione të shumta shqiptarësh nga vendi dhe diaspora, ku bënë pjesë figura të njohura të luftës së popullit shqiptar për liri e pavarësi. Ndër ta ishte dhe Sheh Hamidi dhe grupi i Kavajës. Sheh Hamidi ishte një nga ata që shpresonin e besonin se do të formohej një qeveri kombëtare, do të vendosej qëndrueshmëria e vendit dhe Shqipëria do të ecte krahas vendeve të zhvilluara të Evropës. Me këtë rast do të merrte fund gjendja e paqëndrueshme që ishte krijuar në vend.

Nga tre vizita që Princ Vidi bëri jashtë Durrësit, të parën e bëri në Kavajë, më 20 prill të vitit 1914. Bashkë me familjen e tij dhe i shoqëruar nga oborri mbretëror ai erdhi në Kavajë, ku u prit me entuziazëm nga mbarë populli i qytetit dhe zonave rreth tij. Vendin kryesor në programin e vizitës së Princ Vidi në Kavajë do ta zinte vizita e tij në Teqenë e Sheh Hamidit, i cili do të mbante edhe fjalën përshëndetëse në emër të popullit të Kavajës. Sheh Hamidi e priti “shkëlqyeshëm” e me nderime në teqenë e vet Mbretin Vid dhe mbretëreshën Sofi në pranverën e 1914-s. Pas urimit të mirëseardhjes që u bëri “mysafirëve”, Sheh Hamidi iu drejtua me një fjalim të ngrohtë të pranishmëve dhe bashkëqytetarëve të

tij, të cilët e kishin zgjedhur disa herë si përfaqësues të tyre. Oratoria e Sheh Hamidit la përshtypje të mirë te Princ Vidi dhe shoqëruesit e tij. Përshtypjet për vizitën e Princ Vedit në Kavajë, sekretari i tij H. Armstrong i pasqyron në librin “Gjashtë muaj mbretëri 1914”.

Me predikimin e tij paqësor dhe shpirtin human Sheh Hamidi do të ngelet kultivues i frymës afruese, mirëkuptuese dhe pluraliste në shoqërinë e kohës, duke i shërbyer paqes dhe harmonisë ndërfitare në qytetin e tij e më gjerë.

Mbreti nuk e njihte vendin dhe kjo e kishte shtyrë të mbështetej shumë te Esat Pasha, ndërsa Esati po përgatitej të përmbyste Mbretin. E nxitur nga Esat Toptani, i cili synonte të ishte ai drejtuesi i vendit, më 17 maj 1914 shpërtheu lëvizja kryengritëse e quajtur Kryengritja e Shqipërisë së Mesme. Xhandarmëria e Durrësit e arrestoi Esat Toptanin në shtëpinë e tij dhe ai u detyrua të largohej në Itali. Zjarri i kryengritjes u përhap edhe në krahinat e tjera.

Duke parë gjendjen kritike të krijuar në Shqipëri, Fuqitë e Mëdha nuk dhanë asnjë lloj ndihme dhe këshilluan Mbretin që të hiqet ca kohë nga Shqipëria dhe qeverinë ta marrë në dorë KNK-ja, derisa të zbutet zemërimi i popullit të egërsuar. Në këto rrethana, Princ Vidi u detyrua të largohej nga Durrësi më 3 shtator 1914, pas një memorandumit drejtuar popullit shqiptar. Bashkë me të iku dhe qeveria duke lënë pas një zbrazëti

pushteti, të cilën u thirr ta mbushte KNK-ja edhe një herë.

Me largimin e Princ Vedit, Esati filloi menjëherë përgatitjet për të realizuar synimet e tij. Sapo arriti në Durrës, ai e detyroi Këshillin e Përgjithshëm të kryengritjes ta kalonte pushtetin në duart e tij dhe shpalli veten kryetar të “Qeverisë së Përkohshme” dhe komandant të përgjithshëm të ushtrisë. Në të gjithë Shqipërinë e Mesme ai vuri administratën e tij. Esat Toptani filloi eliminimin e kundërshtarëve të tij në gjirin e Lëvizjes Fshatare.

Sheh Hamidi dhe patriotët e tjerë kavajas ndiqnin me vëmendje zhvillimin e situatës. Këta morën nismën për të dalë me një program të ri, që t’u përshtatej interesave kombëtare. Ata deklarorin se nuk ishin të shtyrë nga asnjë fuqi e huaj, se në konfliktin botëror mbanin asnjësinë dhe se qëllimi i vetëm i Lëvizjes së tyre ishte rrëzimi i E. Toptanit dhe kërkuar rikthimin e Princ Vedit në Shqipëri.

Duke u njohur me këto kërkesa dhe qëndrim të ri të krerëve të kryengritjes, pjesëmarrës aktivë të lëvizjes patriotike në Kavajë, u përpoqën të afroheshin me kryengritësit. Sheh Hamidi, Bajram Xhani, Ahmet Bejtaga, haxhi Isuf Kazazi e ndonjë tjetër morën kontakte me krerët e kryengritjes, Haxhi Qamilin, Sadi Tatanin, etj., dhe me maturi e pjekuri ia arritën që ta drejtonin Lëvizjen në dobi të qytetit dhe në favor të çështjes kombëtare.

Sheh Hamidi u përpoq që të ishte sa më aktiv dhe të ndikonte që kjo kryengritje të kishte si qëllim kryesor rrëzimin e E. Toptanit dhe formimin e një qeverie të ligjshme në vend.

Në prill të vitit 1915, kur kryengritësit forcuuan dhe e ngushtuan rrethimin e Durrësit ku ndodhej Esat Toptani, atëherë ai iu drejtua me kërkesën për ndihmë miqve të tij, Malit të Zi dhe Serbisë. Ata ishin të gatshëm për të ndërhyrë në Shqipëri, sepse kështu realizonin synimet e tyre të vjetra për t'u vendosur në trojet shqiptare.

Për të penguar hyrjen e serbëve, atdhetarët kavajas Bajram Xhani, Ahmet Bejtaga, Sheh Hamidi, Mehmet Sheshi, Mehmet Perçemi, Besim Sinella, Hasan Elhyka, etj., u aktivizuan për organizimin e qëndresës popullore kundër pushtuesve, jo vetëm në Kavajë, por edhe në zonat përreth saj. Sheh Hamidi ishte ndër iniciatorët e organizimit të kësaj qëndrese. Kavaja formoi dy komisione: njëri do të shkonte në Peqin dhe tjetri në Shijak.

Në komisionin e Peqinit që përbëhej prej 6 vetash bente pjesë edhe Sheh Hamidi. Ai bente gjithçka për të ruajtur harmoninë ndërmjet popullsisë së qytetit. Me zgjuarsinë natyrore, inteligjencën dhe përgatitjen intelektuale ai ndërthurte thëniet e mesazhet fetare me këshilla të moralit dhe të atdhedashurisë, duke synuar rritjen e vetëdijes dhe ndërgjegjësimin e

popullsisë për gjendjen e turbullt të vendit. Por veprimtaria e esadistëve dhe qëndrimi nënshtrues i krerëve në këto qytete bënë çmos për ta penguar punën e këtyre komisioneve.

Serbët e kaluan kufirin më 2 qershor 1915, kurse më 13 qershor ata mbërritën në afërsi të Durrësit. Kudo që kaluan, ata ushtruan terror të egër jo vetëm ndaj kryengritësve, por edhe ndaj popullsisë.

Ushtria serbe shpërndau fuqitë kryengritëse dhe sundimin e vendit e mori në dorë Esat Toptani. Ndaj aktivistëve dhe pjesëmarrësve në Lëvizjen Fshatare të Shqipërisë së Mesme shpërtheu një valë e pashembullt terrori serbo-esadist. Edhe Sheh Hamidi nuk mundi të shpëtonte pa u ndëshkuar për shkak të bashkëpunimit me kryengritësit dhe kundërvënies ndaj planeve antikombëtare të Pashës. Ai do të burgoset nga ana e E. Toptanit dhe do t'i bastiset shtëpia duke i marrë materiale dhe dokumente që ai mbante aty.

Për pasojat që rënduan mbi Sheh Hamidin bën fjalë dokumenti arkivor, në të cilin, ndër të tjera thuhet: "Në kohën e rebelëve është burgosur dy herë rresht. Ishte kundërshtar i separatizmit esadist dhe njeri me ideal patriotik."¹⁷

Në janar 1916, ushtritë austro-hungareze hynë në Shkodër dhe marshuan për në Durrës. Serbia ishte thyer. Esat Toptani me pasanikët e tij, bashkë me ushtrinë italiane,

17. Po aty.



Sheh Hamidi (nr. 13) në takimin për të protestuar kundër copëtimit të Shqipërisë

kaluan detin. Pas hyrjes së ushtrisë austro-hungareze në vend, u bënë përpjekje për krijimin e një qeverie apo administrate shqiptare. Gjuha dhe veprimet administrative gjatë pushtimit austro-hungarez ishin kombëtare. Kultura juridike, përvoja e fituar si anëtar në gjykatën e Kavajës në kohën e Qeverisë së Përkohshme dhe respekti e besimi që ushqenin banorët e qytetit për Sheh Hamidin, bënë që ai të rifillojë punë në organet e administratës së qytetit. Më 1.5.1916 ai do të fillojë të kryejë detyrën si gjykatës paqtues dhe nga data 9.7.1916 do të caktohet si kadi¹⁸, duke qenë i zgjedhuri i “Këshillit të Naltë”, që ishte instanca më e lartë për çështjet e fesë islame në Shqipëri.

18. AQSH, F. 266, V. 1916, D. 7, fl. 1.

Sheh Hamidi shërbeu si gjykatës feje në Kavajë nga qershori i vitit 1916 e deri më 8 gusht 1917, i cili “detyrën e ka kryë plotësisht e s’i ka mbetë ndonji pengim, dhe asht njeri me moral të pëlqyeshëm”.¹⁹ Qarqe të ndryshme antishqiptare u shprehën hapur për copëtimin e Shqipërisë. Ministri i Bullgarisë në Berlin, dr. Dimitri Rizoff (Dimitri Rizali), botoi një libër në të cilin shprehej për copëtimin e Shqipërisë midis shteteve të ndryshme të Ballkanit. Ky botim ngjalli zemërim e protesta kudo në Shqipëri. Për të protestuar kundër mendimeve të shfaqura nga dr. Rizoff lidhur me kufijtë e Shqipërisë në mbledhjen që u organizua në Durrës më 26

19. AQSH, Fondi 803, Dosja I-15, fl. 31.

shkurt 1918, populli i Kavajës edhe këtë herë, autorizoi si anëtar të delegacionit Sheh Hamidin për të marrë pjesë atje.

Mbarimi i Luftës I Botërore më 11 nëntor të -1918s me fitoren e Antantës e gjeti Shqipërinë të copëtuar politikisht, të pushtuar ushtarakisht nga disa shtete fituese dhe në një gjendje të vështirë ekonomike.

Më 28 nëntor 1918, me rastin e përvjetorit të Pavarësisë, në të gjitha qytetet u organizuan manifestime të fuqishme, sidomos në Vlorë.²⁰

Në Kavajë përpjekjet për një manifestim patriotik për 28 nëntorin u bënë nga atdhetarët B. Xhani, Sheh Hamidi, etj.²¹

“Për kremtimin e festës së Flamurit” Sheh Hamidi, me autoritetin që e karakterizonte, dhe patriotët e tjerë kavajas arritën që të bindin autoritetet vendore për kremtimin e përvjetorit të gjashtë të Shpalljes së Pavarësisë. Ata ia arritën që me financimin e administratës vendore të sigurojnë “23 kuaj me lara nga katundi i Bagosit”²², me të cilët parakaluan në qytet, si dhe të shtrojnë një drekë përkujtimore me këtë rast ku morën pjesë autoritetet vendore. Në kushtet kur fati i Shqipërisë ndodhej në udhëkryq, zhvillimi i këtij manifestimi në Kavajë merrte një

rëndësi të veçantë: përkujtonte Ditën e Flamurit duke bërë të njohur para opinionit ndërkombëtar se Shqipëria ishte një shtet më vete e i pavarur që prej 6 vjetësh.

Konferenca e Pages, që do t’i fillonte punimet më 18 janar 1919 dhe do të shqyrtonte situatën pas Luftës Botërore, ishte në prag, kurse Shqipëria nuk kishte një qeveri kombëtare legjitime dhe, për pasojë, as përfaqësues legjitimë që do ta përfaqësonin në këtë konferencë dhe do të mbronin interesat e saj. Duke qenë kështu, hija e Traktatit të Fshehtë të Londrës endej shqetësueshëm mbi shqiptarët.

Pikërisht për formimin e një qeverie shqiptare që do të përfaqësonte interesat dhe do të mbronin të drejtat e kombit shqiptar para Fuqive të Mëdha në Konferencën e Pages, miku i Sheh Hamidit, kryetari i katundarisë së Tiranës, Ismail Ndroqi, dhe një grup patriotësh në Tiranë marrin nismën që të thërrasin një kongres “për me siguruar bashkimin e njësin e kombit dhe me pre propagandat e huaja”, e cila do të bëhej “më 19 Shindre (dhjetor) 1918 allafranga...”²³

Për të marrë pjesë në këtë mbledhje të rëndësishme në Tiranë, edhe këtë herë populli i qarkut të Kavajës dërgoi si përfaqësues birin e tij besnik Sheh Hamidin dhe Qazim bej Elbasanin.

20. Historia e popullit shqiptar, T. 2004, f. 187.

21. R. Hoxha, Kavaja në shekuj, Sh. B. “Bota shqiptare”, Tiranë, 1995, f. 124.

22. AQSH, F. 235, D. 12, V. 1918, fl. 1.

23. L. Nosi, Kongresi i Tiranës, në “Dokumente Historike...”, viti I, Nr. 1, Mars 1924, f. 27.

Në kuvendin e Tiranës u morën vendime të rëndësishme për kohën dhe situatën në të cilën ndodhej vendi ynë. U përcaktuan masat organizative për përgatitjen e një kongresi që do të mbahej në Krujë dhe do të vendoste për formimin e një qeverie shqiptare që do të përfaqësonte interesat e do të mbronte të drejtat e kombit shqiptar në Konferencën e Paqes.

U vendos që në kongresin e ardhshëm që do të mbahej në Krujë më 11 janar 1919, Kavajën ta përfaqësonin përsëri Sheh Hamidi dhe Qazim Hydi.²⁴ Mirëpo autoritetet italiane pëlqyen që një mbledhje e tillë të bëhej në Durrës më 25 dhjetor 1918 dhe për këtë qëllim prunë edhe delegatët në këtë qytet. Kongresi i planifikuar për në Krujë më 11 janar 1919, ia la vendin Kongresit të Durrësit që u mbajt më 25 dhjetor 1918.

Sheh Hamidi si përfaqësues i Kavajës në Kongresin e Durrësit dhe anëtarët e tjerë të grupit që kishin marrë pjesë në Kongresin e Tiranës, ishin të vendosur që të realizonin qëllimin për “formimin e një kabineti të përgjithshëm, i cili të përfaqësonte gjithë Shqipërinë e të mbronte të drejtat dhe interesat kombëtare përpara qeverive të huaja dhe Kongresit të Paqes” në Paris.

24. Lef Nosi (Instituti i Historisë), Dokumente historike - Për t'i shërbye historisë tonë kombëtare - (1912-1918), Botim i dytë me rastin e 95-vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë, Tiranë, 2007, f. 286-287.

Në kongres morën pjesë 50 delegatë, pothuajse nga e gjithë Shqipëria, por dhe nga Federata Pan-Shqiptare “Vatra” e Amerikës.

Italia, për të realizuar pikësynimet e saj, kishte punuar me krerët organizues të kongresit, Mehmet Konica dhe Myfit Libohova, duke shpresuar që të gjente përkrahjen e shqiptarëve për formimin e një “komiteti” a një qeverie proitaliane. Duke parë vendosmërinë e delegatëve, drejtuesit e kongresit nuk mundën të realizonin udhëzimet që u kishte dhënë Qeveria e Romës. Ditën e parë të Kongresit u vendos formimi i një qeverie të përkohshme. Sheh Hamidi ishte në favor të këtij vendimi. Në Kongresin e Durrësit proklamohet qeveria provizore e Shqipërisë, e kryesuar nga Turhan Pasha, ish-kryeministër në qeverinë e Princ Vedit. Kongresi i Durrësit goditi Traktatin e Fshehtë të Londrës për copëtimin e Shqipërisë dhe caktoi delegacionin që do të shkonte në Konferencën e Paqes në Paris për të paraqitur pikëpamjet shqiptare.

Një nga pikat e programit të qeverisë provizore ishte “ruajtja e qetësisë, e rregullit dhe riorganizimi i degëve të ndryshme të administrimit brenda”. Për këtë qëllim kudo u organizuan zgjedhjet e pleqësive (organeve drejtuese që vendosnin për punët etj.) dhe të kryepleqve.

Hamid Kraja do të jetë mjaft aktiv për të vënë në jetë këto vendime dhe për të marrë përsipër përgjegjësi. Në listën e kandidatëve për zgjedhjet



Sheh Hamidi dhe delegatë të Kongresit të Durrësit

e organizuara në Kavajë më 10 shkurt 1919, për zgjedhjen e pleqësisë me 12 anëtarë, ishte edhe emri i Sheh Hamidit. Pas përfundimit të votimit Sheh Hamidi do të jetë në grupin e 12 më të votuarve të qytetit.

Ai do të renditet i treti sipas numrit të votave të numëruara.²⁵ Në këtë mënyrë, ai së bashku me anëtarët e tjerë të pleqësisë merrnin përsipër barrën e rëndë të drejtimit të qytetit, të ruajtjes së rregullit e të qetësisë në vend, të zgjidhjes së problemeve e mosmarrëveshjeve etj., detyrë të cilën e kishte ushtruar edhe më parë.

Në mbështetje të kërkesave të delegacionit qeveritar shqiptar në Konferencën e Paqes kundër copëtimit të Shqipërisë, populli i

Kavajës organizoi një miting masiv me rreth 4000 vetë. Nga ky miting, që u organizua më 12 mars 1919, iu drejtua një protestë me shkrim Konferencës së Paqes në Paris.

Sheh Hamidi dhe Qazim Hydi, si pjesëmarrës në Kongresin e Tiranës dhe të Durrësit, si dhe patriotë të tjerë të qytetit, si: A. Tirana, M. Cara, Q. Fortuzi, H. I. Kazazi etj., dhanë ndihmesën e tyre në hartimin dhe frymën e tekstit të protestës.

Ndonëse po bëheshin afro shtatë vjet nga Shpallja e Pavarësisë, çështja shqiptare nuk kishte marrë ende një zgjidhje përfundimtare. Viset shqiptare të Kosovës dhe të Çamërisë ndodheshin të ndara nga trugu amë. Kërkesën për unifikimin e trojeve shqiptare Sheh Hamidi e kishte

25. AQSH, F. 266, V. 1919, D. 4, fl. 1.

parashtruar në tubime të ndryshme si në qarkun e Kavajës, ashtu dhe në ato në shkallë rajonale e kombëtare. Si person me ndikim dhe me mbështetje të gjerë në qarkun e Kavajës, Sheh Hamidi vihet në krye të një komisioni për organizimin e një mitingu më 6 gusht 1919 në Kavajë, në të cilin u protestua dhe u formulua një kërkesë drejtuar Konferencës së Paqes për përfshirjen e Kosovës e të Çamërisë në shtetin amë.²⁶

Ashtu si një vit më parë, në prag të Ditës së Flamurit, Sheh Hamidi organizoi një komision dhe me autoritetin që kishte në organet e pushtetit vendor (në bashki e në nënprefekturë), së bashku hartuan një program zyrtar për festimin e 28 nëntorit 1919 në Kavajë, duke përfshirë dhe nxënësit e shkollave të qytetit. Festa kombëtare e 28 nëntorit do të fillojë me vendosjen e flamujve kombëtarë kudo në qytet, në çdo dyqan e çdo shtëpi, qysh më 27 nëntor, që ishte dita e ngritjes së flamurit kuq e zi në Kavajë nga Sheh Hamidi dhe atdhetarët e tjerë të qytetit.²⁷

Ndërkohë që Sheh Hamidi dhe patriotët shqiptarë, kudo ku ndodheshin, bënë përpjekje për ruajtjen e mbajtjen e qetësisë e të rregullit në vend, si dhe për bashkimin e trojeve shqiptare “në caqet e kufijve etnikë” me Shtetin Shqiptar, Qeveria e Durrësit nuk po e kryente rolin që duhej. Ajo dilte e vepronte jashtë

programit të dhënë nga Kongresi i Durrësit, delegat i të cilit kishte qenë edhe Sheh Hamidi. Në kushtet e mosthirrjes së senatit nga Qeveria e Durrësit, kudo u shtrua kërkesa tjetër për thirrjen e një kongresi të ri kombëtar dhe formimin e një qeverie që të merrte në dorë fatet e vendit. Për këtë u ngrit një komision organizues me qendër në Lushnjë. Kongresi u mbajt më 21 janar 1920 në Lushnjë. Ai vendosi rrëzimin e qeverisë së Durrësit me argumentin se kishte shkelur programin e Kongresit të Durrësit dhe zgjodhi kryetar të qeverisë së re Sulejman Delvinën. Vendi i Princ Vidit që ishte bosh, do të plotësohej me një kandidat që do të miratohej në një Asamble Kushtetuese, e cila do të mblidhej në një kohë të përshtatshme, me votim të lirë e të përgjithshëm të popullsisë. Deri atëherë, rolin e Kryetarit të Shtetit do ta luante Këshilli i Lartë, apo Regjenca (që përfaqësonte mbretin), i përbërë nga katër atdhetarë të sprovuar për urtësi e drejtësi, përfaqësues edhe të katër besimeve fetare të popullit shqiptar. Në maj të 1920-ës, kur po organizohej gjykata e Kavajës, Sheh Hamidi u propozua nga Këshilli i Lartë (Regjenca) për të qenë anëtar i gjykatës së shkallës së parë dhe u emërua në gjykatën e Kavajës. Sheh Hamidi e mori këtë detyrë dhe punoi me përkushtim e devotshmëri për kryerjen e saj.²⁸

Ai u bë një nga nismëtarët dhe nxitësit për hapjen e shkollave shqipe në nënprefekturën e Kavajës në ato

26. Z. Shehi, Kavaja – Figura të shquara, f. 164.

27. AQSH, F. 266, V. 1919, D. 80, fl. 2.

28. AQSH, F. 803, D. I-15, fl. 30.



**Xhamia Plakë e vitit 1561, e prishur më 1 qershor 1922
nga nënprefekti Neki Starova**

vite. Shehu qëndronte në radhën e njerëzve që shqetësoheshin për mbarëvajtjen e vendit dhe mori pjesë aktive në lëvizjen demokratike të asaj kohe.

Në Kavajë ishte një xhami e njohur si Xhamia Plakë (Xhamia e Vjetër), ndërtuar në vitin 1561. Në mëngjesin e 1 qershorit 1922 banorët nuk po u besonin syve, faltorja e vjetër nuk bënte më hije në qytet. Me urdhër të nënprefektit të Kavajës ajo ishte rrënuar dhe kthyer në një grumbull mbeturinash të materialeve me të cilat ishte ndërtuar xhamia, duke thyer me kazma e lopata gjithçka ndodhej brenda mureve: orenditë e mjetet e saj dhe librat fetarë. Sheh Hamidi, si jurist e si anëtar i zgjedhur në pleqësinë e qytetit, kryepleqtë e

lagjeve, tregtarë të qytetit të Kavajës dhe të tjerë, i drejtuan organeve qendrore më 1.IX.1922 një protestë me shkrim, ku nënvizonin se të tilla veprime si ai i nënprefektit nuk janë bërë e nuk mund të bëheshin as “në ndonji shtet [...] pa ndonji histori ose me ndonji libër fetar...”²⁹

Si “njeri me parime moderne” e me bindje demokratike, në tetor të vitit 1923, Sheh Hamidi mbështeti dhe u bë një nga anëtarët më aktivë të shoqërisë “Xhoka”, si një forcë opozitare e qeverisë e me program demokratik. Ai u caktua nga Shoqëria “Xhoka” kandidat për zgjedhës të dytë në Gërmaj të Kavajës për zgjedhjet në Asamblenë Kushtetuese

29. AQSH, F.1152, V. 1922, D. 1369.

që u shpallën në shtator 1923.³⁰ Kandidat i kësaj shoqërie ishte edhe H. Isuf Kazazi. Kundërshtarët e tyre politikë përdorën dhunën, presionin, deri në zhdukjen fizike ndaj anëtarëve dhe simpatizantëve të “Xhokës” e të grupimeve të tjera opozitare. Ishte një mrekulli që Sheh Hamidi do të shpëtonte gjallë nga prita që iu bë, por pasojë e atentatit që u organizua ndaj tij, që plagosja në këmbë. Po atë ditë, dy orë pas atentatit, në Kavajë vunë në shënjestër dhe haxhi Isuf Kazazin, që e vranë bashkë me bashkëshorten pranë shtëpisë së tij më 25 dhjetor 1923. Në të tilla kushte dhune e terrori, rezultati i zgjedhjeve nuk tregonte realitetin.

Edhe pas këtyre ngjarjeve e rezultateve, Sheh Hamidi nuk i braktisi idealet e tij progresiste e demokratike, por mbeti një faktor me rëndësi në jetën e qytetit.

Më 22 janar 1924 në bashkinë e Kavajës u bë një mbledhje ku u diskutua për çështjen e kryeqytetit dhe u vendos që të dërgohej në Tiranë një delegacion, në përbërje të të cilit ishin Sheh Hamidi, Kleanti Mineu, Mustafa Cara, etj. Qëllimi i delegacionit ishte “që të bajn demarshat e nevojshme e të kërkojnë prej Kuvendit Kushtetues për kryeqytet Kavajën, simbas dëshirës popullore”.³¹

Në vitin 1924 në Kavajë erdhën figura politike të njohura për prirjet e

tyre demokratike, si: Mehdi Frashëri, Luigj Gurakuqi, Avni Rustemi, haxhi Ibrahim Dalliu, haxhi Jusuf Banka, Haki Tefik, Mustafa Mara, Xhemal Kondi, Dervish Hima, Ali Mulleti, Qazim Mulleti, Salih Hoxha Elbasani, Qamil Bala, Ismail Petrela, Rexhep Jella, Mitat Kulliçi, Reshat Kulliçi, Myntaz Vrioni, Selim Kukaleshi, Xhafer Hakani, Hashim Hakani, Selim Shpuza, Sheh Myslimi, Xhafer Zilka, Shaqir Preza, Beqir Valteri, Vahid Tivari, Ali Ndroqi, Haki Stërmilli, Bajram Curri etj.

Si një nga njerëzit që shquhej për pikëpamjet demokratike në qytetin e tij, Sheh Hamidi u takua e pati shkëmbim mendimesh me ta.

Në një periudhë të shkurtër të Qeverisë së Fan S. Nolit, të formuar në qershor të 1924-ës, ishin profilizuar katër grupe kryesore politike; përveç “Bashkimit” dhe grupit nolist, u krijuan për herë të parë dy forca të reja politike me programe të qarta e të përcaktuara. U krijua Partia Nacionale Demokrate e, më pas, më 18 tetor të 1924-ës, në Tiranë, u themelua Partia Radikal-Demokrate.

Në Partinë Radikal-Demokrate morën pjesë shumë intelektualë të njohur. Anëtar i saj u bë edhe Sheh Hamidi.

Për të bërë të mundur shtrirjen e Partisë Radikal-Demokrate, Sheh Hamidi ndërmoi nismën për formimin e degës së kësaj partie edhe në Kavajë. Ai gjeti mbështetjen dhe mirëkuptimin e intelektualëve dhe të

30. “Fletorja Zyrtare”, Nr. 69, Tiranë, e shtunë 15 dhjetor 1923, f. 4

31. Z. Shehi, Kavaja – Figura të shquara, vep. e cituar, f. 164.

demokratëve të qytetit, ndërmjet të cilëve edhe të anëtarëve aktivë e të nderit të shoqërisë “Bashkimi”, me të cilët ai kishte bashkëpunuar edhe më parë.

Në “nji mbledhje të mbajtur prej popullit të Kavajës ashtë formuë dega e Partis Radikale. Këshilla ashtë zgjedhun si vijon: “Kryetar: Sheh Hamidi; Anëtarë: H. Kariqi, Mustafa Cara, H. Nijazi, Sulejman Rrena, Kasëm Xhihani, Mustafa Turra”.³²

Pas rënies së Qeverisë së Nolit dhe pas triumfit të “Legalitetit”, frenat e pushtetit i kishte Ahmet Zogu. Menjëherë qeveria ndërmori disa veprime për të shtypur forcat kundërshtarë dhe mori masa për riorganizimin e pushtetit.

Pas vendosjes së pushtetit të A. Zogut, ndaj Sheh Hamidit do të merren masa duke e shkarkuar nga funksionet në gjykatë dhe duke bërë sekuestrim të një pjese të pasurisë, si kundërshtar politik i tij. Gjendja shpirtërore dhe shëndetësore e Sheh Hamidit sa vinte e përkeqësohej. Ai ndërroi jetë më 15 dhjetor 1926.

Vlerësimi për këtë figurë atdhetare shprehet dhe në këtë përmbledhje të shkurtër biografike të përgatitur nga n/prefektura Kavajë pas vdekjes së tij, me rastin e 25-vjetorit të Pavarësisë:

‘I ndyeri Sheh Hamid ka qenë Sheh. Njeri me parime moderne, idenë kombëtare e ka pranue qysh

në kohrat e errta të sundimit osman. Ka qenë antar i Klubit t’Itilafëve qi kishte përmbledh në gji shqiptarët e vërtet dhe s’ka mungue të përqafojë me kurajo çdo vendim të grupit shqiptar të Kavajës. Shqiptar i flaktë e atdhetar i deklaruem, asht dërgue në Durrës si përfaqësues i Kavajës në Kongresin e Durrësit më 1918 për zgjedhjen e përfaqësis kombëtare në Konferencën e Paqes. Flamurin kombëtar e mbante në shtëpi me nderim të madh mbas shpalljes s’Indipendencës dhe në kohën e rebelëve asht burgos dy herë rresht. I ndyeri ka qenë kundërshtar i separatizms esadiste dhe njeri me ideal patriotik’.³³

Me rrëzimin e sistemit monist dhe fitoren e pluralizmit në vitet ‘90, u krijua një klimë e re për shoshitjen, vlerësimin dhe vënien në piedestalin e merituar të nderit të atyre që politika e së shkuarës i mohoi padrejtësisht. Pavarësisht nga kalimi i shumë viteve, faktet e dokumentet i kanë përjetësuar dhe komuniteti nuk i harroi këta figura atdhedashurie.

Qeverisja vendore në Kavajë pas vitit 1990, në bashkëpunim me historianë, studiues, punonjës të Muzeut Historik të rrethit e veteranë, ka nxjerrë në pah figurat e shquara të qytetit dhe ka bërë përpjekje për vlerësimin e rivlerësimin e tyre. Kështu, me rastin e 90-vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë, Sheh Hamidit iu dha titulli

32. Dega Radikale në Kavajë, në gazetën “Xhoka”, Nr. 3 (19), 13 dhjetor 1924, f. 1

33. AQSH, F. 266, V. 1926, D. 329, fl. 1.

“Mirënjohje e Qytetit” nga këshilli bashkiak i Kavajës.

Gjithashtu, një nga rrugët e qytetit të Kavajës, e cila njihet si “Rruga e Teqesë”, është emërtuar: Rruga “Sheh Hamid Kraja”.

Me rastin e 100-vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë, me propozim të Bashkisë së Kavajës, Këshilli Bashkiak i këtij qyteti, i jep

Sheh Hamid Krajës titullin e lartë **“Qytetar Nderi”** me motivacion:

“Për kontribut të shquar në mbrojtjen dhe propagandimin e gjuhës shqipe. Atdhetar dhe pjesëmarrës në ngritjen e flamurit më 27 nëntor 1912 në qytetin e Kavajës”.

Duke njohur dhe kujtuar të kaluarën, brezat do të ndërtojnë më mirë të ardhmen.

Paqja, bashkimi kombtar dhe Islamizma

E. F. Kraja

Abstrakt

Hamid Kraja i përket atij brezi që jetoi dhe veproi në periudhën e fundit të Rilindjes Kombëtare Shqiptare dhe periudhën e parë të pavarësisë së vendit. Ai ka punuar dhe ka luftuar me të gjitha forcat e mundësitë e tij fizike dhe mendore duke u vënë plotësisht në shërbim të çështjes kombëtare. Ai ishte njohës i mirë i jurisprudencës, i ligjeve dhe kodeve zakonore, një teolog i shkallës së lartë, po ai ishte njëkohësisht dhe atdhetar i flaktë, që punoi me shpirt e me mendje për bashkimin e shqiptarëve pa dallim feje për të fituar dhe për të mbrojtur pavarësinë e vendit nga pushtuesit, që krijuan ndarje e përçarje deri brenda Islamit.

Vet mësimet e Islamizmës, literalisht, donë me thanë me hy në një vend – paqe, të cilat vijnë nga dy principet themelore të saja, njitimi i Zotit dhe njitimi i racës njerëzore. Këto dy principe janë sheshit të njoftuna në Kur'anin e Shejt dhe të dyja këto idena janë të zhvilluese me kuptimin ma të gjatë. S'ka harmoni ma efektive se ajo që ekziston n'anëtarët e një familje të vetme, e cila na pikturon themelet e

Islamizmës në dy idena të mëdhaja – të një Zotit dhe të një njerzije – me të cilat Kur'ani i Shejtë shtron bazën e një paqes internacionale – të përgjithshme – ma të fuqishme.

Sikur të pranohet një herë që idea e njitimit të racës njerëzore asht bazë e vërtetë për paqen internacionale, mund të krijohen dyshime se idea e njitimit të Zotit a ka ndonjë lidhje me subjektin e paqes internacionale. Fakti asht se Islamizma shtron themelin e njitimit

të racës njerëzore nën njitimin e Zotit, dhe një Zot qëndron për mbi të gjithë, sikur një babë mbi fëmijë të vet, në terminologjinë islame. Një Zot, me një dashuri dhe më mëshirë ma të madhe, të cilat mund të kuptohen në mardhanjet njerëzore, e sjellë të gjithë njerzisë në qëllimin e plotësimit. N' Islamizëm në të vërtetë, idea e njitimit njerzuer asht e puqun e aq ngushtas me iden e njitimit të Zotit, saqë njena pa tjetrën asht e pa kompletueme.

Doktrina e njitimit të Zotit asht e shtruese kjartazi dhe definitivisht në Kur'anin e Shejt. Ndoshta shumica e studentave t' Islamizmës i dijnë, por ma e shumta e popullit nuk dijnë se doktrina e njitimit të racës njerëzore asht e shtrueme në të njajtë qartësi dhe definitivisht si edhe ajo e njitimit të Zotit, për të cilat Kur'ani i Shejt bën fjalë kështu: "Gjithë lavdrimet janë të duhura për Zotin." "Rab (Zot) i gjithë kombeve të botës" janë të vetmet fjalë, me të cilat Kur'ani i Shejt fillon. Po, të shohim çka na tregojnë këto fjalë? Fjala arabisht "Rabb", të cilën, mbasi nuk ka fjalë tjetër, po e përkthejmë, "Zot", që letërsisht don me thanë "Ushqyesi i një gjaje në një gjaje në një mënyrë sa me e ba atë me arrijtë një pozitë mbas një tjetre deri që ajo t'arrijë qëllimin e vet të plot." Fjalët "Rabb i gjithë kombeve" tregojnë kjartaz që gjithë kombet e botës janë fëmijë të një Babe dhe që Ai vetëm ka kujdes të njajtë për të gjithë, tuj i sjellë të gjitha në qëllimin e tyne të plotësimit

gradualisht. Për ma tepër le të flasi vetë Verseti i Kur'anit: "Të gjithë popujt janë një kombë i Vetëm" (2:213) dhe përsëri "popujt nuk janë tjetër veç se një komb i vetëm". (10:19); dhe "O njerëz! Ne ju kemi krijuar juve prej një mashkulli dhe një femre dhe ju kemi bamun juve fise dhe familje që të mund të njihni njeni tjetrin. Sigurisht ma i ndershmi i juaj tek Zoti asht një në mes të juaj, i cili asht ma i kujdesshmi i detyrës së tij." (49:13). Edhe fjalët, me të cilat Libri i Shejt mbaron, janë shesh për të gjithë njerzisë, ku, raca njerëzore asht e përmendun si një familje. "Thuej, unë kërkoj mbrojtje dhe strehë në Zotin e Njerzisë, Mbretin e njerzisë, Perëndinë e njerzisë" (114:1-3).

Siç u tha sipri, idea e njitimit të racës njerëzore jo vetëm që asht e shtruese qartaz në Kur'anin e Shejtë, por asht, gjithashtu dhe e zhvilluese me një zhvillim mjaft të gjatë e të plotë. Ajo që Zoti e zgjatoj ndihmën e tij fizike¹ tek të gjithë kombet e botës asht një fakt aq potent (i dukshëm) sa që as një s'i kundërshton kësaj; gjithashtu dihet se vetëm n' Islamizëm asht e shtruese ajo forcë mbi iden e paralelët që ndihma shpirtnore e Zotit asht e zgjatun tek të gjithë kombet e botës. Në Kur'anin e Shejt nuk asht shtrur vetëm idea që "Zoti asht Rabb i gjithë kombeve", d.m.th. "që ka zgjatë ndihmën e Tij

1. Na duket se asht ma mirë me thanë (materjale). Z. N.

materiale ndër të gjith kombet”, por gjithashtu, në Kur’an asht stabilizue qartaz dhe definitivisht se, “çdo kombi i qe dhurue Reveleta Hyjnore që përgatit ushqimin shpirtnuer të njeriut i cili pa këtë ushqim nuk mundet me e mbrii shkallën e përsosmenisë”. Qe pra ç’urdhënon Kur’ani: “Nuka ka një popull” thotë Libri i Shejt “po një lajmtar ka pas shkuemun ndër ta” (35:24). Edhe përsëri “Edhe çdo komb e kishte një apostull” (10:47). Për këtë arsye Kur’ani i Shejtë flet gjatë mbi profitit e Israilitëve e të shumë profitëve pa bibla, p.sh. flet për Hudin dhe Salihun, dy profitin dërgue në qarqet e Arabisë, flet gjithashtu për profitin ethipjan, me emën Lukman, (31:13), për një Profit të dërguem në Sudan (18:60), i cili ishte i një koheshim me Moses-in - Musanë - ; dhe për një Profet Mbret të Persisë, Dhul Karnejn, ose i zot i dy mbretëve (18:83) i cili nuk asht tjetër veç se Dariu i I-rë. Edhe për m’e e ba ma të shqueme natyrën e përgjithshme të deklaratës së bame, Kur’ani i Shejt e ka kjarue atë që kishte edhe të tjerë Profitën përveç atyne, emnat e të cilëve janë të përmendun në Librin e Shejt. “Ne kemi dergje apostuj që t’i kemi përmend përpara, dhe apostuj që nuk t’i kemi përmendë” (4:164). Kështu që teoria që ndonjë komb ishte zgjedhun nga ana e Zotit veçanërisht të dhanunit e të mirës – Revelatës – së Tij shpirtnore asht plotësisht e refuzueme n’Islamizëm, dhe në vend t’asaj, një bazë vllaznimi

për gjithë kombet asht e shtruese për bukuri, kështu që gjithë kombet janë të konsiderueme si antarët e një familjeje njerëzore me një Zot si Zot dhe Zotni të tyre, i cili i përdor ata njilloj të gjithë, fizikisht aq ma mirë dhe shpirtnisht.

Islamizmi hedh poshtë teorinë – që favorizimi – Revelata – ishte për një komb të vetëm gjithashtu dhe teorinë që ndonjë komb ishte i ndëshkuem nga Zoti. Zoti ndijon lutjet e të gjithë popujve, çfarëdo feje ose shtetësie që të jenë. Ai asht falës dhe mëshirues për të gjithë dhe Ai i dhuron vepra të mira të gjithëve. Ai nuk ban çqarje në mes të popujve të krahinave të ndryshme, tuej fillue nga racat, opinionet ngjyrat ose gjuhë e ndryshme. Ai i krijojë gjithë njerzënë njilloj dhe me një natyrë Hyjnore, “Fitra tallë – hil – leti fetaren nase aleja”, d.m.th. “Natyra e bame prej Zotit në të cilën Ai i ban të gjithë njerëzit”, “nuka ndryshim në krijesën e Zotit, ajo asht feja e drejtë, por shumica e popullit nuk e dijnë” (30:30). Nuk ka pengesë ngjyre n’Islamizëm, as nuk rrjedh ndonji pengesë për shkak gjuhe, as edhe fisi, as nuk ndodhet n’Islamizëm superioritet i njanit mbi tjetrin tek Zoti. Ndryshimet e ngjyrës dhe të gjuhës, të cilat i kanë pru kombet kundra njëri tjetrit, janë simbas Kur’anit të Shejt, vetëm Shenja të Zotit. “Dhe një nga shejat e Tij asht krijesa e qiellzave dhe e tokës dhe ndryshimi i gjuhëve t’uaja dhe të ngjyrave; sigurisht ka shenja

në këto për të ditshmit” (30:22). Kjo duhet të na tërheqë vërejtjen që me të gjithë ndryshimet e ngjyrës dhe të gjuhës e njëjta natyrë njerëzore asht e krijuese kudo. Këtu posht po riprodhojmë disa versete të Kur’anit të Shejtë që tregojnë se:

1- Lutjet e gjithë popujve janë të vështueme nga Zoti – “Dhe Zot’ i juaj thotë: “Më thirr Mue dhe Unë do t’ju përgjegji juve” (40:60). “Ose kush i përgjegj atij që asht në rrezik kur thret Atë dhe zhgulë të keqen dhe ju ban juve sundues në tokë? A ka një zot me Zotin”? (27:62).

2- Falja dhe mëshira e Zotit janë barazisht të shpërndame tek të gjithë.

“Edhe mëshira e Eme rrethon gjithë sendet” (7:156)

“Zot’ i ynë! Ti i përmbledhë të gjithë sendet me mëshirën dhe dijen” (40:7).

“O shërbëtorët e Mij, që keni punue tepër kundra shpitrave t’uaj, mos u dëshproni prej mëshirës së Zotit, pse Zoti i fal gabimet të gjitha” (39:53)

“Zoti i yt asht Zot falës njerëzit me gjithë gabimet e tyne” (15:6)

3- Të gjithë popujt do t’jenë të llogaritur si mbas asaj që ata kanë ba:

“Ai, i cili ban mirë sa pesha e një atomi do të shofi atë, dhe kush do që të bajt të keqe sa e pesha e një atomi do t’a shofi atë” (99:8).

“Kush do që ban mirë, aj do të ketë dhjetfishin e asaj, dhe kush do që ban një të keqe, aj do të shofi dënimin me shembëllën e asaj” (6:160).

“Edhe ne do të vendosim një balancë ditën e ngjalljes (Resurrection), kështu që asnjë shpirt nuk do të jetë i llogaritur me padrejtësi në ndonji gjë” (21:47)

Kështu pra asht sheshit që ideja i njitimit të Zotit n’Islamizëm jo vetëm paraqet që Zoti asht Krijuesi i gjithë kombeve të botës, por gjithashtu dhe marrdhaniet e Tija me njerëz të ndryshëm e me kombe të ndryshme janë të njëjta. Prandaj një Humanity – njerzim – asht rezultati i doktrinës së një Zotit. Siç u tha tani sipri, gjithë popujt janë të përmendun shpesh herë si një komb i vetëm. Gjithashtu janë të përshkrueme edhe si anëtarët e një familje të vetme. “O njerzi! Ne ju kemi krijuë juve prej një mashkulli e një femne dhe ju kemi bamun juve fise dhe familje që të mundeni me njoft njeni tjetrin” (49:13). Në këtë familje njerëzore nuk ka nderim pse t’jetë prej një krahine, as edhe çnderim mbi një tjetër krahinë, as nuk asht ngjyra e një populli as gjuha e tij një provë e madhësisë së tij, siç e zbukuron edhe vet verseti: “Sigurisht ma i ndershem në mes t’uej në sy të Zotit asht një i cili asht ma i kujdesshmi i detyrës së tij” (49:13). Profiti i Shejt Muhamed, per me i forcue këto principe të shejta e të bazueme t’Islamizms deklarojë me za të naltë në peligrimin e fundit – Haxhe-tul-vedan – që kombi i tij “Arabët nuk kishin sipërroritë mbi jo Arabët”. Edhe Buharia na difton një thanie të tij. “Në qoftë se një negro skllav asht i emnuem me sundue mbi

ju, ndigjoni dhe nënshtrojeni atij”.

Nji Musliman asht i cilësuar e i përcaktuar nga Profiti i Shejt “një njeri, prej gjuhës dhe duarve të të cilit gjithë njerëzia janë të shpëtuar”. Edhe Kur’ani i Shejt predikon mbi sjelljen e bukur të njeriut me këto fjalë: “O ju që besoni! T’jeni të patundur për Zotin, dëshmitarë të drejtë dhe të mos urrehet një popull që ju shtyn të mos veproni me të drejtë; veproni me drejtësi, kjo asht ma afër tek devotshmëria (it-tika) dhe t’jeni të kujdesshëm për detyrën tuej tek Zoti” (5:8). Edhe përsëri: “O ju që besoni! T’jeni mprojtësat e drejtësisë, dishmues për hirin e Zotit, me gjithë se mund t’jetë kundër vetes s’uej ose prindërve t’uej, ose t’afërme t’uej” (4:125). Përsëri thotë: “Edhe një popull, që ju penguen juve prej Tempullit të Zotit, mos të urrehet sa të jë shtyjnë për me kapërcye kufinin, dhe ndihmoni njeni tjetrin në të mirë dhe në divoçmëni, dhe mos ndihmoni njeni tjetrin në mëkat dhe në grindje” (5:2). Këtu këshillohet Muslimani për me qenë i patundur në mardhaniet e tij me të gjithë popujt e kombet, bile dhe me ata kombe prej të cilëve kanë qenë të ndjekun dhe mizorët e tyre. Jo vetëm këshillohet Muslimani për drejtësi, por bile dhe me ba mirë atij populli, me të cilët asht në mardhanie me përjashtim t’atyre që gjenden me të vërtet në luftë me një tjetër. “Zoti nuk ju ndalon juve me respektue ata, të cilët s’kanë bamun luftë kundra jush – për shkak të fes

s’uej, dhe nuk ju kanë nxjerrë juve prej shtëpiave të Atdheut t’uej, që ju t’u tregoni atyne zemër bardhësi dhe të bani mardhanie drejtësisht me ta” pse Zoti e dashuron vepruesin me drejtësi” (60:8).

Mësimi Kuranuer mbi luftë, në qoftë se studiohet me vëmendje, do të tregojë që lufta asht me të vërtet faktori ma me randsi që mundet me sjellë paqen e përbotshme. Kur’ani e mallkon luftën sulmuese me fjalët që vijojnë: “Edhe luftoni në udhën e Zotit me ata, të cilët ju luftojnë juve dhe të mos bani sulmim pse Zoti nuk i don sulmuesat” (2:190). Përsëri, Revelata, ma e parë mbi këtë çështje, asht fare e njëjloj e kuartë: “Leja për me luftue i asht dhanë atyre, që janë sulmue për shkak se ata janë damtue dhe Zoti asht i aftë me ju ndihmue atyne... dhe sikur Perëndija mos t’ju hiqte qafet njerzis një popull me një tjetër do të kishin qenë të rrënueme manastirët, kishat, sinagogat, xhamiat, ku emni i Zotit pareshtur përmendet” (22:30,40). Merret vesh fare lehtë se këto dy versete, që janë Revelata ma e parë, e premtojnë Muslimanin me luftue n’at kohë kur asht për mbrojtje të vetës – t’Atdheut -, për të shpetue nderin e ca popujve të dhunuem të cilët janë mbrojtësit e manastireve të murgeve, të kishave kristiane, të sinagogave, të xhamive, pse këto janë shtëpia prej të cilave merret e fitohet ushqim shpirtnuer dhe se përmendet emni i Perëndisë nga gjithë kombet e ndryshme të botës

dhe lufta sulmuese asht rreptësisht e ndaluese. Të gjithë versetet e fundit në lidhje me lëvizjen luftarake janë subjekte e baza, të cilat mbasin principet e Profitit të Shejt dhe të shokëve të tij të hershëm.

Ky ndalim e kjo përbuzje kundër luftës sulmuese tregon faqe kjartë pjesëmarrjen e Islamizmës me ma të madhe fuqi në paqen e përgjithshme.²

2. Marrë nga revista "Zani i Naltë", nr. 2, viti XI, shkurt 1936, f. 61-68.

Abstracts in English

Islamic Sciences

1. Functionalism of Islamic thought

Dr. Muhamed Mustafi

Abstract

Islamic thought is something that is considered as an entirety which cannot be divided into smaller parts, because in such a case it would be merely considered a result of any theory that can be either accepted or rejected. The entirety of such a thinking makes it functional in daily life since the period of Islam's announcement until today. Functionalism of Islamic thought can be very real if implemented in every idea and action at the same way it has been applied at the time of the Prophet PUBH, i.e. as it has been accepted by the people of that time. The pure Muslims' mind, the greater will be the functionalism of Islamic thought and vice versa, the pale Muslims' brain, the weaker will be its functionalism. Islamic thought does not need to be perfect to be renewed because it is perfect by its very nature and emanates from the divine origin, but instead, we need to renew ourselves and be proud of Islam and not of ideas and thoughts that come only from the human mind. Human thoughts are diverse and very often they become outdated by time passing, while Islamic thought is constant and suitable for all ages, because it stems from Islam, which is not valid only for any certain time or people and therefore, everyone has the opportunity to implement it and hereto, it can be applied in any country.

2. What did you do to feel the prayer?

Adnan Merja

Abstract

If you really want to accomplish the prayer properly, then you should be stripped of any sense other than the pleasure of Allah (SWT) and open your heart to Him. Every word flowing from your lips must be stamped with the seal of consciousness. For example, when we say Alhamdulillah, we need to know better what is meant by this word and to elaborate it in our consciousness and sobbing we must say "All praise, thanks and sublimation, belongs to Allah (SWT). It is my duty and the right of my Creator to do this." Thus, this word it exalted to Allah, together with the insights that we have carried on it. Also, when we say Ar-Rahman and Ar-Rahim, we have to be adorned with the same feelings for Him. When we say Maliki Jeumid-Din, we have to seal this word with the magnificent meanings it contains and in this form to present ourselves to the Trust One. Prayer for us should be considered as a Miraj and for this we should strive according to our capacity to feel those truths which our Prophet (AS) felt too.

Studies

3. Publication of the complete edition of "Zani i Naltë" magazine - Compensatory evaluation for the years of its anathematization and its importance today-

Mr. Ramadan Shkodra - Dr. Sadik Mehmeti

Abstract

The half century absence of "Zani i Naltë" magazine's heritage – as well as many of its peers - which were published at the same period with it or after it - and its consequent anathematization, avoidance and denial of its values, and furthermore, the segregation, contempt and naming as "enemies of the people" of authors who have written on this issue, not only indicate a severe, orchestrated and systematic effort of that time's ideological thinking to extinguish and to underestimate its values, but it proves once again that good word - the word of truth and hakikat - is like a good tree; its roots are deep into the earth, and its branches are high, very high, and - God willing - it gives its fruits at any time and at any moment.

4. Give the employee his salary before his sweat dries out!
Ilir Akshija, M.D., M.Sc.

Abstract

The study and comparison of the banking system with Islamic practices, or even the opposition at certain times is common in Islamic economic literature. A topic that has not been routinely addressed is the payment of workers and the evaluation of relevant schemes according any model based on Islamic legislation. Exceptional flows of capitals in the financial world rightly have put the Muslim economist into a difficult position. Being obliged to respect contracts and looking for profit which must be halal, he is highly charged of responsibility in this respect. Therefore the main focus is centered on banking transactions and stock trading neglecting other factor, and - in a way – he has fallen prey of imitation of ready models in terms of employee payment system. In this discussion we raised the question whether the employees' payments that usually are made once a month could be considered as a debt paid with delay or a subcategory of usury, if we refer to the Hadith for immediate payment of the employee! Salary of the first day of a certain calendar month is taken at the same time as the salary of the last day, not taking into account the timeliness of work completion which for any ordinary employee is the working day. The consequences of payment delay are recognized in all the practical procedures; furthermore, receiving a monthly salary not in the given time, is associated with increased crime, drug consumption, alcohol and creates the possibility of obtaining short-term loans with high interest. This hypothesis requires a response in the future from experts of fiqh, and possibly it needs an interdisciplinary discussion.

Islamic jurisprudence

5. Religious supervision to parents or Ihtisab – the rules and ethics
Dr. Sedat Islami

Abstract

'Commanding the good and forbidding the evil' is one of the most important religious institutions. It ensures the implementation of the law of God in society and the preservation of the latter by any negative phenomena. Because of this importance it has, it is described in the Qur'an (9:71) as an obligation that derives from religious brotherhood. Because of having such a status, it is regulated as an institution with the relevant rules and ethics in order to prevent any case of its wrong manifestation, which may have ramifications. Commanding the good and forbidding the evil continued as a state and social organ for centuries. Over time, deficient perceptions in this respect, as an institution, philosophy and worldview, have led to its erroneous application. There have been made errors - inter alia - in relation to parents. This paper aims to represent the aspects where it was wrongly applied regarding the parents and what are the religiously adopted forms for its application in relation to them.

History

6. Six centuries of institutional Islam in the Balkans

Prof. Dr. Feti Mehdiu – Prishtinë

Abstract

Many foreign scholars - and domestic ones as well - who handle the historical matters objectively rejected the thesis of Islam spread through violence in the Balkans by the "Asian invaders".

Objective researchers, independent from political ideologies, have proved through their scientific research that traces of Islam in Albanian territories had existed long before the Ottomans arrival in these lands. This is a reality that cannot be denied or ignored. It is also true that long before the Ottomans arrived to this region of Balkan Peninsula- in Albanian territories - Islam initially was not supported institutionally by the relevant state entities. It was presented only from willing individuals, missionaries or traders, who accidentally passed through these lands.

7. Sanjak of Skopje at the end of XIX century and early XX century

Dr. Hasan Bello

Abstract

Kosovo Vilayet which was part of the of Skopje at the end of XIX century and early XX century, lied in Western European territories of the Ottoman Empire, with an area of 32,000 square km. In the East it bordered with Bulgaria, in the West with Vilayet of Shkodra, Bosnia and Montenegro, in the south with Thessaloniki, and in the north with Serbia. In this context, due to the geopolitical position this vilayet – and consequently the Sanjak of Skopje - occupied, it was turned into the most important but at the same time in one of the most problematic Vilayets of the Empire.

Given the infrastructure (railway station), health care, telegraphy network - the conditions necessary to avoid additional costs of wasted trips - and given the city was not in the border area, Skopje - according to him - had all the prerequisites to become a Vilayet center. In 1888, the Ottoman government rightly decided to transfer the Kosovo Vilayet center to Skopje Sanjak.

8. In search of independence

Nuredin Nazarko

Abstract

Albania's independence, arrived as a result of many historical circumstances combinations, brought to the Albanian people a mutilated state, without any geographical or demographic cohesion, which was necessary to establish the foundations of a future

sustainable development in the Albanian lands. Albanians gained a truncated state, but lost significant parts of their territories - a loss which was not only political, but also economic and demographic. Each part of the Albanian territory took a different way of development according to the country to which it already belonged. The cohesion of the internal market broke and under and aboveground assets of Albanian territories - which were mangled - would be used by states to which these territories already belonged after 1913. After gaining their independence, Albanians testified -though in a painful way- the "love" of civilized nations towards them, although there were great expectations the great civilized Europe would know how to fix things correctly in their case.

Translation

9. On the religion and freedom

Turki El-Hamed

Abstract

The essential divine wisdom, which derives from the narrative of creation, is that the presence of opposites is essential to recognize their core, but no one has no right to monopolize the natural recognition of opposites. Things lose their value without the presence of opposites. The diversity of colors is necessary to make distinction between them. Diversity among people is essential to life in order to bring it forward. Otherwise the life turns into a stinking pond, where the water has lost its characteristic taste and the air is bad and smelly. Without pluralism, diversity and opposites, everything loses taste and sense, the universe is transformed into a shapeless and senseless accumulation.

Personalities

10. The patriot cleric Sheikh Hamid Kraja

(1870 -1926)

Muharrem Shqarri

Abstract

Hamid Kraja belongs to the generation that lived and acted in the last period of the Albanian National Renaissance and the early period of country's independence. He worked and fought with all his forces and possibilities - physical and mental - putting himself completely in the service of the national cause. He was a connoisseur of jurisprudence, laws and customary codes; a theologian of the highest degree, but he was at the same time a patriot who worked with his soul and mind for unification of all Albanian people regardless of religion and for the acquiring and preserving the independence of the country from invaders, who introduced divisions and splits even within Islam.

Retrospective

11. Peace, national unity and Islam

E. F. Kraja

Abstract

Thus, it is clear that the idea of God's Oneness in Islam not only shows that God is the Crator of all world nations but also His relationships with different people and nations are of the same degree. Thus, having the same "Humanity" is the result of the only One God's doctrine. As mentioned above, all people of the world are often mentioned as the same nation. They are also mentioned as the members of the same family. "O people! We have created you from a male and a female and We made you in tribes and families in order to know each other (49:13)." In this large human family there is no advantage being from a certain region or any disadvantage being from another; neither is the color of a nation nor their language a sign of its majesty, as expressed in the Quranic verse: "Certainly, the most honorable amongst you in God's sight is the one who is more careful to his duties (49:13)." In order to enforce these sacred and important Islamic principles, the honorable Prophet Muhammad loudly declared in front of his follower in his last pilgrimage: "Arabs are not superior to non-Arabs." Bukhari also narrates in one of his sayings (hadiths): "If a black slave is appointed to rule upon you, listen and obey him!"

Rregullat e shkrimit

Çdo shkrim duhet të ketë një strukturë, që duhet të përmbajë në mënyrë të detyrueshme elementët e mëposhtëm:

1. Artikulli duhet të jetë punë studimore e kërkimore, shkencore origjinale.
2. Titulli i artikullit të jetë sintezë e problematikës që trajton. Ai nuk duhet të jetë më i gjatë se 35 karaktere.
3. Të vihet emri i autorit me gradën shkencore përkatëse. Poshtë emrit të jepet pozicioni zyrtar i tij/saj.
4. Poshtë këtyre, në krye të shkrimit, me një paragraf të veçantë mund të jepet një abstrakt, duke radhitur të gjitha nënçështjet.
5. Artikulli duhet të jetë i strukturuar me disa nënçështje, sipas tematikës që shtron.
6. Nënçështja e parë e çdo artikulli duhet të jetë “Hyrja”, ku të jepen qëllimi dhe objektivat që e kanë shtyrë autorin për ta shkruar atë dhe rëndësia e botimit të tij.
7. Të gjithë nëntitujt të jenë me “Bold” dhe shkrim “Italik”, “Times New Roman 12” dhe të paraprihen nga numrat 1, 2, 3, etj.
8. Në fund të artikullit duhet të jetë një nënçështje e posaçme me titull: Sugjerime a përfundime.
9. Artikull duhet të ketë në fund bibliografinë.
10. Artikulli duhet të ketë footnote-a dhe referenca në fund të faqes, për të treguar burimin e një citati a të një informacioni që jepet në tekst dhe duhet të shkruhet me shkrim “Times New Roman 10” dhe të përmbajë: autorin, titullin e veprës, shtëpinë botuese, vitin dhe vendin e botimit, numrin e faqes nga është marrë citati. Shprehjet e marra ekzaktësisht nga materialet e tjera të botuara më parë duhet të jenë në thonjëza.
12. Kur informacioni merret nga interneti, duhet shënuar data; p.sh., 10 maj, 2008. Në fund të footnote-s vihet pikë dhe ajo rregullohet me «Justify».
13. Artikulli duhet të jetë jo më pak se 5 faqe dhe jo më shumë se 15 faqe kompjuterike.
14. Artikulli duhet të respektojë rregullat gramatikore të gjuhës shqipe standarde.
15. Shkrimi duhet të jetë “Times New Roman” me “Spacio 1”. Të mos mungojnë shkronjat “ç” dhe “ë”. I gjithë teksti të jetë “Justified”.